

Jeta Arbëreshe

e-mail: jetarbreshe@libero.it - <http://digilander.libero.it/jetarbreshe> (Mondo Italo-Albanese)

Del nga tre muaj - Trimestrale della Minoranza linguistica storica Albanese d'Italia - Eianina / Purçill (Cs- Italia)

Spedizione in A.P. - TAXE PERÇUE - art. 2 comma 20/c - L.662/96, Aut. n. DCO/DC/CS/101/2003, valida dal 06/03/03

Përmbajtja / Sommario

LETRA DREJTORIT	faqe 2
EDITORIALI	
Drejtori (<i>Fjala Arbëreshe</i>)	faqe 3
PËRVJETORI	
dom Nikë Ukgjini (<i>Dom Simon Filipaj e Bibla shqip</i>)	faqe 3/17
KORRISPONDENXA NGA KATUNDET ARBËRESHË E ISH-ARBËRESHË	
Kikina Martino (<i>Të rinjt për dëmin e Rozarnit</i>)	faqe 4
Kostandin Bellushi (<i>Mostër ikonësh bixantine</i>)	faqe 4
Spectator (<i>Cfarë po ndodh me Kishën Arbëreshe?</i>)	faqe 5
Tommasa Guarino (<i>Shuarja e vlerave të traditës arbëreshe</i>)	faqe 6
Peppe De Micheli (<i>Le Icone Badessane</i>)	faqe 6/11
Daniela Moccia (<i>Ture ruajtur Shën Benedhitin çë sholaret</i>)	faqe 7
Patrizia Figlia (<i>Shurbise të rea për Kajvericin</i>)	faqe 7
TEKSTE POPULLORË NGA KATUNDET ARBËRESHË	
Agostino Giordano (<i>Vjershi nuses</i>)	faqe 8
Giulio Peta (<i>Si vritet derku</i>)	faqe 8
Giuseppe Chiaffitelli (<i>Derku</i>)	faqe 9
Giuseppe Mario Miracco/Motimadh (<i>Një mot i harruar</i>)	faqe 10
Maria Assunta Fazzano (<i>Si thuet Këmarin</i>)	faqe 10
Peppe De Micheli (<i>Le Icone Badessane</i>)	faqe 11
Gaetano Passarelli (<i>...E le allettanti promesse</i>)	faqe 11
Angelo Matrangolo (<i>Një Kalimere e farruar</i>)	faqe 11
QISHA BIXANTINE ARBËRESHE	
Intervistë zotit Manuell Giordano (<i>Treni më llargoj ka gjiritë e më qasi ka Inzot</i>)	faqe 12
Vincenzo Straticò (<i>Ajri Shin Mëris Malit</i>)	faqe 12
POEZI ARBËRESHE	
(Beccia, Scutari, Borrescio, Di Lena, Russo)	faqe 13
POEZI SHQIPE	
(Kodra, Arapi, Bozha, Miftari, Dibrani)	faqe 14
TE PRAKU I QISHËS	
Arbri Roman (<i>At Gjergj Guzzetta Shënjt?</i>)	faqe 15
STUDIME/RECENSIONE MBI BOTËN ARBËRESHE	
Alma Dema (<i>Arketipi në simbolin e ëndrrave të Koliqit</i>)	faqe 16-17
Papa Jani Giudice (<i>Sa Arbyreshy te dheu i Kutronit!</i>)	faqe 18
Nexhip Mërkuri (<i>Sociolekti i Përmetit dhe emërtimet e bimësisë në bashkësinë arbëreshe të Pulinit llukan</i>)	faqe 19
Rrezarta Draçini (<i>Ndikimi i kulturës arbëreshe në Shqipërinë e viteve 1878-1912</i>)	faqe 20
Helena Grillo (<i>Zef Serembe, autori arbëresh në këndvështrimin gjuhësor</i>)	faqe 21
Italo Costante Fortino (<i>Birnard Bilota i shkruan De Radës</i>)	faqe 22
DORËSHKRIMI ARBËRESH	
Bernardo papas Bilotta (<i>Shpata Skanderbekut ndë Dibret Posht</i>)	faqe 23
STUDIME/RECENSIONE MBI BOTËN SHQIPTARE	
Alisa Velaj (<i>Ankthi i dritës në poezinë e Alket Çanit</i>)	faqe 24-25
dom Nikë Ukgjini (<i>Dom Simon Filipaj e Bibla shqip</i>)	faqe 25
Irena Sawicka (<i>Studime polake për gjuhën shqipe</i>)	faqe 26
Vilma Proko Jazexhiu (<i>Fjalori Enciklopedik Shqiptar, pasuri e madhe kombëtare</i>)	faqe 27
Odise Çaçi (<i>Laskarina Pinoçi, Bubulina</i>)	faqe 28
Irena Fistani (<i>Gjuha shqipe dhe ndikimet e latinitetit mesdhetar</i>)	faqe 29
Vilhelme Vranari (Haxhiraj) (<i>autobiografi e shkruar nga autorja e vetë</i>)	faqe 30
LIBRE e RIVISTA	faqe 31
JO VET ARBËRISHT	
Pierfranco Bruni (<i>Mostra itinerante su Cultura Arbëreshe</i>)	faqe 32

Letra drejtorit

Mirëmbërmani, mik i nderuar i letrave,
Ndiehem i prekur thellë kur mendoj se si me një dashamirësi
vëllazërore më dërgoni revistat numra me radhë, duke mos
ndier as më të voglin lodhje, ndërsa unë u tregova memec, i
heshtur, por për asgjë tjetër por nga punët e përditshmërisë, që
më lodhin, por jo të më ftohni nga respekti e malli që ndiej për
ju, vëllezër gjuhe e gjaku. (...)

Me këtë rast po ua dërgoj disa poezi, me shpresë që në të
ardhmen t'ju dërgoj në vazhdimësi vargje të tjera poetike.

Me respekt e dashuri vëllazërore

Muharrem Miftari

lindur në Mitrovicë, Kosovë, banues në Finlandë (25-10-'09)

Përshëndetje të perzemërta. Jeni shumë i sjellshëm!

Shpetim Bozha (23-10-'09)

Të falënderoj shumë dhe gjithnjë sa herë që revista e juaj më
vjen në email.

Jeni një dritë ne muzgun e kulturës arbëreshe, jeni një dritë që
u shërben njerëzve për të pritur mëngjesin e kësaj kulture të
rrezikuar dhe të mrekullueshme; kulturë e cila per ne shqiptarët
ka erëminin e qytetërimit më të mirë arbëror të shekullit të XV
dhe atë rilindës të shek XIX.

Edhe njëherë faleminderit.

Artan Shkreli (22-10-'09)

Direttore Istituto per i Monumenti Culturali, Direzione di Tirana

Zoti Drejtor

unë nga zemra ju falimnderoj per kontributin tuaj të shkëlqyer
që po bani. Zoti ju bekoft juve dhe gjith popullin Arbëresh. Kjo
që po bani ju sot të jep edhe më shumë vullnet se ju të dashur
vllëzër fare nuk e keni harruar trugun tuaj se prej ka keni
ardhur. Doket, zakonet traditat e një populli vetëm kështu ruhen.
Urim edhe njëher nga Osman Caka, nga Manchester i Anglisë.
Vetëm desha që të informoj se këtu në Manchester të Anglisë
gjegjesisht në Manastirin e Gortonit, është vendosur Shtatorja
e të madhës sonë Nëna Tereze, ku ideator jam unë dhe kjo
shtatore është vendosur prej në lartësis mbi 2 metrash.

Ju uroj sukses

Osman Caka (18-10-09)

I dashur z. Giordano,

Sot mora numrin 63 të revistës Jeta Arbereshe dhe më pëlqeu
shumë përmbajtja e këtij numri, e cila ishte shumëllojshme.

Ju falënderoj shumë për kujdesin që po tregoni duke më
informuar vazhdimisht me përmbajtjen e revistës Tuaj.

Shëndet e shumë suksese,

prof. Zeqirja Neziri (16-10-09)

I dashur Agostino,

Të falënderoj shumë që më kujton e më dergon herë pas here
edhe "Jetën", që, sa më shumë kalon koha, fiton një përmbajtje
më të pasur e rrit edhe më shumë nivelin e saj shkencor. Shoh
që ky numër i Jetës paska shumë informacione që mua më
interesojnë edhe drejtpërdrejt.(...)

dr. Merita Bruci

(17/10/'09)

Grazie della rivista! La sfoglio sempre volentieri, specie da
quando ti sei deciso a metterci un po' più di italiano e qualche
traduzione in più. Lo so che pensi che questo è solo un mio
limite, ma che vuoi farci? Sono arbrësh anch'io. Con affetto.

prof. Emilia Blaiotta (14-10-'09)

I dashuri im vëlla, drejtor i gazetës "Jeta Arbeshe",

Faleminderit për kujdesin që tregoni ndaj meje, duke më
dërguar shkrimet e kësaj gazetë të bukur dhe shumë cilësore
nga jeta e vëllezërve tanë të një gjaku - arbëreshëve. Unë e
lexova prej fillimi e deri në fund dhe u mrekullova nga shkrimet
e bukura.

Të fala të perzemërta vëllazërore - Gjaku i Arbërit rron!

Prof.dr. Hamit Xhaferi

Universitet - Tetova - Macedonia (19/7/09)

Faleminderit, Agostino! Shumë mirë për këtë gazetë të
rëndësishme. Do ishte akoma më mirë nëse arrini ta shtypni dhe
ta përhapni gazetën Jeta Arbëreshe edhe në Tiranë, Prishtinë,
Tetovë, etj. Besoj se e keni këtë projekt me rëndësi të madhe së
afërmi.

Iu uroj mbarësi

Saimir Lolja

Toronto, Kanada (17/7/09)

I nderuari drejtor,

posa e mora me e mail numrin e fundit të Jeta Arbëreshe. Shumë
faleminderit që na e dergoni dhe jam mjaft mirënjohës. Ta dini
se me kureshtje e lexoj. Përndryshe unë kam qenë në grupin e
studentëve dhe arsimtarëve nga Universiteti i Europës
Juglindore nga Tetova, që udhëtoi dhe qëndroi në Tokat
arbëreshe të Italisë në vitin 2007. Kam shumë mbresa nga ai
udhëtim. Kam parë njerëz që qanin kur merrnin vesh se `Jeni
gjaku jonë i shprishur` e deri te ata të cilët, për të treguar
përkatesine e tyre, këndonin këngë arbëreshe ose thonin
`Sembre arbëresh`. Ju përgëzoj dhe ju them se po bëni një punë
të mirë dhe shumë atdhetare për gjith arbëreshët, për ne jashta
Arbërisë dhe sidomos për ruajtjen e trashëgimisë kulturore të
arbëreshëve, për gjëratat e reja.

Me respekt,

Hasan Jashari (16-7-09)

Shumë shumë të fala zot.Giordano!

Ju uroj jetë të gjatë dhe gjithë të mirat!

Faliminderit për kujdesin!

Ju mirëpresim në Maqedoni të na vini...

Me respekt,

Zeqir Kadriu (16/7/09)

Përshëndetje, Arbreshë e Arbeshe të dashur.

Ju përgëzoj për ruajtjen e gjuhës dhe traditës. Zoti Ju bekoft!
Unë jam kryetar e një shoqërie kulturore dhe artistike, "Shtoj"
nga Ulqini, Mali i Zi (Montenegro).

Organizata e jonë është jo fitim prurëse. Në vitin 2002 kemi
 marrë pjesë në festivalin ndërkombetar "Città dei ragazzi" në
Palermo, me ftesën e arbreshit zoti Zef Giuseppe Chiamonte.

Me respekt

Mr Leze Lazari (korrik 2009)

Fjala Arbëreshe

Te këta 8 vjet mbajtim dhezët flakën e Arbërisë dhe shumë zjarre dhezitim këtu këtë ndëpër katundet arbëreshë. Ku dhezitim shkrepse, ku qirinj, ku flakëza, ku varavashka, ku zjarre. Me Fjalën Arbëreshe.

Fjala. E menduar, e ri-menduar, e studjuar, e zgjedhur, e lëmuar; e mbështuar te peshorja e zakonit, e hulluar te vatra e përrallavet, e zbkruar tek argalia e vjershevet, e kënduar ndër vallet e gjitonivet, e matur mbi buzët e plakavet.

Fjala ka magjinë e saj. Kur thuhet e kur shkruhet. Kur gjegjet e kur djovaset. Fjala qasën e reshtën, Fjala ngjitën e zgjidhën, Fjala ngjallën e therën. Fjala. Ngaherë Fjala.

Neve Arbëreshë na lidhën Fjala, na mban të gjallë Fjala. Me Fjalën thërresmi e murmurisimi, këndomi e vajtomi, vallëzomi e shërbemi, qami e qeshmi, romi e trashgomi. Ngaherë Fjala.

Po Fjala Arbëreshe ka, e do, nderën e saj: nëng shitet e nëng blehet lirë ndër sheshet. E para fjalë jo ngaherë është më e mira, më e kulluara, më arbëreshe. Fjala arbëreshe do zgjedhur. Një e një duan zgjedhur fjalët arbëreshe. Dhe të qepura njera me jetrën, si zërat e vashavet ndër vallet e Pashkëvet. Tek të folit e tek të shkruarit, fjalët duan zgjedhur. Pak e të matura. E Arbëreshe. Jo “arbëreshine” (fjalë lëtrë të arbëreshizuara) e jo shqiptare. Po Arbëreshe. Sa më shumë Arbëreshe.

Jeta Arbëreshe është për Alfabetin e Monastirit, i njohur e i përdorur ka gjithë Shqiptarët e Botës.

Jeta Arbëreshe është për Arbërishten. Për më të mirën Arbërishte katundare, ose për Arbërishten standarde.

Jeta Arbëreshe, ndëse ka të zgjethë ndër dy fjalë – një “arbëreshine” e një shqipe – nëse s’ka si të ndërronjë “arbëreshinen” me një të fjalë arbëreshe, zgjeth fjalën shqipe.

Jeta Arbëreshe e di se katundari s’mund të flasë ngaherë me fjalët e duhura; po shkruesi o gazetari o drejtori o shkrimtari o profesoriarbëresh “kanë” të shkruajën si duhet. E sipas rregullavet gramatikore. Fjalët i merr ajri e shkrimi qëndron. Jo vet: shkrimi mëson më se fjala, shkrimi bëhet histori. E sot Arbëreshët duan të djovasjën tekste arbëreshë të kulluar.

E ardhmja e Arbëreshëve viret ka Gjuha. Ka gjallëria dhe pastërtia e Gjuhës ‘ tyre.

Drejtori

La Parola Arbëreshe - In questi otto anni abbiamo tenuto accessa la fiamma dell’Arbëria e molti fuochi abbiamo acceso qua e là tra i paesi arbëreshë. Dove abbiamo acceso fiammiferi, dove ceri, dove fiaccole, dove incendi. Con la Parola Arbëreshe.

La Parola. Pensata, ripensata, studiata, scelta, accarezzata; pesata sulla bilancia della tradizione, levigata al focolare delle favole, abbellita al telaio degli canti, cantata nelle ridde dei vicini, soppesata sulle labbra delle vecchie.

La Parola ha la sua magia. Quando si pronuncia e quando si scrive. Quando si ascolta e quando si legge. La Parola avvicina e respinge. La Parola lega e slega. La Parola resuscita e uccide. La Parola. Sempre la Parola.

A noi Arbëreshë ci lega la Parola, ci tiene vivi la Parola. Con la Parola gridiamo e sussurriamo, cantiamo e piangiamo, balliamo e lavoriamo, piangiamo e ridiamo, viviamo e tramandiamo. Sempre la Parola.

Ma la Parola Arbëreshe ha, e vuole, il suo onore: non si vende e non si compra a basso prezzo nelle piazze. La prima parola non sempre è la migliore, la più pura, la più arbëreshe. La parola arbëreshe va scelta. Una per una vanno scelte le parole arbëreshe. E cucite l’una con l’altra, come le voci delle ragazze nelle valle di Pasqua. Nel parlare e nello scrivere, le parole vanno scelte. Poche e pesate. E Arbëreshe. Nè arbëreshine (parole italiane arbëreshizzate), nè “albanesi d’Albania”. Ma Arbëreshe. Per quanto è possibile Arbëreshe.

Jeta Arbëreshe è per l’Alfabeto di Monastir, conosciuto e usato da tutti gli Albanesi del mondo.

Jeta Arbëreshe è per la Lingua Arbëreshe. Per la migliore Parlata Arbëreshe locale, o per l’Arbërishte standard.

Jeta Arbëreshe, se deve scegliere tra due parole – una “arbëreshina” e una “albanese d’Albania” – se non ha come sostituire l’ “arbëreshina” con un’altra parola arbëreshe, sceglie la parola “albanese d’Albania”.

Jeta Arbëreshe sa che il popolano non può parlare sempre con le parole giuste; ma chi scrive o il giornalista o il direttore o lo scrittore o il professore arbëresh “devono” scrivere come si deve. E secondo le regole grammaticali. Le parole le prende il vento e lo scritto rimane. Non solo: lo scritto insegna più della parola, lo scritto diventa storia. E oggi gli Arbëreshë vogliono leggere testi arbëreshë corretti. L’avvenire degli Arbëreshë dipende dalla Lingua. Dalla vitalità e dalla purezza della loro Lingua.

Përvjetori

Dom Simon Filipaj e Bibla shqip

Qendra e Studimeve Albanologjike e Tiranës, në bashkëpunim me Institutin Filozofik dhe Teologjik të Shkodrës, me rastin e 10vjetorit të vdekjes së dom Simonit Filipaj dhe të 15vjetorit të botimit të Biblës shqip (Ferizaj, 1994), organizuan Konferencën Shkencore “Filipaj dhe Bibla shqip” e cila u mbajt më 11 nëntor 2009, në Muzeun Historik Kombëtar:

Filipaj dhe Bibla shqip

Viti i tanishëm në të cilin po zhvillohet kjo veprimtari përkujtimore, 10 vjetori i vdekjes së dom Simon Filipajt, ka një koincidençë të rastit, sepse përkon me 15 vjetorin e botimit të Biblës në shqip, vepër kjo e cila na bëri ta përkujtojmë dekadën e vdekjes së përkthyesit dhe veprën e tij jetësore Biblën. Simon Filipaj u lind më 1

maj të vitit 1925, në fshatin Kllezën e Ulët, afër Ulqinit, në Malin e Zi. Të gjitha vitet shkollore i kreu në gjuhën sllave në mungesë të shkollës në gjuhën amtare. Seminarin e Ulët për në rrugën e meshtarisë e nisi në Tivar, për t’i vazhduar më pas mësimet në seminarin e Jezuitëve në Shkodër 1941-45; i kreu studimet, filozofike dhe teologjike, me sukses të shkëlqyer në Fakultetin Teologjik të Zagrebit dhe në këtë vend u shugurua meshtar më 29 -VI- 1950, si anëtar i Kryedioqezës se Tivarit. Në vitin 1994 u bërë i mundur përkthimi i plotë i Vulgatës së Re, në gjuhën standarde, botuar nga shtëpia botuese “Drita”, Ferizaj, falë pasionit dhe vullnetit të çeliktë për 40 vite më radhë, të mjeshtrit të fjalës shqipe,

dom Nikë Ukgjini

nga Shkodra

klerikut të shquar të kishës katolike, dom Simon Filipajt: rëndësia e veprës përcaktohet edhe nga koha kur u realizua ky botim, se libri ishte punuar gjatë rritjes dhe forcimit të sistemit komunist dhe ateist i cili për 45 vite më radhë si një morde e zezë, dominonte mbi trevat shqiptare dhe më gjerë. Të përkthesh Biblën, do të thotë rrokesh me kompetencë më një varg çështjesh si: njohja me traditën e përkthimeve biblike dhe gjuhët e saj të kohës, të jesh teolog i spikatur, të kesh njohuri në filozofi, histori, letërsi dhe poezi, si dhe të jesh mjeshtrë i madh i fjalës së letrave shqipe.

(ec te faqja 17)

Të rinjt për dëmin e Rozarnit

Mostër ikonash bixantine

Kikina Martino

ka Ferma (Cs)

Të rinjt e Acione Katolikës së Ungrës u gjëndëtin në Shëjtitërorin ‘ Sh. Kozmit e Damianit e Strigarit, ndër 31 e janarit 2010, sa të parkalesin bashkë dhe bashkë të fjsin mbi dëmin që qe në Rozarnë. Pas liturgjisë, që qe thënë nga zoti Pietër Minisci e zoti Elia Hagyi, foli Viçenxi Feraudo, president i AK nga Strigari, fali të rinjt zoti Minisci e presidentja e AK Eparkisë ‘ Ungrës Kikina Martino, që prisëndarti profisurin Vincenzo Bova, që mson Sociologia të Fenomenevet Politike tek Fakulteti i Shencavet Politike në Universitetin e Kallavrisë: ki tha si, që kur u zu jeta, “jetri” trëmbin e skotisin njerëzit, njerëzit e populit ecëtin e ndrrun dhe, më shumë nani, nganjë shurbes që mund pundaret do të qellet mbë krishter, si njerëz që kan bes tek një që shpëton.

Kostandin Bellushi

ka Pllatëni (Cs)

Ndër gjashtë të Falvarit të k’tij viti, Pllatën, te Çentri Gramshjan – që më parë ish Kanxheleria a vjetar - u bë një pamje me trembëdhjetë ikona bixantine (di ikona t’ voktra t’ Krishtit që bekon - Pantokrator, çera a shëjtë t’ Krishtit mbi skamandilin – Mandilion, tri ikona t’ Shën Marisë së butësisë - Eleusa, një ikonë a vokarr t’ Shën Timoteut, di kriaangjul: Gabrielli dhe Mikelli bashkë me çeran a shëjtë t’ Zotit Krisht, një ikonë me Zotin Krisht djal bashkë me fëmilan e tij – Ypapandi, një ikonë a vokarr me kria a prerë të Shën Janjit Pagëzor dhe njetar di ikona t’ voktra, gjims kurmi, të Shën Marisë) të shkruara ka mjeshtri Fangijsk Kosta ka Hora, “ç’ japan harë sivat dhe buthojan gjithë mirësin e ksaj art a shëjt”, si thon kritkrat ikonograf që pan pamjan e tij. Ikonat ishan gjithë t’ bukura e t’ bënura me teknikan e motit: tempera me krukun e vesë me fleta ari mbi dërrasa t’ vjetra arja, qari dhe tili. Ki trim artist shudharti ikonografi dhe ikonoloxhi Lourdes, ndr’ Franxh’t; qelli ikonat e tij aq parjashta se mbrenda Talljas dhe kudò vata kle i mirëpritur dhe pat sukses t’ madh. Pas ca vjet u mbjodh ka katundi i tij e sod sharben ka llaboratori i tij, ka Marina e Horës (114), ku jeton.

Sen. Basilio Giordano

3^a Commissione - Affari Esteri, Emigrazione
Vice Presidente Comitato Italiani all’Estero

Piazza Madama, 1 – 00186 Roma

Tel. (+39) 06.6706.3174 • Fax (+39) 06.6706.6174

basilio.giordano@senato.it • www.basiliogiordano.com

Mostra di Icone Bizantine

Il 6 febbraio di quest’anno a Plataci, nel Centro Gramsciano dell’ex Municipio, è stata allestita una mostra di tredici icone bizantine (due piccole icone di Cristo benediciente - Pantocrator, il Santo Volto di Cristo - Mandilion, tre icone della Madonna della Tenerezza – Eleusa, una piccola ikona - ‘icona da viaggio’ - di San Timoteo, due arcangeli: Gabriele e Michele con il santo volto di Gesù Cristo, un’ ikona della Sacra Famiglia – Presentazione di Gesù al Tempio, una piccola ikona di San Giovanni Battista decapitato e altre due piccole icone, a mezzo busto, della Madre di Dio) scritte dal maestro Francesco Costa di Villapiana, “che sanno dare gioia ed esprimono tutta l’eleganza e la serenità di quest’arte sacra”, come affermano i critici iconografi che hanno visitato la sua mostra. Le icone erano tutte belle e realizzate con la tecnica antica della “tempera all’uovo” con foglie di oro zecchino su tavole stagionate di noce, rovere eiglio. Questo giovane artista ha studiato iconografia e iconologia a Lourdes, in Francia; ha esposto le sue icone sia all’estero che in Italia e, dovunque sia andato, è stato ben accolto ed ha riscosso grande successo. Dopo qualche anno è rientrato nel suo paese ed oggi dipinge nel suo laboratorio di Villapiana Lido (114), dove vive e lavora.

Pëstaj hëngtin bashkë tek Shpia e udhëtarit e ristorandët e Strigarit sulltin shumë shurbise të mira. Pas të ngrënit u mbjodhëtin papani mbë qish, ku avukati Xhusepi Capparelli foli mbi komunikatin e Caritas e dioqezës ‘ Oppido- Palmit, se ku gjëndet Rozarni; tha se të hujt qelljin një gjellë të rëndë dhe e keqe si nëng mund jetë tek një dhë i krishtëruar, edhe se qisha e Caritas i mbetin afër, i dhan si do mundëtin. Dica herë është, e do të bësh martri, si judëçi Livatino, e si i nget krishterëvet.

Jeta Arbëreshe



Trimestrale di Cultura
e Informazione Arbëreshe,
in Italia e nel Mondo

Revistë tremujore e Shoqatës Kulturore “Jeta Arbëreshe”, Purçill/Eianina (Cs-Italia)

Drejtor përgjegjës / Direttore responsabile: **Agostino Giordano**

Drejtori, Redaksi dhe Administratë / Direzione, Redazione, Amministrazione: via G.Marconi,30 – 87010 Eianina-Purçill (Cs-Italia) - Tel. 0981-32539 / 340-8452364; e-mail: jetarbreshe@libero.it – http://digilander.libero.it/jetarbreshe

Shërbim grafik / lavoro grafico: Antonio Giordano

Ku shtypet / Stampa: AGM srl, Telefax 0981-491957 – e-mail:

info@agm.calabria.it

Abonime / Abbonamenti: (4 numeri): Italia €30 (Institucjona €60), Europa e America €40

Ku dërgohen turesët / Versamenti: sul ccp. n.12994760, intestato a: Associazione Culturale “Jeta Arbëreshe” – 87010 Eianina/Purçill (Cs)

Regjistrim / Registrazione: Tribunale di Castrovillari (Cs), nr.4/2001 del 28-12-2001

Artikuj, Dorëshkrime e Fotografij, edhe ndëse s’botohen, nëng jipen prapë / Articoli, Manoscritti e Foto, anche se non pubblicati, non si restituiscono

Drejtorja nëng është përgjegjëse për përmbajtjen e artikujvet të nënshkruar / La Direzione non è responsabile del contenuto degli articoli firmati

Gjithë të drejtat të rezervuara / Tutti i diritti riservati

Çfarë po ndodh me Kishën Arbëreshe ?

Spectator

Prej kohësh në disa numra të kësaj reviste z. drejtor, prof. Agostino Giordano, shprehet në mënyrë tepër kritike për Kryetarin e eparkisë së Lungro-s.

Ndërsa në eparkinë tjetër arbëreshe, atë të Piana degli Albanesi (Hora e Arbëreshëvet), nuk ndjehet asnjë pipëtim dhe mesa duket atje gjithshka shkon mirë.

Ç'mund të mendohet atëhere për dërgimin kohët e fundit të një Vizituesi (Inspektori) Apostolik në eparkinë siciliane?

Nuk është publikuar asnjë lajm mbi përfundimet e vizitës.

Nga burime informale njoftohet se vizita vjen pas ankesash të shumta nga ana e eksponentëve të klerit në Selinë e Shenjtë, dhe pikërisht në Kongregacionin vatican për kishat lindore, kryesisht në lidhje me çështje të natyrës ekonomiko-financiare.

Një tjetër shenjë pakënaqësie nga ana e klerit arbëresh të Sicilisë u shfaq disa vjet më parë, kur eparku Sotir botoi, me financime publike, një përkthim të Meshës së Shenjtë të Shën Gjon (Joan) Gojartit. Famulltarët jo vetëm që refuzuan të përdorin tekstin, të paraqitur pa recognitio-n e zakonshme nga Selia e Shenjtë, por ju drejtuan Romës për miratimin e një damnatio memoriae (mallkimi). Dhe me të vërtetë, vëllimi nuk gjëndet më!


Në dy "rastet" e fundit të eparkisë horjote vëmë në dukje një veçori të re: ndryshe nga tradita shekullore që i vendoste laikët në rradhë të parë, sot të gjithë aktorët i përkasin klerit. Sigurisht është një shenjë e kohëve, megjithatë është krejtësisht negative. Zërat kritikë të besimtarëve kulturallisht të kualifikuar janë zbehur, për të mos thënë se janë zhdukur krejtësisht, të lënë mënjana me angazhime të tjera të shumta të eparkisë, natyrisht jo shpirtërore.

Ajo që denoncohet nga Drejtori Giordano për Lungro-n dhe ajo që flitet për Horën e Arbëreshëvet nuk mund të na lërë indiferentë.

Del e qartë për të gjithë që arbëreshët kurrë s'do të kishin mundur të mbeteshin ata që janë pas 5 shekujsh e gjysëm jete italiane pa respektin dhe interesin e Vatikanit. Meqënëse kemi të bëjmë në fakt me komunitete të vogla, të izoluar nga njëra tjetra dhe pa një traditë qytetare unifikuese - të cilën u përpoq ta themelonte në Palermo, aty nga mesi i '700-ndes, Patër Gjergj Guxeta - ato me siguri do të ishin zhdukur plotësisht nëse Papati nuk do të ishte interesuar si në nivelin thjesht kishtar ashtu dhe në atë kulturor.

Prandaj mësojmë me një kënaqësi të veçantë që Këshilli i përhershëm i Konferencës ipeshkvnore italiane, organizëm ky modern i shprehjes së kujdesit suprem papnor, në mbledhjen e 25-27 janarit 2010, ka nisur "një shqyrtim të strukturimit të Kishës Arbëreshe në Itali" (krhs. Avvenire të 30 janarit 2010, fq.26)

Do të ishte e këshillueshme që gjatë riorganizimit me modalitetet sui juris të Kishës Bizantine Arbëreshe, sidomos pas celebrimit të Sinodit ndëreparkor që u bë kohët e fundit, duke ringjallur një frymë të re shpirtërore në dy eparkitë së bashku me Manastirin e Shenjtë të Grottaferrat-ës, të jepej një shenjë konkrete uniteti me zgjedhjen e një Mitropolitit.

<p>VANGJELI</p> 	<p>i pjerrë arbërisht</p> <p>nga</p> <p>zot Emanuele Giordano</p> <p>230 faqe</p> <p>Euro 10,00</p>
---	--

Che succede nel campo ecclesiastico arbëresh?

Da tempo, in alcuni numeri di questa rivista, il sig. direttore, prof. Agostino Giordano, si pone in termini assai critici nei confronti del Capo dell'eparchia di Lungro.

Sul versante dell'altra eparchia arbëreshe, quella di Piana degli Albanesi, invece, non si sente stormir foglia e sembra che lì tutto scorra liscio.

Che pensare, allora, del recente invio di un Visitatore Apostolico nell'eparchia siciliana?

Notizie sull'esito della visita non se ne hanno.

Solo da indiscrezioni si viene a sapere che la visita fa seguito a numerose lamentele da parte di esponenti del clero alla S. Sede, e segnatamente alla Congregazione vaticana per le chiese orientali, riguardanti principalmente questioni di ordine economico-finanziario.

Altra avvisaglia di malcontento da parte del clero arberesh di Sicilia si ebbe già alcuni anni fa, allorquando l'eparca Sotir, pubblicò, con denaro pubblico, una traduzione della S. Messa, detta di S. Giovanni Crisostomo. I parroci non solo rifiutarono di adottarne il testo, proposto senza la recognitio di rito da parte della S. Sede, ma ricorsero a Roma per una sua damnatio memoriae. Di fatto il volume è introvabile!

Nei due ultimi "casi" dell'eparchia planense notiamo un differente approccio: di contro a una tradizione secolare che vedeva i laici in prima linea, oggi gli attori rimangono tutti all'interno del clero. E' certamente un segno dei tempi, ma assolutamente negativo. Sono diminuite, forse scomparse del tutto, le voci critiche dei credenti culturalmente qualificati, lasciate ai margini a favore di molteplici altri impegni, non certo spirituali, dell'eparchia.

Quanto denunciato dal Direttore Giordano per Lungro e quanto trapela da Piana degli Albanesi non può lasciare indifferenti.

Aappare chiaro a tutti che mai gli arbereshe avrebbero potuto rimanere quelli che sono, dopo 5 secoli e mezzo di vita italiana, senza il rispetto e l'interesse del Vaticano. Trattandosi, infatti, di piccole comunità, isolate fra di loro e senza una tradizione cittadina unificante -della quale cercò di gettare le basi, a metà del '700, a Palermo il P.Giorgio Gazzetta-, esse sarebbero state certamente cancellate se il Papato non se ne fosse interessato vuoi a livello strettamente ecclesiastico vuoi a livello culturale.

Con vivo piacere, perciò, apprendiamo che il Consiglio permanente della Conferenza episcopale italiana, organismo moderno di estrinsecazione della somma cura pontificia, nella riunione del 25-27 gennaio 2010, ha avviato "una riflessione sulla strutturazione della Chiesa Italo-Albanese in Italia" (cfr. Avvenire del 30 gennaio 2010, p.26).

Sarebbe auspicabile che, nel riorganizzare con modalità sui juris la Chiesa Bizantina Italo-Albanese, anche a seguito del Sinodo intereparchiale testé celebrato, e nell'infondere nuovo vigore pneumatologico alle due eparchie e al sacro Monastero di Grottaferrata, si desse un segno tangibile di unità nella persona di un Metropolita.

	<p>W W W</p> <p>ARBITALIA .it</p> <p>.net</p>
---	--

Shuarja e traditës arbëreshe

Tommasa Guarino

ka Kuntisa (Pa)

Te dita 14 janar, te salla e Këshillit bashkiak “ F. Di Martino “ të Kuntisës, u përkujtua dyzetedy (22°) përvjetori i terremotit, që kle te lugina e Bëliçit.

Ish një natë e ftohtë e me borë kur dheu u tund. Gjithë iktim nga shpiti tona, më shumë e më pak të pështruar, pa të lënguar mirë atë që ish e ndodhej.

Edhe Kuntisa pati viktimën e saj, Gushtin Merendino, i zënë nga një shkëmb, te momenti që ish e ndihë një i pafuqishëm. Përveç këtij të vdekuri, hora ngë pati dëme të forta materiale, dëmet klenë shoqërore, morale, etnike.

Për përkujdesimin e kryetarit që ish aherna, on. Frangjiisht Di Martino, ndihmat për rindërtimin e shpive ng’u kanë lypsur, gjithë Kuntisiotët patën mundësinë të bëjnë një “bukur” shpi. Nga kjo eksperiencë vijën jashtë dica vërejtje time. Ehj, sot gjithë kanë një shpi të re, me gjithë komoditetet, sot Kuntisa ka njetër faqe. Ng’isht më ajo horë e bukuriqe, me formën e njëi trekëndëshi, e shtruar përpos Brinjave, por isht ndarë te dy pjesë, pjesa e re e qendri i vjetër.

Ngë isht më gjithonia, lypsen ato lidhje shoqërore, që te qëroi i shkuar jipjin jetë karakteristikave tona arbëreshe.

Ky ndërrim shoqëror-urbanistik, ndarja e horës, emigrimi në Itallinë e veriut, në Gjermani, në Zvicër, martesat e përziera, të huajt që kanë ardhur te hora për sa të shërbejnë kanë dhënë një kontribut negativ për të shuar vlerat e traditës sonë e idealet e lidhura me historinë tonë, më gluhën tonë, me etninë tonë.

Edhe qendri i vjetër kle shëmtuar nga çimentit, i çili nga një anë ka dhënë mundësinë të ndreqëshin shpiti që ishin, nga tjetra anë ndërrojti faqen e hores, që rroj më shumë me bujqësi. Me rindërtimin pas terremotit u ka pasur një ndërrim të madh ekonomik, nga një horë bujqësore shkojtim te një horë te ku shumë vilanë u bënë mjeshtrë, muraturë ose manualë. (Leu ashtu industria e ndërtimit të shpive).

Prandaj, e folmja arbëreshe sbiret gjithmonë më shumë, ndërsa një herë j’arrej fëmila për t’ e trashgaur gluhën, sot jo, përçë në fëmilë, më të shumtën herë, njeri ka prindërit ngë isht arbëresh dhe atëherë zgjidhet gluha italiane ose dialekti sicilian për të folur në shpi.

Nderkaqë, për gjithë të mirat e etnisë sonë duhet ndihmja e skollës, si vegël përhapjeje kulturore, dhe e administratës bashkiake, si vegël e përgjegjshme e rritjes shoqërore. Skolla dhe administrata bashkiake kanë të shërbejnë shumë për t’ e mbajtur gjallë atë bëgatëri të vlefshme, që na lanë tatërat tanë, të bëjën në mënyrë se kopilet mënd t’ i njohën më mirë rrenjat e tyre, historinë e tyre, vlerat kulturore, çivile, morale e fetare e komunitetit të të çilit janë pjesë, ndryshe humbet identiteti i njei populli, i çili rron nga më shumë se pesëqind vjet.

Vërtet isht, si shkruan Ali Podrimja, poet e shkrimtar kosovar, te Jeta Arbëreshe nr. 56, se “Arbëreshët kanë krenarinë, mallëngjimin e një kujtesë historike”, por isht gjithashtu vërtet se, sot si sot, ngë mend të rrojëm me kujtime, me mallëngjim, me një kujtesë historike e për të qëndruar përpos njei globalizmi të madh.

Komunat e horëve arbëreshe duhet, pra, të mirren vesh e të shërbejnë bashkë, pa përheje e jo vetëm në dica ndodhje, me të gjitha agjencitë edukative, për të mbajtur lart flamurin e Arbërishtërisë, e çila ka klenë për ne Arbëreshë, llargu dheut kaha kemi ardhur, krenari e që na ka dhënë gjithmonë një shënim të madh më shumë te konteksti i realitetit tonë sikul ku na rrojëm.

Le Icone Badessane

Peppe De Micheli

nga Badhesa (Pe)

L’attuale amministrazione rosceanese tende la mano e invita alla collaborazione la Curia Vescovile di Lungro (Cs) per far ripartire un processo di valorizzazione e crescita della comunità di Villa Badessa. Va necessariamente letta in questo senso la recente decisione discussa e presa in consiglio comunale di concedere i diritti della pubblicazione sulle icone di Villa Badessa “Le icone e le radici” curata dal prof. Passarelli, che qualche anno fa fu oggetto di controversia. La contesa sfociò in un contenzioso giudiziario, che nei primi due gradi di giudizio vide in sostanza prevalere le posizioni dell’ente locale, lasciando, il copyright della pubblicazione, concepita senza scopo di lucro, al Comune di Rosciano.

A distanza di anni, l’uscita del volume sulle icone della chiesa di Villa Badessa è stata accompagnata da un generale consenso, ha svolto una preziosa funzione divulgativa ed ha rappresentato un primo esempio di catalogazione delle 77 icone, la maggior collezione di icone votive dell’Europa Occidentale. Ma le vicissitudini, prima e dopo la pubblicazione, hanno scavato un solco di divisione tra l’ente locale e il potere religioso.

La nuova amministrazione Secamiglio ha pensato di rivedere in senso costruttivo i rapporti con la Diocesi calabrese e tendere la mano. Per dare subito il buon esempio ecco che allora con deliberazione consiliare sono stati ceduti i diritti di riproduzione del volume all’Eparchia, “Stabilendo comunque il divieto di fissare alcun prezzo” - precisa l’assessore ai lavori pubblici del Comune di Rosciano Costantino De Micheli, rappresentante badessano in seno alla maggioranza. “Il gesto di buona volontà è stato dettato dalla volontà in primis del sindaco di porre fine a questa annosa e sterile ostilità che nessun vantaggio sta arrecando alla vita sociale della comunità badessana. Facendo sempre riferimento alle sentenze giudiziarie sulla pubblicazione, si è ben pensato di cedere il copyright alla Curia di Lungro, visto che le icone sono un bene di una delle sue Parrocchie. Nel nuovo clima di collaborazione inoltre sono stati messi sul tavolo altri progetti da condividere per migliorare Villa Badessa: parlo della sistemazione dell’area ex cimitero dove, oltre che la necessità di un arredo urbano, potrebbe essere costruita una Pinacoteca: idea non nuova, visto che già il defunto Papas Lino Bellizzi si era adoperato anni addietro per una sua realizzazione. L’amministrazione comunale ha inoltre donato alla Parrocchia di Villa Badessa un contributo di 2.000 euro per l’acquisto di nuove sedie per la chiesa SS. Maria Assunta.

Un’ulteriore iniziativa che l’amministrazione sta portando avanti, con un auspicato sostegno degli altri enti amministrativi, oltre che dell’Eparchia di Lungro, per Villa Badessa è la proposta di una legge ad hoc, da far approvare in Consiglio Regionale, che tuteli e permetta di valorizzare i tratti caratteristici ed unici della comunità badessana, dal rito greco-bizantino e dalle origini albanesi. Abbiamo già individuato le linee guida per una legge che nel dettaglio vada a favorire le nostre peculiarità, prendendo spunto da leggi ad hoc approvate e già in vigore.”

Le speranze e gli intenti dell’assessore De Micheli e dell’intera amministrazione rosceanese attendono d’ora in poi segnali positivi dalla Calabria, che indichino precisi cambi di direzione all’andazzo di questi ultimi anni.

(ec te faqja 11)

Ture ruajtur Shën Benedhitin çë sholaret

Daniela Moccia

nga Shën Benedhiti (Cs)

Është e sholaret një copë nga Shën Benedhiti nga ana ku gjëndet qisha e Sëndrokut. Shola, nd'atë llok, kish xha qënur ndë sekullin çë shkoj e mosnjeri kish besë se mund prirej pameta nd'atë llok, po kështu qe. Shola zuri e u tund vjet ndë dimër e simbje vate përpara: sholarti udhën çë qellën Allimarr, kaq çë nëng mund shkohet mëngu me këmbë, pështroj një kazeluçe, ndajti një vaskë nga depoziti i ujvet çë gjëndet lart ndë male; nani është'e mutan murin prapa qishës e Sëndrokut. Bashkia e Shën Benedhitit çë aministroj kur zuri shola, çë ndë votacionat e majit vjet mori ndan 880 vote mbi 1200 çë qenë gjithë votet të ndajtura vetëm ndër 2 llista, nëng bëri faregjë sa shola mos të vej përpara. Ujit e malit nëng qe nxjerrë me tube: qe lënur të rrij e të vej mbrënd dhe njera çë ki nëng zuri pameta të kallarej alla posht. Ture thënë se pritëshin soldet nga governi, qenë spenduar ata çë kish bashkia sa të bëhshin një marçapjed e një shesh pa belicë, ku nëng mund venë ne kriatura ne pjeqë, të parata përcë nëng mund vehet me një pasexhin e përcë, si ndë tjerat sheshe të katundit, nëng është mos një jokë; pjeqët nëng mund venë përcë ka të bëhen di shkalla pa mos një pasaman. Shën Benedhiti është'e ljbjar edhe të llurtmin mullir nga tre çë kish një herë: zuri sa të bij muri ndan arket e, më moti shkon, më vëra është'e rritet e mosnjeri do t'e dijat. Një katund çë nëng ka mos një monument është'e ljbjar edhe të llurtmin sinj të storjes të tij. Po ç'i bën ndëçë katundi franàn e mulliri bie? Bëhet më njize të rrihet e ruhet, se të bëhet gjë..!

Shurbise të rea për Kajvericin

Janë ca shurbise të rea për Kajvericin e Qanën. Ndë tre të marsit doli sentença e Tarit të Lacit për rikursin çë kish bën Asoçjaciona Kajverici Rron. Ka të pundaren llavuret e rikostrucionës. Me këtë sentencë qe anulartur verballi të konferenxës e servixeve çë qe bën ndë 2007 e çë aprovarëj proxhetin definitiv. Verballi qe anulartur pse ngë qe bën vallutaciona të impatit ambiental. Tari i Lacit thot ndë sentenxë se shurbiset çë bëhen ndë emergencë servirin të sallvohen gjindja, kur gjindja u sallvuan nëng është më emergencë e proçedurat ka të ruhen gjith, ngë mund të cumbaren. Proteciona Çiville tha se rikorirën te Konsili i Shtetit. Ndë këtë momend shpit çë stistin ndë Qaneta janë abuzive. Udhë të dilet nga kjo storje është edhe shumë e gjatë e e keq. Është edhe njetër shurbes i ri për Kajvericin. Ndë 14 të fjorarit Shën Gjergji e tjet Shëjtëra, çë ishin si ai llogiër ndë qishën e Qanës, u mbjodhëtin te shpia e tire. Peshku Mons. Domenico Crusco desh se statuat e Kajvericit mbidhëshin Kajveric dopu se nëng është mos një perikull për qishën e për gjindjat. Ndë Kumunin e Qanës ka të bëhen ellecionat komunale. Qenë prisëndartur 3 llista. Dopu ellecionave Kumuni i Qanës ka pameta një sindkë, pse ka një vit çë është i komisarjarm. Duam të penxojmë se kështu mund të kanxhojnë shurbiset çë nëng venë ndë gjë më të mirë.

Guardando S.Benedetto che va in rovina - Sta franando una parte di San Benedetto Ullano dal lato in cui si trova la chiesa di San Rocco. La frana in quel punto si era già verificata nel secolo scorso e nessuno credeva potesse ripetersi in quel luogo, ma così è stato. La frana ha iniziato a muoversi lo scorso inverno e quest'anno è andata avanti: ha distrutto la strada che porta a Marri, al punto da non poterla percorrere neppure a piedi, ha coperto una casupola, ha lesionato la vasca del deposito d'acqua sito in montagna ed ora spinge il muro alle spalle della chiesa di San Rocco. L'Amministrazione comunale, che amministrava all'inizio della frana e che nelle votazioni dello scorso maggio ha ottenuto circa 880 voti su 1200 totali divisi solo tra 2 liste, non ha fatto niente per impedire che la frana proseguisse: l'acqua della montagna non è stata intubata, ma lasciata correre e infiltrarsi nel terreno, finché questo non ha iniziato di nuovo a scendere verso il basso. Sostenendo di attendere il denaro dal governo, è stato speso quello del Comune per costruire un marciapiede ed una villetta senza alcuna bellezza e impraticabile sia per i bambini che per gli anziani: per i primi perché non si può entrare con un passeggino, e perché, come in tutte le villette del paese non c'è alcun gioco; gli anziani non possono andarci perché ci sono 2 rampe di scale sprovviste di corrimano. San Benedetto Ullano sta perdendo anche l'ultimo mulino, dei tre che un tempo aveva: sta cadendo il muro vicino agli archi ed il foro più passa il tempo più si allarga e nessuno se ne interessa. Un paese che non ha nessun monumento sta perdendo anche l'ultimo segno della sua storia. Ma cosa importa se il paese frana e il mulino cade? È più facile stare a guardare che fare qualcosa ...!

Patrizia Figlia

ka Kajverici (Cs)

Novità per Cavallerizzo - Ci sono alcune novità per Cavallerizzo e il Comune di Cerzeto. Lo scorso 3 marzo il TAR del Lazio si è pronunciato sul ricorso presentato tempo fa dall'Associazione Cavallerizzo vive ed alcuni cittadini di Cavallerizzo. I lavori della ricostruzione del nuovo paese devono essere fermati. Con la sentenza del 3 marzo il tar ha annullato il verbale della Conferenza dei Servizi del 2007 con il quale si approvava il progetto definitivo, perché la procedura è priva della valutazione di impatto ambientale. Il TAR motiva la sentenza col fatto che per il progetto di ricostruzione non si possono seguire le procedure di emergenza. Le procedure di emergenza servono per mettere in salvo persone e cose, messe in salvo queste si devono seguire le procedure normali senza deroghe di alcun tipo. La protezione Civile ha fatto sapere attraverso il sito che ricorrerà al Consiglio di Stato. In questo momento, di fatto, tutto quello che è stato costruito in contrada Pianette è abusivo. La strada per uscire da questa storia è ancora molto lunga e tortuosa. C'è stato anche un altro evento nuovo importante per Cavallerizzo. Lo scorso 14 febbraio S.Giorgio e gli altri Santi, che erano ospiti nella chiesa di Cerzeto, sono tornati a casa loro. Il Vescovo in persona, Mons. Domenico Crusco, ha ordinato che S.Giorgio e gli altri Santi tornassero a Cavallerizzo dato che non c'è alcun pericolo per la chiesa e per l'incolumità delle persone. Nel Comune di Cerzeto ci saranno le elezioni comunali. Sono state presentate 3 liste. Dopo le elezioni il Comune di Cerzeto finalmente riavrà un sindaco; è, infatti, ormai un anno che è commissariato. Considerando la situazione tutt'altro che rosea in cui versa il comune si spera che una volta eletto il nuovo sindaco le cose per Cerzeto possano cambiare in meglio.

Vjershi nuses

(vjen ka nr. 62)

(*diten e martesës, tek shpia e dhëndrrit*)

Se ti zot e dhëndërrith,
mos më ec i trëmburith:
se ti s'je vete të luftosh
po ti vete te rrëmbesh
at krie mollzen,
at mes purteken! (1)

Se ti trim e lumi trim,
paç më hje, o vllathi im,
dha si dielli kur del! (2)

Se ti trim e lumi trim,
asaj udhje çe te shkoç,
aq lule nëmëroç! (2)

Se ti krëher e krëhri im,
krehme mir ti dhëndrrin:
se ndë mos m'e krehsh mir,
u di çika me të bënj
e të shtie pjëhravet! (2)

(*tek shpia e nuses*)

Paç më hje, ti motra ime,
dha si dielli kur del,
e si hëna kur perndon;
dha si peta ndë mësallet,
si tariu ndë skamandilt. (2)

(*i pari kor vajzash, ture krehur nusen*)

Ju po shoqe edhe gjitone,
krehnia mir këshetëthin,
piksnia but e bënia pal
me ato hjetulla si bor:
mos i kputni ndënj fill,
t'ë varesnj kojo her! (1)

(*i diçiti kor, në vend të s'jëmës*)

Ngreu se mënove shum. (1)

(*i pari kor, për nusen*)

Nëng mënoi mosnjeri
se mënoi zonja e jëm
t'i bënej stolizit. (1)

(*i diçiti kor, për t'jëmen*)

O nuse vash-dëllir,
ku je, mollez pa mbjel,
shtënur rrënjet pa bot? (1)

(*i pari kor, për nusen*)

Ëh, mosnjeri nëng më potisi,
vetëhea më lulzoi,
dielli vet më zbukuroi.(1)

(*njeter version*)

Paç më hje, ti motra ime,
dha si dielli kur del,

(mbjodhi) **Agostino Giordano**

Purçill e Frasnite (Cs)

si vera e qelqevet,
si triesa me mësall. (1)

Çë t'bëra, ti mëma ime,
e më ndajte ka gjir it,
ka gjirit e vates sate? (2)

Vash, ti spingull e rëgjënd,
pataksu e mos bjer mbë këmb:
mirr uraten e sat'ëm;
ndë ti do t'jeç hajdhjare,
mirr liçenx ti shoqevet,
puthi doren e tit et. (2)

(*njater version*)

...mirr të falat ti ka shoqet,
ka shoket e gjitonet;
mirr uraten e sat'ëm,
të sat'ëm e të tit eti. (1)

Paç uraten, ti bil,
Si t'Inzoti edhe tonen;
çëdo bëç, të past nder:
le zakonezit çë ke
e mirr ata çë gjën. (1)

(*i vjehri mbiton/fton të renë sa t'i verë pas, mbë Qishë*)

Ngreu nuse, e ulur nuse,
ngreu si t'zu hera:
dhëndrri rri e t'pret te dera.
Mos na ngà me lot ndër si
Se tij dhëndrri të do mir,
ai e gjith fëmila tij;
ngreu e mos të t'zërë më hera,
dhëndrri ë e t'pret te dera. (1)

(*njater version*)

Ulu nuse, ngreu nuse,
ngreu, nuse, e nga me ne
se tek it at nëng ke më hje:
t'qellmi t'rrish mb'udh e re,
se t'ë bëm një shpizë te re;
se sot e bëni me shëndet
e u gudhirshit nj'milez vjet:
maniöfshit ar sa dafshit vet! (3)

1) M'i rrëfijti Sepmaria Makanit / Ferrari Epifanio, ka Frasnita, ditën 20-8-1973;

2) I gjeta shkruar tek dorëshkrimet e papas Bernard Bilotës (1843-1918);

3) M'ë rrëfijti Maria Markut/Maria Miranda, ka Purçilli, ditën 21-8-1973.

(2 – ka më)

Si vritet derku

Giulio Peta

ka Garrafa (Cz)

Te Karnillevari, nj'herë, gjithë vrisnin derkun. Menaten vanë nj'kusi të pjot me ujë te fokullari. Kater o pes njerz lidhënj derkun te çupjelli i madh, e vrasin me nj'thikë, gratë marmë gjakun te llimba pi të bënënjë gjaksnë. Pra vanë derkun te magia, gratë marmë ujit i ngrohtë ka kusia me nj'poç e njerzt, me thikë të madhë, pillänjnjë gjithë derkun. Pra e vjerren te nj'travë, e shkuartanjnjë, më parë nxjernë fucken e na, ç'ishmë më të vogël, e uhjänjmë; pra nxiernë zorret e i ljanjnjë e i ndertonjnjë. Mjездit hanë gjithë bashkë me gjiri tumac me lang me ashtre. Pra presnë gjith mishtë e grat mbjonjnjë, me butil druri, sallucice e supersatë e gjithë gratë këndonjnjë: "Vemi ka ai mal, mal e zam gjarprin i zi". E njërizt vejnin ka karrerat e luanjnjë djathhtë. Nesor bënënjë "kusinë", mbjonjnjë një kusii me lëkura, ashtre e mish i majmë, e zienjnjë e bënënjë të lier, drra, e frezullimet e gjithë hanë fritulat me ulli ka uthulla. Pra tre ditë gjithë sallumet i vjermë lartë te fokullari me fumatë çë del ka fanoi.

Come si uccide il maiale

Nel periodo di Carnevale, una volta, tutte le famiglie amazzavano il maiale. La mattina si metteva una grande pentola piena di acqua nel focolare. Quattro o cinque uomini legavano il maiale sopra un grande ceppo e lo sgozzavano con il coltello. Le donne raccoglievano il sangue in un vassoio di terracotta per fare poi il sanguinaccio. Dopo mettevano il maiale nella madia, le donne prendevano l'acquabollente con una pignatta e gli uomini, con un grandi coltelli, pulivano tutta la pelle del maiale. Dopo veniva appeso a una trave e veniva tagliato: per prima toglievano la vescica, e noi piu' piccoli la gonfiavamo; dopo toglievano tutte le budella, le lavavano e le preparavano, per poi essere riempite. A mezzogiorno, tutti insieme con i parenti, si mangiava la pasta al sugo preparato con la ossa del maiale. Poi la carne veniva tagliata e le donne riempivano, con l'imbuto di legno, le salsicce e le sopressate e cantavano tutte insieme il canto di Carnevale: " Andiamo alla montagna e prendiamo il serpente nero..."; gli uomini, invece, andavano alla località "Carriera" e giocavano con il formaggio. L'indomani si preparava la "quaddara", cioè riempivano una grande pentola con la pelle, le ossa e la carne grassa del maiale si faceva bollire per fare il grasso, cicole e fresulimiti; e tutti quel giorno mangiavano le frittelecon il contorno di olive e sottoacetii. Dopo tre giorni tutti i salami venivano appesi sopra il focolare, con il fumo che usciva dalle tegole.

Sa i glet i krështeri derkut !

Kur isha i vogël, ta a dijta “uerrë mondjale”, ndë gjithë shpité rritjan derkun, pë çë nëng ish si nani, çë janë shumë vuçari e “supermerkatë”, e nëng ishën shumë turesë pë të blijan mishtë. Pë këtë, ta muaji marsit, pas pak çë kish lënë sisan a dosës, blihij “dirzi”, çë nëng mbëshoj më sa pes o gjasht kille. A qelljan jasht ngadita e ai nëng zëj kurrë pushim sa, pë gjithë ditan, vej tura kërkuar krimba, brumbulla, këmil, lakra, lulkuqe, barëra, renja, e çdo gjë të ngrënshtëm. Mbrëman e ndë ditat kremtja, o kur ish moti i lig çë nëng vehij jasht, haj atë pak çë mbetij nga të ngrënt: pij latiran, haj ndonj “patafë” o dardhë o mollë të kalbët, krundan. Adhe ndonjë gjitënë pa drek i bij latiran e gjithë ate çë i mbetij nga të qëruart e lakravet o nga te ngrënt, ma sprënxan të kish “prësendin” pë dhuratë ta të vrrat të derkut. Derku njera te vjeshti rritëhij ashtu, Haj çdo gjej, isht “onnivoro”, ha gjithsej si i krështeri. Sa i glet i krështeri derkut! Pas çë kish ngrënë kalliu ndë kallametë e lëndat ta pilla, ndë shënmitër ish lidhur ta një “katrumbë” ma terkuzan ta “stala”, haj e pij ta korita sa më dish: “ghardhinë”, elbët, krunda, molla e dardha të kalbëta, lënda, kungul e gjithë tjera të ngrëna çë i pëlqenjë derkut. Tura ngrënë e tura flerë mahij shumë mirë, dreq si ka te bënë nga derk i ndershem e, ta muaji shëndreut o ta janari ma të parën dhëborë, vij vrrarë. Ditan kur vrisjan derkun, gra, burra e në sa gjithë djelma, gëzohshin e shurbejan ma hare. Çë manatën shpejt jëma dhezij zjarrin e virrij ta kamastra kusin a madhë, atë çë duhij vetëm kur bëjën sapunin, kunnxervan o finjan pë t’lajan petkat o kur kish ziajan makarunat çë hajan ta nusja. Laj mirë magjan, tjetrat kusi të mesma e të vogla, tavullierin, triazan e “bufetan”. Jati vej ta “çilari”, mirrij skanin, ghamallin e tërkuzan. Skani ish një triaz a ultë e shumë a fortë, a bënë nga “mastërhdashi” nga një trung lisi i ndarë dishë, e mbajtur nga katër këmbë të forta e pak të hapta sa kish të mbaj derkun çë mbëshoj shumë e tundij ma sa fuqi kish, e burrat çë i vëshshin mbi pë t’a mbajjan pënguar pë të mos ikij. Të vegllit mbajën bishitin. Kur vejan të mirrijan derkun, ki, o pë çë ish shumë i rënd enëng ja bëj më të ecij, o pë çë e ndriaj ate çë kish t’i bëjan, nëng dish tundij nga vendi tij, kaq sa duhij ta a tëlqjanma shumë fuqi njera ta shpia, ku a nrejan e a hijjan ta skani e a mbajan fort. Si ujët ta kusia zëj vale, lalë Vëçjenxi Bakukut, ma një thikë të madhë, i prisij kanaroçin e një grua mblidhij ta një kusi gjakun çë a rrotulloj ma një purtekë pë të mos piksej. Kur derku, Pas çë kish rrahallisur e rënguar shumë e bënur të sprasmat thirma të rrohuja e rrahalla, kish pasavisur, qërojan qimat e i shkulanj thonjë. Të një kënatë mirrijan ujë të ziar nga kusia e ja shtijan ku ma një thikë të ehjur kish i gërrijan lëkuran. Pas çë i kishën vënë e bënë një këmbë pë pak mot, ndonjë imtë, ta një kënatë ma ujë të ziar i toljanj thonjë çë i shkulanj ma ndihman a njëj cinxullja. Më a rëndë ish a qëruart a buzës, veshvet, këmbëvet, bishitit e vukullarit sa i mbetshin qumat edhe ndë a kishë bënë mirë. Pra ma një thikë nxirrshin jasht “njervat”/dejavët a këmbëvet të prapma, ngulshij “ghamall” e vëhij vjerrë derku ma një tërkuzë a lidhur ta një katrumbë hekuri o ta huri llamjas. Pëstana hapij barkun tura zënë nga lart, nga bishti, çaj eshatr e bithësë ma një spatë, shqitij kullarinin, prisij e hilqij culaqin, ndë derku ish maskull; nxirrj zorran a gjere e zorran a ngushtë bashka ma sqepin, plënxin, mulshimë ma fellin, shprethkën, zëmran e kanarillin, veshlat e fuckan. Gratë vejan zorrat mbi një tavullier, i mbrazjan nga muti, i shqitjan nga shqepi, i prisjan, ma një purtekë të hollë i sprisjan sa faqja përjashtëma vej brënda e ajo çë ish a përmbrendëma vej jasht. Si u kishen nxjerre gjithë të përmbrendat, ma një spatë çahshin eshatr a kurizit, nga bishti njera ta koca, hapshin e zgjarohshin këmbët ta ghamalli. Kur vuçari bëj këta shërbëtira, zoti i shpise mirrij mulshinë, zemran, veshlet i bëj copa copa, i diganisij ma ca kunnxervë e di pepdhinë të trasha të mbajtur ma uthullan. Lajan derkun mirë mirë ma ujë të ftohtë

Giuseppe Chiaffitelli

nga Mashqiti (Pz)

përjashta e përbrënda, ndajen shqepin ta ghamalli e vejan di kelma të ehjura e të ngulur ta a prera kurizit e ta ajo a barkut, pe të mbajan zgjaruar gjëmsat a derkut. Gratë, si kishan qëruar mirë zorrat, i vejan ta një kusi ma ujë të ftohtë e skorçë narënxash të i japen ca erë të mirë. Adhe plënxin a mbrazjan, a piqjan pak ta prushi e prana i shkulanj lëkuran a brëndëshme e a vejan bashka ma zorrat. Nëng harrojan të shkulanj nga kurizit derkut qimat më të mbdha çë i duhshin skarparit pë t’bëj “kaptjelin” ma malan. Fshijat qimat e lajen mirë përdhe. Djelmërat (u) nëng vejan jasht ta udha pë të lozjan, po mbetshin ta shpia rreth derkut e, ma një thikë fshehur, prisjan copat mish sa nëng kish njihij a prera (ishan mjeshtre!). Lëjan derkun di o tre ditë pë të ftohshij e ngurshij e pas a “spëtacojan”, domethënë a prisjan mbë copa e a ndajan: brinjat, shpatullët, përsutët; e copat lardhe e vëndreshkë i pustojan ma kripë pë një javë më pare sa t’i vejan vjerre ta huri; kocan, këmbët, veshët, bishitin, vukullarin, eshatr ma shumë kripë i vejan ta “starolal” o ta një kantar. Ma shpatullat e tjerat mishra të muskulvet bëjan lëkëngat (sallcicat), ma mishtë a “razhallit” e lardhte e vukullarit bëjan sallamat; ma mish shumë të majmë e veshlët mbushjan zorran a gjere e bëjan “pecendin”. Gjithë prisjan ma hare mishte a sallcicas e djlmrat (u) nga dica piqjan ta prushi vatras ca mish e a hajan, kaq pë të shihjan ndë ish a mirë pë kripë. Mishit të sallcicës i shtijan mbi kripë plëh pepdhini e farë mëraj, e prana a mbrujan. Kur ma një “mbutil” ramja mbushjan zorrat, ma një lëpër i bëjan shumë gavera pë bë t’i dil jasht gjithë ajri sa ashtu zorra mbushij më mirë, mishte mbetij më shtërënguar e shtipur. Sallcicat të glata pak më se një metër e të pjerrë katrësh, vëshshin vjerre ta një hu përpara vatras, pe të tershin e mbetshin atje njera kur nëng u kishën terur mirë e zorra nëng ju kish ngjitur mishit. Djelmrat (u) ruajan gjithë atë “ghraxja Krishtit”, a hajën ma sitë, po nëng mundjan t’a përvojnë. Hria a hullonë trutë! Ndë sallcica ish a lidhur, i bëjan njetër të lidhur pak më mbi, e prisjan ate çë ish ndën; ndë ajo nëng ish a lidhur, ma di glishtra i nxirjan mishtë, si milët një kapiq dhija. Sallamat i vejan ndën një gur pë pak ditë e prana i virjan llargu nga voha vatras pë të tershin. Ma gjakun bëjan “sanxhiqin” e jo “pixan” ta turtieri si nan’: mbushjan zorrat ma gjak të bashkuar ma ca cukër e çikullat, i lidhjan ma peun e i ziajan. Gjitonëvët i dërgojën, ma një djal, ca mish, ca lëkur e një copë sanxhiqi, pë “presend”. Derku ish bēgatēria e hareja shpise, sa, pë mot mot, gjithë fēmila gēzonij kur ta triaza kish pë të ngrënë gjagjë të derkut.

Jeta Arbëreshe

**(8 vjet: 2002 - 2009)
64 numra, 1.088 faqe**

**gjuhë, kulturë e lajme ka Arbëria
e ka Bota Shqiptare**

**400 euro
(për Istitucionat 600 euro)**

Një mot i harruar

Giuseppe Mario Miracco – Motimadh

ka Shën Sofia (Cs)

Ajo histori që pjakat tona mbajtin mbë zëmër, e prisin njeri të ja rrëfijin sa t' mos birej, ngaherë që qe e rrëfir prit atë njëri që, sa t' mos gharrohej, prir e rrëfinij, si këtë cop që vjen apriasu, e vën ndë shesh ka grupi "Shqiponjat" ndë mojn e gushtit 2008:

Vuxhë jashtë valles

Thanasi e Anmaria

Kjò e bukur gjitoni, ka gjithë e bën vandi.

Një der katoqi e një lloxhët, që façonjen te një shesh.

Bie kambana mbë gharë, gjithë ndë shesh pjot me hje.

Anmaria te lloxheta, pret Thanasin e ronxar si bjeta

Somanat ai tartanoj, kush e di kushë e pengoj.

Këndimi kukez:

Java madhe është arrvon, ndrikulla kuke zë e këndon

Gjindja e pret me llegri, sa t'zër hijromëri i ri.

Vashzit ven ka udha kroit, i pinjen vjet' t sa t' i martonjë.

Edhe pjaka qet qet, i pin vjet' t ç' i jep kjo jet.

Gjëmbi:

Sa e bukur kjò lloxhet, kur shkonnj duket se fjet.

Do t' thorrë se Anmaria, të do mir vetem tija.

U e runj me trëmbësi, i thom Janarit "e do kët krushqi?"

Trandafila nd'at spundun, më ruen si arçilùn

E më thot "Menat vjen maj, një deg gjëmbi ec e çaj.

Pjot mall e xigarele, vëri dhe di karamelle.

Pra kur gjindja vete fjë, te sportjeli vete ja vë.

Anmaria manat kur zjoghet, me kragh hapt te xerku të shillohet".

Trokomei kuq

"Sonde, Thanà, nga rri me ne, se Anmarin zëmi mbë pe.

Nxjermi fodhra trokomei, kush e çon të kuq bën gjelin.

E ndëse e çoje ti, mënd e puthje at Anmarin.

Të parin t' kuq e çoj Rina, ja batir te gjunjet atire trima.

Të ditin e çoi Thanasi, për pak zëmëra s' i pjasi.

Ci Sofi, lipja ti, u dua të puthinj Anmarin".

Kucari

Sa t'm' e hapinj trut e sit, kam i trughem Shën Lluçis.

Somanat një kucer kam çonj, që ka t' duket si thron.

Lalë Piskati më je strungaturin, sa t' vemi e presmi drurin.

Te mënga kroit çova një vishil, ç' ë i drej si kandill.

Ndë Janari ë i mir si thon, m' e këllet mbërënda e m' e bën thron.

Ndëse pra e rrukullisen, te cila timbë vete gramisem.

Martoreza mir e di, sa mir dua u Anmmarin.

Kucari rrukullisur.

Par sa t' dihej u zgjova, te kjò nat që gjum së çova.

Si një gozhdëz ndë tru më mbet, kucari im i shkret.

Ndëse drurin u s' e çonj, që mendim kam bënëj?

Vet ndrikulla Sofi, mënd më ketë lipisi.

Janari kucarin e rrukullisi, mallin tim m' e gramisi,

E dërgoj ndë fundë asaj llavin, sa t' vinij një e madhe qin.

Ndrikulla Sofi, si kam e bënëj, pa Anmarin u së mënd rronj.

Fosi madh vete e shëllohem, pse ka malli së mund harrohem.

Si thuet Këmarin

Maria Assunta Fazzano

ka Këmarini (Cb), mban bashkë Sportelet Gjuhësorë të Molizit

(vjen nga nmri 64)

nxathur a piedi

nxëvuor sporco

pak pl. pakra poco

plaku ngë dish vëdisi pse dish mësoj – il vecchio non voleva morire perché voleva imparare

primt- i pl. primtra genitori

pse perché

rej – a pl. rejra nuora

ronj vivere

shoh vedere

shtun sabato

sirmie di seta

sprasmi ultimo (non è stata trovata la forma determinata)

të çanj kanielet ta këmba – ti spezzo le gambe

thonj/thuoj pl. thonjë unghia

tumac (pl. ind.) tumact (pl. det.) tagliatelle

u rit thuoi – è cresciuta l'unghia

ulëm a digiuno

vete mbë këmb – vado a piedi

viehër - i pl. viehërit suocero

viehër - a pl. viehërat suocera

Dhëndrri lëti.

Pa t' vinij një lëti sa t' na vithë të bukuren Anmari.

Sa ngamat u bë Janari, nderon t' bilen me di kurala ari.

Edhe lulave te lloxheta, sonde ju mushartin fjetat.

Gjitionia u mëri e shërton, për ndjet ktij matrimon.

Nrikulla Sofi rri tue spasjuer sa t' njogh dhëndrrin e vanduar.

Tue ju truajtur Shën Mëris, t' i ghapinj trut Anmaris.

At lëti me nëm e mbioj, sa te skalluni çambikoj.

Të kalluar.

Nëng sosnij ai lëti, që do t' na vidhë Anmarin

Edhe një brigand i zi, na cuparti Shën Sofi.

Tue sërritur, tue mallkuar, Anmarin erdh na muar.

Mbalë kraghëve e ngarkoi, doj t' e kallarnij ka përroi.

Ci Sofia si petrit, "popo popo, Thana!" thërrit.

Me një përprush picut si ghell, ai brigandit i bëri çer.

Pra një te kurrizi i ndëndi, sa u gramis e ra te gjëmbi.

Vallja nuses

Gjindja që erdh sonde na çoj, zëmëren pjot mall na mbjoj.

Gjitionia ka t' mbahet mendë, me një bukur momend.

Gjithë te sheshi marren piesë se Thanasi dhënder u vesh.

Anmaria del te lloxheta, i qeshnjën lulet edhe fjetat.

Një murr djal e rrethonjen, te kendar vallëzonjen.

Dilni gjithë te ki shesh, se dhe nusja na u vesh.

Sa t' mbullimi:

Gjindja që erdh e na çoj, zëmëren pjot mall na mbioj.

Buartim ndrikullen Sofi, vate mbë krua o ndë shpi.

E pan bashkë me ci Marjellen, ç' ikjin tue qeshur si dele.

Me di besa lehet i kshteu, një per qillin një per dheun.

Një gjiton e një lloxhet, të rrimi bashkë, mos rrimi vet.

(vjen ka faqja 6)

Le Icone Badessane ...

L'Eparchia di Lungro, volente o nolente, continua a non seguire degnamente il suo "avamposto" settentrionale di Villa Badessa. Gli strumenti di partecipazione e di consultazione cittadina per l'amministrazione parrocchiale, il consiglio parrocchiale e il consiglio economico non sono rinnovati da 4 anni. Gli stessi anni della nomina di "reggente" in loco della parrocchia come viceparroco di Mircea Coros, la cui effettiva nomina a parroco è congelata e in attesa ancora di definizione. Le buone intenzioni dell'ente locale, ma soprattutto l'intera comunità badessana, pervasa in questi anni da una "lodevole comprensione" cristiana, meriterebbero finalmente una cordiale e fattiva vicinanza diocesana per lavorare tutt'insieme ad una moderna ed attrezzata "oasi orientale", che sia luogo di culto e contemporaneamente di offerta culturale. La soluzione migliore per conservare, valorizzandola, un'identità religiosa e culturale, giova ricordarlo, unica in Abruzzo. Un progetto che, in sintesi, potrebbe essere un volano per lo sviluppo sostenibile non solo della frazione di Villa Badessa ma dell'intero territorio comunale di Rosciano.

Një Kalimere e farruar

Angelo Matrangelo

ka Firmoza (Cs)

Kur isha i vogël, ka gjitonia ime ishin shumë pjaka, ishin gjithë të veshura arbëreshe, të bukura, të mira e të urta. Nganjë ndër ato dini të bënej shumë shurbise, ma atënjë që dijnë të bëjnë më mirë me ne të vegjil ish ajo se të na rrëfajnë përllazet e kocëkazele e kështu na, si zogaz afër kllasavet, mbijdhshim e gjegjëjmë ture hapur veshët e zgardhallisur sitë. Njera ndër këto ngjë dinej përllazet po vetë kalimere e parkalesje të ndrishme. Kjo ish ce Çin'e Bellizzit, dinej aq shumë se ndose i kishim shkruar, sod do të kishim librin më të shtrënjt pir ne krishterë arbëreshë. U një kalimere ahina e shkruajta e jo se ish më e bukura, ma pse ce Çina na thoj se zoti (prifti) ngjë doj se të këndofej më qishë se ng'ish "kanoniko"; ish "apokrifto" e kështu nani gjindja e farroi. Ju dërgonj të parin copë të kësaj kalimere që mua më duket "kanonike":

Nutixja

Nutixja i vate s'jëmës // oj se i biri ish ndër kriqë
u nis ndë atë këmbë // se të vej t'i me shif
birin e saj e gjet // oj e ndë një kriqe i vjerr
zu fill e m'u batir // oj e nëng la fare çerë
të birin e Shën Pjetrit // oj Krishti m'e dirgoi
thuaj të qetet mëma // e mos të më rrëkoi
u të thom të ngrëfesh // e të vish ti me mua
se u ka biri yt // oj qeva i dirguar
u të thash të vesh // e mos më ngulltar
se biri im vdiq // e nëng është më i gjall
ka kriqja e nxuartin // e ndër duar s'jëmës ja vunë
i sfraxhillartur bir // e nëng ka si t'i të mbanj
si do e prir e jëma // oj atij i dil gjak
se i nimroi vërat // oj e kish shumë, jo pak
kish ndonj triqind // e tridhjetë e gjashtë
e jëma ja mbulliti // gjithë me mbumbak
e pra ç'ja mbulliti // tha një ju shifnie vetë
se si m'e vranë // oj birin tim i shkret
e ruajtj ndër kocët // oj me gjithë atë kurorë
tha popo biri im // moj sa dhëmbje shkoi
m'e ruajtj ndër këmbë // e m'e pa të gozhdjasur
tha popo biri im // oj sa dhëmbje ke pasur.

...E le allettanti promesse

dr. prof. Gaetano Passarelli

autore del libro sulle Icone di Villa Badessa

Caro Beppe, sono contento che tu abbia scritto questo, ma la problematica ha sfaccettature molto più complesse e volutamente tenute in ombra.

Prima di procedere, però, nel mio discorso è bene che faccia una premessa: sono un anarchico mentale", cioè non tengo per alcuna amministrazione, o partito o chiesa, perseguo per quel che è possibile la verità.

La pacificazione di un ambiente si ottiene solo quando è chiara la verità. Allora vorrei fare delle precisazioni e porre dei quesiti.

Fermo restando che sono l'Autore del libro e non il curatore; fermo restando che il libro è stato finanziato da soldi pubblici; fermo restando che ho fatto il lavoro con tutti i permessi possibili ed immaginabili fino ad una certa data, cioè fino a quando ho fatto rilevare che la rimozione dell'allora Parroco è stata fatta contro ogni norma del Diritto Canonico, passo alle precisazioni.

La scorsa Amministrazione è stata letteralmente "trascinata" in tribunale dalla Diocesi e sono testimone dinnanzi a Dio di quanti tentativi sono stati fatti dall'allora Sindaco e Vice-sindaco per evitare un simile "scandalo". Perfino dopo il primo grado si è espedita ogni via senza alcun risultato.

Passo ai quesiti. Da cittadino mi chiedo: l'attuale Amministrazione aveva tutte le facoltà per cedere i diritti alla Diocesi? Si badi bene: la pubblicazione non ha alienato la proprietà, anzi l'ha rafforzata e vincolata al luogo.

La domanda nasce da una doppia considerazione: si possono cedere i diritti di una pubblicazione finanziata da denaro pubblico? L'Autore, in tal caso io, non ha ceduto i suoi diritti a nessuno: come mai non è stato neppure interpellato?

Una considerazione finale: Si possono cedere i diritti di una pubblicazione proprio a quell'Istituzione che ha chiesto la distruzione della stessa e, per questo motivo, ci sono stati due gradi di giudizio?

FJALËT I MERR AJRI, SHKRIMI QËNDRON

- "In ogni festa parrocchiale vi siano tutte le icone delle feste principali e siano esposte alla venerazione dei fedeli in occasione delle rispettive festività" (*ibidem*, 180, pag.87)

- "E' severamente proibito introdurre nuove statue in chiesa. Secondo il Sinodo di Grottaferrata, le statue devono essere sostituite con le icone" (*ibidem*, 181, pag.88)

- "Nelle processioni in onore della Madre di Dio o dei Santi siano portate le corrispettive icone bizantine" (*ibidem*, 183, pag.88)* (...)

* Eparchia di Lungro degli italo-albanesi dell'Italia Continentale, Dichiarazioni e Decisioni della Ia Assemblea Eparchiale - 1995-1996, Mit, Cosenza 1997.

Intervistë zotit Manuell Giordano

Treni më llargoi ka gjiritë e më qasi ka lnozot

(vjen nga nmri 63)

- Nder vitrat '30 e patë ndonjë herë peshkopin Mele? Te Qisha e Frasnitës o te shpia juaj?

Peshkopin Janj Mele të parën herë e pe te Qisha e Frasnitës, kur bënej krezmimet. Ishen me mua edhe shokë e shoqez; kishem bënur Katekizmin mbë qishë e mbanj mend zotin Viçenx Frashinin, çë më një kallmër të gjatë i binej atirve çë nëng gjegjjen o foljen me shokun mbanë. Të dijtën herë, e këtë e kujtonj mirë, tek muaji i llonarit të vitit 1933, Peshkopin Mele e pe tek shpia e zotit Frangjisk Kamodeka, prift i Purçillit. Peshkopi vej për gjë ditë bashkë me të ndë detit, se të mirrë diell. Ahiera vajta me mëmën te Peshkopi se të më truanej të hija te Seminari i Grotaferratës. E mbanj mend ankora fjalët çë thoj: "Shohmi nj'çik ndë mund bëhet". Më rrëfianë tata se Peshkopi Mele, më parë se t'ish peshkop, vinej e skomollisej tek zoti Lalë Bilotta.

- Çë këshile ju jipjen prindët për t'ardhmen tuaj?

Prindëvet të mi i kishen qëndruar stisur ndër tru fjalët e zotit Lalë, papas Bernard Bilotta, çë thoj: "Një bir ndë fëmilet ish mirë të bëhej prift; e këta Vjershet e mi - çë thërrit "bilzit e mi" - s'kanë të biren, po ka t'i marrë, e t'i ruanj, një çë i ndëlgon". E kanë qënë edhe parkalesjet e tij ndëse u dolla prift. Prindët pënxojen edhe se ish mirë për mua të bëhështa i urtë, e të nderoja shpinë. E më se gjithve i pëlqenej mëmës, çë s'shih heren të më shih çë studhjarja.

- Çë ju tha tata juaj kur xu se do t'bëhshit prift?

Tata ish i nipi Binard Bilotës, edhe njeri qishje, ku vej e këndonej edhe me òrganin. U veja pas atij mbë qishë e xura ka ai këndimet qishtarë të tradhitis, çë mbësöhëshin te Kullexhi-Seminar i Shën Mitrit, ka priftrat arbëreshë të ritit Bixantin-Grek. Është vërtetë se tatës, bujk e delar, me t'vaturit tim Grotaferratë, i iknej një ndihmë, me gjithë se ishen të tjerët bil çë e ndihjin. Po kish hare ndëse bëhështa prift, sepse mbanë mend Binard Bilotën, lalën e tij: ç'ish i urtë, i bënej mirë gjithve e ish i dashur mirë ka gjithë.

- Kush u interesua të dërgonej kërkesën tuaj te Seminari i Grotaferratës?

Se të veja Grotaferratë, parë e më parë u interesuan prindët, çë ja thanë zotit Frashin, priftit t'Frasnitës, i cili patë shumë hare. Zoti Frashin i dërgoi Pëshkopit pyejtjen, e Ai e dërgoi Grotaferratë.

- Pat e prisjet shumë përgjegjjen? E ju, ndërkaq, çë po mendojet, çë po bëjet?

U "isha ndër gjëmbat"! Veja e vija ka mali e ndër dherat, e trëmbsha se s'mund veja më Grotaferratë. E tata s'mund më dërgonij, me t'paguar, te xhinasi ndë Horet (Castrovillari) o gjetk.

- Kur erru përgjegja ka Peshkopi, ju ku gjëndshit? E ç'bëtë?

Atë ditë kur erru përgjegja ka Peshkopi, ndë fund të vjeshtit, u gjëndsha ndë malt, se kisha fjetur atje atë natë. Mora llitrën çë vinej ka katundi, e hapa, e djovasa e vajta tek tata, çë ish e bënej dru te voshku, tue thërritur ka hare. Ai më qetësoi; po u mbjatu u nisa mbë këmbë ture ngurtur se t'errëja posht ndë katund, mbë shpi, e të ndaja harenë time me mëmën e me motren time, Ngjiskë.

- Prindët tuaj qenë të gëzuar?

E tërë fëmila u gëzua, patë hare kur xu se u kish të veja te

(intervistoi) **Agostino Giordano**

ka Purçilli (Cs)

Seminari i Grotaferratës. Sepse gjithë më dojin mirë e dojin të mirën time.

- Kush ju qelli Grotaferratë?

Rromë më qelli tata. Ish viti 1933, viti i Shëjtë. U bashkuam me piligrinat kalabrezë e, me trenin, vamë Rromë. Atje fjetëm një natë e, ditën pas, vizituam Papën, çë edhe na foli, te qisha e Shën Pjetrit. Ditën pas shkuam Grotaferratë.

- Cilët qenë, gjatë atij udhëtimit, ëndrrat e shpresat tuaja?

Mbanj mend se mendoja se ish e ndërroja jetën time, se soteparet përpara meje s'do të kisha parë më dele e dhi e vreshta, po vetëm skollë, libre e qishë; e ëndërrja se isha xha prift, se thoja meshë e se i mbësója popullit Fjalzën e mirë.

- U penduat ndonjë herë për atë tren çë muartit, atë ditë, çë ju qelli llargu ka gjiritë e më afër Tinzoti?

Gjatë studimevet, ndë trimëri, kam pasur ndonjë mendim të prirështa te jeta; po, si u rrita, më ra nën sitë ajo e thëna e Jisu Krishtit, te Vangjeli, çë thot: "Kush vë dorën te parmenda e ruan prapa, s'është për rregjërinë e qielvet". E vajta përpara, ngaherë me ndihmen e Tinzoti, çë falënderonj ngadita me gjithë zëmër.

(5 – ka më)

Një Vjersh

Ajri Shin Mëris malit

Vincenzo Straticò

ka Ungra (Cs)

(si e këndon Moti i Parë: *con organetto diatonico dolcemente in 3/4*)

M'i vajta Shimëriemal, e m'i vajta Shimëriemal
m'i vajta Shimëriemal e më 'mbeta një dit (2 herë)

Ngj t'pë tij zëmire, ngj t'pë tij zëmire
ngj t'pë tij zëmire e m'u duk mot mot. (2 herë)

M'i vajta Shimëriemal, e m'i vajta Shimëriemal
m'i vajta Shimëriemal e nusen ng'e pë. (2 herë)

M'i piejta shokezit, e m'i piejta shokezit,
m'i piejta shokezit e më than se ng'ë (2 herë)

E çuk mbi çuk venjë, e çuk mbi çuk venjë,
e çuk mbi çuk venjë si korb i zi. (2 herë)

U venja ture thriritur, u venja ture thriritur,
U venja ture thriritur mall ku jë (2 herë)

E vetim venja mall, e vetim venja mall,
E vetim venja mall e zëmëra ngi m'le (2 herë)

Një vullundat m'e thoj, një vullundat m'e thoj,
një vullundat m'e thoj priru popa (2 herë)

E vajta e gjeta ulët, e vajta e gjeta ulët,
e vajta e gjeta ulët ket një fagarë (2 herë)

Zef Beccia

nga Kazallveçiq (Fg)

Vjeshtë

Ta lulishte të shpis,
ndën një lis dhë dardhë,
ma një rrëkrëjan dhë hekuri
ma dhambëtë të shtrëmbëra,
punoja dheun.
Një shumicë dhë arca
sukoin lulët dhë një rroqia dhë rruket.
Një hera a holla tundi fletet
shum ngjyrësh të dardhit.
Nji diell i kuqi çë vei ta thesi
bëta furfurisën gjith fletet.
U mbeta ma griken hapr.
Pas ngë peva mosgjë më.
Syt ishin plot dhë llot.

AUTUNNO - Nel giardino di casa, / sotto un
albero di pero, / con una forca di ferro / dai rebbi
ricurvi, / lavoravo la terra. / Una moltitudine di api /
succhiavano i fiori di un cespuglio di rucola. / Un
vento sottile muoveva / le foglie multicolori del pero.
/ Un sole rosso tramontante / faceva luccicare tutte le
foglie / Sono rimasto a bocca aperta. / Poi non ho
visto più niente. / Gli occhi erano pieni di lacrime.

Enza Cetera Scutari

ka Fameta (Cs)

Gjellinj*

Ti më the:
- *Kutëndoju
me një kutull hirrë
mos dishirë gjizen
çë s' mund kesh.*
Tue pirë hirren
si qentë
lavdërova tën Zon
Prana më the:
- *Kutëndoju
me një pikez ujë
ndë hirra u rrit.*
Tue pirë ujet
si zogj të lumë
lavdërova tën Zon.
Kur të rritet edhe ujet
do të jem te mali i lart
e do të fal edhe tën Zon.

VIVERE – Tu mi hai detto: / Accontentati / di una
scodella di siero / non desiderare la ricotta / che non
puoi avere. / E bevendo il siero / come i cani / ho
lodato il Signore. / Poi mi hai detto: / Accontentati /
d'una goccia d'acqua / se il siero è finito. / E bevendo
l'acqua / come gli uccelli nel fiume / ho lodato il
Signore. / Quando sarà finita anche l'acqua / io sarò

già sulla montagna alta / e ringrazierò ancora il
Signore.

* Poezi e nxjerrë nga libri “Bubuqja-Gemme”,
Lavello 1984, faqe 37

Vincenzo Borrescio

(1927-1995), ka Ungra (Cs)

Vapa*

Nxora të leshtat dhe xhaketen
sa erdh vapa që ngrofi jetën;
kudo mbeta nën zura rrëçet,
sa më pinja, më më vinej et.
Kur u vura nën njëj lisi,
një fjtur veshin më digëlisi.
Gugurojën dy guguçe
dhe rrëmbinej hardhja një maçe.
Fjeta dhe pata par një'ëndërr
njërma sa më zgjoj një cinxërr.
(1992)

* Poezi e nxjerrë ka libri *Poezi arbëreshe – atjè ka
qjelli puthin dhenë – laddove il cielo bacia la terra -*
, 1992, faqe 178.

Marienza Di Lena

ka Munxhufuni (Cb)
Shkollë e mesme, klasë II

Bie shi*

Bie shi
isht natë, natë a zeza,
një vumët i madhi, e atia bie i keqi.
I ligu kljeti shekui
çë tërgojti ka ajò natë a zeza
shiuu i zezi ka dheghu ta Abrucit.
Pas u zgjuhën ditën pas,
bie shi,
bie papà,
bihe bashk ma lot ta sivet
ka faça ta të vogëlet e të mëdenje,
çë borën gjisena.
Kljanjën zëmëret përpama mortjes,
çë ka të runjën përpama.
Bie shi,
bie papà,
ma doglu arku ma kugluret,
kughure ta spërenxës e ta dashuris.
Nani bie, bie dashuri.

PIOVE – Piove / E' buio, notte fonda, / un forte boato,
e li ecco piove sventura. / Crudele è stata la natura /
Ad impartir tale sciagura che in quella notte buia /
fece piovere in terra d' Abruzzo. / Al mesto risveglio
del di seguente, / piove, / piove ancora, / piove un

misto di tristezza, angoscia e sgomento, / lo mostrano
i visi di grandi e piccini, / han perso tutto. / Piangono
i loro cuori alla presenza della morte, / ma il coraggio,
la forza e la fierazza non viene lor meno. / Piove, /
piove ancora, / ma l'arcobaleno è apparso già, / vivi i
colori del coraggio e della solidarietà. / Ecco, adesso
piove amore.

*Një poezi e shkruar në kujtim të të vdekurvet të
terremotit të l'Aquila-s.

Annamena Russo

ka Ferma (Cs)

Përjetësia jote

U ngre ndë qillit
dhe është ëngjuull Parrajsi.
Do të shokësh qillin
e ajo do të jetë dill,
sa ti të dritësonj jetën me hare.
Do të shokësh natën
e ajo do të jetë ylli,
sa ti të shronj zëmrenë ka errësia.
Do të shokësh lulet, sheshet të gjelbra,
arvurët ulliri shekullor
e ajo do ti të mbjedh,
sa të t'jap sigurim, fuqi dhe kuraxh .
Do t'ë gjësh tek ajri ngroktë ndë verë
pse do qeshjat e saj;
do t'ë gjësh ndër ditët shiu
pse përfaqimet e saj, shpirti kan ti të
ngrokjën.
Do dashurin, e trëmbe
dhe kshtu e do me tij
pse do ti t'jap lirin të vallzosh dashurin.
Ngaherë,
ti gjëje, ruje, duje mirë,
pse ajo është Përjetësia jote...

LA TUA ETERNITA*

E' salita al cielo
ed è diventata angelo del Paradiso.
Guarderai il cielo
e lei sarà sole
per illuminare di gioia la tua vita.
Guarderai la notte
e lei sarà stella
per alleviare il tuo cuore dal buio.
Guarderai i fiori, i prati verdi, i secolari alberi
d'ulivo
e lei ti avvolgerà
ti darà sicurezza, forza e coraggio.
La cercherai nel vento caldo d'estate
perché vorrai i suoi sorrisi;
la cercherai nelle gelide piogge d'inverno
perché i suoi abbracci ti riscaldino l'anima.
Amerai, ma avrai paura
e così la cercherai dentro te
perché possa renderti libera di volare
l'amore.
Continua a cercarla, a guardarla, ad amarla
perché Lei è la tua Eternità...

Klara Kodra

nga Tirana

Vëllezërve arbëreshë

Midis nesh një det, -
midis nesh pesëqind vjet.

Ndër valle ndrijnë shpatat
errësirën e kohës për ta çarë.

Fëmijë shkullur nga gjiri i nënës, -
pesëqind vjet buza u është tharë.

Tej detit fytyrat e vëllezërve
si tonat – të gdhendura në gur.

Të gjitha vargjet e këngëve
mbi dallgë ngrihen si urë.

Nënës sime

Sytë e ndritshëm, flokët e zes ...
Buzëqeshja që s'e ndërroj me asgjë.
S'më hiqet nga mëndja ai mëngjes
Kur për ty koha u ndal për gjithnjë.
Dora jote e palodhur në shkrime,
Dora jote si krah mjellme e bardhë,
Dora jote e butë në ledhatime
Dergjej si krah mjellme e vrarë.

Po çaj dallgë kohe për të të kthyer,
Po veç bregu i poezisë na bashkon.
Veç kështu, mjellma ime krah-thyer,
Krahu im prapë në gji të shtërngon.

Këmbana e dashurisë

Në shpirt po bie një këmbanë.
Me tingujt e argjenditë thotë:
Dashuria lindi.
Sa do rrojë?
Jehona thotë:
"Pa fund,
pa anë!"

Në shpirt po bie një këmbanë.
Me tingujt e mbytur thotë:
Dashuria vdiq,
si të gjithë sendet
që ikën e vanë!

Në shpirt po bie një këmbanë.
Me tingujt e artë thotë:
Dashuria u ngjall.
Ajo s'vdes dot
Si gjithësia e paanë.

Fatos Arapi

nga Vlora

Mjafton dy gisht maskë

Mjafton dy gisht maskë
dhe zëri është tjetër,
e qeshura tjetër.

E vërteta me maskë.
Shpirti me maskë.

Mjafton dy gisht maskë
Dhe dhimbjen s'e ndien:
ti qan vërtet,
po maska loton.

Me maskë trishtimet.
Me maskë pikëllimet.

Shqiptarët

Në luftë flenë duke ecur
Në vdekje vdesin duke ecur.
Në këngë qajnë shqiptarët

Shpëtim Bozha

nga Tirana

**Me ty s'di sesi
mund të veproj unë...?!**

Me ty s'di sesi mund të veproj unë,
Kur para rrugës papritur të ndaloj,
Kur çuditem me ndryshimet e tua
Dhe s'di sesi në këmbë vetë qëndroj...?!
Me ty s'di sesi mund të veproj unë,
Kur qeshja të deh si gurgullim,
Kur nga dehja jote bëj se s'kam mendjen,
Se zhytem gjer në thellësi, në hutim...?!
Me ty s'di sesi mund të veproj unë,
Dallgën tënde të vrullshme s'e pengoj dot...?!
Si m'u përplas kjo erë, kjo furtunë...?!
Prej saj si do shpëtoj unë vallë sot...?!
Me ty s'di sesi mund të veproj unë,
Kur në takim më gjen porsì në gjumë...?!
(24 09 1999)

Deti dhe njeriu

Kanë thënë për detin
Se është djepi i Afërditës.
Kanë thënë për detin
Se është djepi i vetë jetës.

Si qielli i kaltër
Po jo si ai – pafundësi.
I ngjan njeriut
Që të pasqyron Ty, Perëndi.

duke dëgjuar këngët e tyre si qajnë...
Në vdekje vdesin duke ecur...
Dhe këmbë e kalojnë
Akerontin e tyre prej gjaku.

Ku është Kaini?

Mbrëmë në rrugën e ngushtë tiranase
takova Abelin gulçues që pyeste:
- Ku është Kaini?
Se unë, - thoshte Abeli – duhet të vdes,
patjetër duhet të vdes.
A e ke parë Kainin?

*Poezi të nxjerra nga libri i Fatos Arapit
"Antologji personale", Ora botime, Tiranë 2001

Muharrem Miftari

Kosovar, banon në Finlandë

Mblidhmëni eshtrat!

Mblidhmëni eshtrat!
Ju thërras me zë
Të ftohtët e natës e ndiej në shtat
Kur agon Dita pse s'vjen më?

Sytë s'i kam të mbyllur
Nuk jam në gjumë
Ndonëse kohen në sy ma dogjën
Mijëvjecarët m'i bënë shkruamb

Mblidhmëni eshtrat!
Zëri i ndërgjegjes vallë s'ju ka tundur
Edhe pse m'vranë mijëvjecarët
Vdekjen, megjithatë e kam mundur

Mblidhmëni eshtrat!
Ju thërras!

Shefqet Dibrani

Kosovar, banon në Zvicër

Gruaja Kosovare *

Në krahëror dhembjen shtrëngon...
fuqi të deves e gojë të mbyllur
ashpërsia e fytyrës jetën zbut
lëvizjet e saja janë si të ushtarakut
rënd rënd ec me trastën në shpinë
me barrën në bark
edhe kur kosa mbi kokë i rri
fëmijën çon në përjetësi.

*Nga libri i Shefqet Dibranit "Strehët e gjakut",
shtëpia botuese Faik Konica, Prishtinë 2000,
faqe 43.

At Gjergj Guzzetta Shënjt ?

Arbri Roman

nga Roma

Bëri tëtım te muaji i fjovarit, simbjët, dhe tre miqtë arbëreshë të Romes u përpoqin pakë herë. Më duket se kanë dalur rrallë edhe ka shtëpia. Jatronjtë i trëmbin pleqtë: i thonë se vjen kolla, se vjen sinahi, se vjet purmunita, se do t'vdesin ndëse marrin tëtım. Të mjerët kurrusen, shtrëngojnë shpatullat dhe shkojnë ditë e ditë pa dal fare. Shkojnë orë e orë përpara televizjonit. Kështu shkon dita, shkon java, shkon muaji. Ma të parën e Marsit u telefonuan dhe u përpoqin përpara Qishës. U faltin me harë. Ishin të gjallë e pa kollë.

Gjergji ka Hora e Arbëreshëvet kish ndënë sjetullë një libër i ri që kish marrë Palerm ku vate për një konferencë. Libri është i ri, ma të shkruajturët është i vjetër. Është i shkruajtur italisht: “Gjella e Atit Gjergj Guzzetta” (1682-1756), burr i madh për Arbëreshët e Siqlisë. Po jo vetëm, ma edhe nder i rrallë për gjithë Arbëreshët “te ku ndodhen edhe janë”. Ish kutjend Gjergji se kish atë libër me më se katërqind faqe, që doli herën e parë në vitin njëmij shtatqind nëndëdhjetë e tetë. Auktori është një prift palermitan Don Gjon D’Angelo. Libri rrëfien gjithë atë që bëri At Gjergji që kur u le njera sa vdiq. Dhe bëri shumë shurbise për t’mirën e Arbëreshëvet. Më i madhi është se krijoi Seminarin arbëresh në Siqli ku studjartin shumë arbëreshë: priftra, poetë e polikantë si Frangjisk Krispi.

-Mirë e bënë të publikojnë pametë këtë libër! Shurbiset harrohen nga Arbëreshët shumë njëze. Pra! Nani që do t’e bëjnë shëjt At Gjergjin duhet të njihet gjella dhe vepra e tij - tha Kozmaja nga Strigari.

-Kur e ke djovasur m’e shkon mua se do t’e shoh edhe u, se e gjegja shumë shumë herë ëmrin e Atit Gjergj, ma me të vërtet s’njoh gjë nga gjithë ata që bëri.

-Jo vetëm ti - ja ngjati Ndoni nga Rruri - Tek na s’njihet fare. Di ëmrin vetëm njeri që zgjodhi ndonjë histori. Mirë e bënë të publikojnë pameta. Ma denja t’ju pyenja: nani ç’i lyptin Papës t’e bënë shënjt, jan’e bëhen studime më të reja, më të dokumentuara? Nëmös Papa s’e bënë shënjt në sod në nesër. Romë duan mirakuj, duan të dinë si e konsideroi populli, që nominatë pati gjatë shekujve At Gjergji. Këtu thonë një fjalë që ngë kapirin fare, ma këtu do të njohin cili është “sensus fidelium”, cili ë opinionit i popullit. Një shëjt s’bëhet vetëm për Papën, o për kalendarin, ma për gjithë besimtarët. Është një shurbes i madh. Vërtet i madh. Edhe pakë misterjoz. Ndë Siqli jan’e i bëjnë keto studime?

-Ndë konferencë - ju përgjegj Gjergji - thanë se këto studime i kanë ndë program.

-Arbëreshët kanë sembri programe! Atë që kanë t’bëjnë sod thonë se do t’e bëjnë neser! Thonë! - tha si i rrahuar Ndoni- Neser? Ma kur është nesër?

Babuini ruaj pa thënë gjë. Ai kish studjuar logjikë klasike romane dhe s’kuptoj përse “neser” s’vjen m’e thënë “neser”. Ai s’di se Arbëreshët s’e kanë studjuar logjikën romane. Është vërtet: neser vjen m’e thënë “pas sod”, por s’dihet kur merr fill ajo ditë.

Babuini nani dukej si i zi ndë cerë, me fjalën “neser” ndë tru. Të dukej se pensoj: “Nesër Arbëreshët do t’rrojnë”?

Jeta Arbereshe + Fjalor

i Emanuele Giordano-s
Euro 50

P. Giorgio Guzzetta santo?

Ha fatto freddo nel mese di febbraio, quest’anno, e i tre amici arbëreshë di Roma si sono incontrati poche volte. Mi sembra che siano usciti di casa raramente. I medici spaventano i vecchi: dicono loro che viene la tosse, che viene il raffreddore, che viene la polmonite, e che moriranno se prendono freddo. I poveretti si rannicchiano, stringono le spalle e trascorrono giorni e giorni senza uscire di casa. Passano ore e ore davanti alla TV. Così passa il giorno, passa la settimana, passa il mese. Ma il primo di marzo si sono telefonati e si sono incontrati davanti alla Chiesa. Si sono salutati con gioia. Erano vivi e senza tosse. Giorgio, da Piana degli Albanesi, aveva sotto il braccio un libro nuovo che aveva preso a Palermo quando vi andò per una conferenza. Il libro è nuovo, ma lo scritto antico. E’ scritto in italiano: “Vita di padre Giorgio Guzzetta” (1682-1756,) grande uomo per gli Arbëreshë di Sicilia. Non solo, ma anche onore raro per tutti gli Arbëreshë “dovunque essi siano”. Era contento Giorgio perché aveva questo libro di oltre 400 pagine, uscito la prima volta nel 1798. L’autore è un sacerdote palermitano, don Giovanni D’Angelo. Il libro racconta tutto ciò che padre Giorgio ha compiuto da quando è nato alla sua morte. E molte cose egli ha fatto per il bene degli Arbëreshë. L’opera maggiore è la creazione del Seminario arbëresh in Sicilia dove hanno studiato molti Arbëreshë: sacerdoti, poeti e politicanti come Francesco Crispi. “Bene hanno fatto a ripubblicare questo libro! Le cose si dimenticano molto presto dagli Arbëreshë. Poi! Ora che vogliono fare santo padre Giorgio è necessario conoscere la sua vita e la sua opera” – disse Cosimo da S. Cosmo Albanese.

- “Dopo che lo avrai letto me lo passerai, voglio vederlo anch’io, perché molte volte ho sentito il nome di padre Giorgio, ma veramente non conosco nulla su quello che lui ha fatto”.

- “Non solo tu – continuò Antonio da Uuri - da noi non lo si conosce per niente. Soltanto qualcuno, che ha letto qualche storia, ne ha sentito il nome. Bene hanno fatto a ripubblicarlo. Ma vorrei chiedervi: ora che hanno chiesto al Papa di farlo santo, stanno facendo nuovi studi, più documentati? Altrimenti il Papa non lo farà santo né oggi né domani. A Roma vogliono miracoli, vogliono sapere come lo considerò il popolo, che fama ha avuto lungo i secoli padre Giorgio. A questo punto usano una parola che io non capisco, ma qui a Roma vogliono conoscere qual è il “sensus fidelium”, vogliono sapere che cosa pensa il popolo. Un santo non lo si fa solo per il Papa o per il calendario, ma per tutti i fedeli. È una cosa grande. Veramente grande. E anche un poco misteriosa. In Sicilia stanno facendo questi studi?”

- “Alla conferenza – rispose Giorgio – hanno detto che questi studi li hanno in programma”. “Gli Arbëreshë hanno sempre programmi! Ciò che devono fare oggi dicono di farlo domani!” - “Dicono! – esclamò come urtato Antonio – Domani? Ma quando è “domani”?”.

Il Babuino guardava senza proferir parola. Lui aveva studiato logica classica romana e non capiva perché “domani” non significa “domani”.

Lui non sa che gli Arbëreshë non hanno studiato logica romana. E’ vero: “domani” significa “dopo oggi”, ma non si sa quando inizia quel giorno.

Il Babuino ora sembrava scuro in volto, con la parola “domani” nel cervello. Sembrava che pensasse: “Ma domani gli Arbëreshë saranno in vita”?

Arketipi në simbolin e ëndrrave të Koliqit

Alma Dema

pedagoge e gjuhës shqipe
Universiteti "A. Moisiu", Durrës

Koliqi, mjeshtër i madh i prozës shqipe, i rritur dhe i brumosur me kulturën perëndimore, kulturë e cila aq sa e madhështoi në sy të të gjithëve aq edhe e bëri të vetëdijshëm se një njeri është madhështor në sy të botës vetëm kur di të ruajë e të brendësojë atë që lidhet me identitetin dhe identifikimin e tij: traditën dhe kulturën, mendësinë dhe mjedisin, elementët e prekshëm dhe të paprekshëm të botëkuptimit dhe ekzistencës së karmës së tij gjenezore.

Ai e rrëmoi dhe e skaliti këtë panoramë të nevojshme brenda vetes, sepse ai nuk deshi ta pranonte errësirën e vendit të tij e për këtë ndezi një qiri a një fije pishë, drita e të cilëve i ndriti rrugën, e ia grishi gjithmonë kujtimin, respektin dhe analizën e veprës së tij.

Është folur e vazhdon të flitet për poliedrizmin e tij kulturor, letrar e shkencor.

Sa herë që më ka munguar frymëmarrja autoktone e trajtuar me shumë vërtetësi, sinqeritet dhe dashuri, i jam rikthyer tregimeve të tij, i kam lexuar, i kam përpirë, i kam studiuar e përsëri nuk jam mjaftuar.

Duke u bazuar tek arketipet, (1) si elemente përbërës të pavetëdijshme kolektive do të dëshiroja të zbrërthenim me instrumente arketipale ëndrrën e zonjushës Netë tek *Andërr e një mbasditje vere*. (2)

Duke dashur të jem e qartë dhe e kuptueshme që në fillim, do të doja t'ju kujtoja se ishte Jungu ai, që duke u nisur nga një eksperiencë personale (në vjeshtën e vitit 1913) zbuloi e më pas konstatoi se, ëndrrat shërbenin si medium komunikues të aspekteve të thella të pavetëdijshme, konstatim ky i diskutuar shumë jo vetëm në rrafshet psikologjike e letrare por edhe mistike, fetare, antropologjike e më tej.

Nëse do t'i referoheshim çfarëdolloj fjalori leksikor, leksema ëndërr do të përkufizohej si një gjendje abstrakte përjetimi, vegimi, shfaqje figurash e ngjarjesh që ndodhin gjatë procesit të gjumit, domethënë ndodhin në mënyrë pasive e të pavetëdijshme.

Ëndërra dhe përjetimi i vegimeve të zonjushës Netë, realizohen në një mënyrë tjetër; duket se ndodhin jo si proces i përkufizimit të sipërpërmendur, por si të stisura nga shkrimtari, gjë për të cilën ne nuk kemi përse habitemi apo mendojmë se është ndonjë gjë e re!

Ajo që do të kërkojmë të analizojmë në vazhdim, do ketë të bëjë me mënyrën e përjetimit shpirtëror dhe takimit me arketipin e ëndrrës që ekziston si i tillë në

sajë të imazheve dominante dhe parimit organizues të tij (ëndërra, edhe pse shumë e shkurtër në jetëgjatësinë e saj, karakterizohet nga një strukturë organizuese e fiksuar edhe pse pjesët inferojnë tek njëra-tjetra me shumë mjegullim).

Neta, pas një debati me prindërit e saj, debat i cili nxjerr, shumë mirë në pah mentalitetin e krahinës dhe "privilegjet" që gëzon vajza që po të kishte lindur djale, do të kishte gëzuar një status tjetër (*Fajin e ke vetë ti ... qi deshte me le vajzë!*) e si rrjedhim, nuk do t'i jepte shtysë as diskutimit tonë e as të drejtën për të qenë e komentuar sipas parimit të organizimit arketipial të Jungut.

Megjithatë, vajza jonë, jo si të gjithë të rejtat e asaj kohe e të asaj krahine, mënyra e jetesës së të cilës i kishte dhënë mundësinë të pretendonte por edhe të shijonte vajzërinë e saj, përjeton ëndrrën në mënyrë pasive në kuptimin që ajo nuk bie për të fjetur apo dremitur, madje ky proces nuk kuptohet as nga pika e lidhjes së veprimit apo nga rendi i ngjarjeve të ndërtuara mjeshtërisht, mbi bazën e simbolit, nga Koliqi. Ëndërrimi si eksperiencë e gjumit as që pranohet nga rrjedha e veprimit, sepse atëherë kur mund të mendohet se ajo ka filluar të ëndërrojë, tregimtari do të na bëjë të kuptojmë të kundërtën, se ajo nuk po ëndërron, por se gjithçka po procedon sipas rrjedhës së arsyes kronologjike – *Jo, nuk i bie kurrë pa nota – tha Neta, e padashur u skuq si të ishte gjetë në faj.*

Domethënë ëndërra e saj apo ai lloj përjetimi i aprovuar më parë

(...Disa rritura tërhiqshin vërejtjen. Sa hlynte njeriu në odë, nalt në mur përkundër derës, një zotni i gjatë – veshë me benevrekë, me anteri të mëndafshhtë, jelek të zi, çarapë të bardhë, këpucë të shkurtra lustrafini, tanuz të vumë mbi njanin sy e tuftën qitë mbi krah, – të pritte me një buzëqeshje të hollë e t'ambël: xha Filip, vllau i gjyshit të Netës. Ma poshtë ishte fotografija e dy grave të hijëshme: njana nuse, me sallman plot lagjuhera ari, me katër rrjeshta dupash në parzëm me unaza të mëdhaja ndër gishta; tjetra vajzë me bishtalec të lëshueme, me një fytyrë të vogël e të kandëshme ku pasqyrohej një mituni e freskët. Ishin halla Zeze e halla Gjysto, dy motrat e axhës Filip.) (3)

sipas tregimitarit, nuk ka të bëjë më të, por me diçka tjetër, që mbase ai do ta lidhë me instruktin e njeriut për të krijuar situata të vërteta edhe kur nuk ekzistojnë vetëm e vetëm për të dalë nga ajo ku ndodhen apo për ta ndryshuar atë. Sërish

Koliqi, do të përdorë mjeshtërisht simbolikën për të transmetuar ndjenjat e fshehura të njeriut, të cilat dalin në pah në momente të veçanta kur ai ia ka nevojën apo nuk e kupton as vetë kur bëhen të pranishme në mënyrë të pavetëdijshme, por asnjëherë, pa patur një shtysë e një ngacmues të jashtëm.

Në rastin e Netës sonë, ngacmuesi vjen vetvetëshëm dhe i pashmangshëm, sepse nëse i ati do t'ia kishte plotësuar dëshirën për ta dërguar për pushime diku larg Shkodrës (ashtu si bënte çdo verë tjetër), ajo nuk do të ishte mërziutur, nuk do të kishte kërkuar mjete për të larguar mërzinë e saj e si pasojë nuk do ta kishte zënë gjumi!

Megjithatë, le të ndjekim rrjedhën e kujt ku duket se po i drejtohet mullirit të Koliqit, le të pranojmë se ajo nuk fjeti e nuk ëndërroi, vetëm se solli në mendje, imagjinoi, ëndërroi me sy hapur (e kam të pamundur ta përjashtoj këtë term) një skenar të mirëpërcaktuar. Neta, ndërmjet habitës dhe mënyrës në të cilën vepron në "ëndërr", na jep të kuptojmë se ajo ndeshet me një prirje të pamësuar e i gjithë përjetimi ndodh në një mënyrë të caktuar, pikërisht ashtu siç përkufizohet edhe arketipi. Ai vetë nuk ka formë, por vepron si "parim organizues", mbi gjërat që ne shohim edhe bëjmë; ai funksionon po në atë mënyrë që funksionojnë instiktet.

A nuk mund të themi të njëjtën gjë për përjetimin e Netës? Ajo ndeshet me një prirje jo vetëm të pamësuar, por edhe të aprovuar më parë: axhë Filipi dhe hallat, nuk ishin pjesë e kësaj bote, ata kishin kohë që kishin vdekur. Tashmë, ishin thjesht të kornizuar mbi mur e moshë dhe eksperiencia jetësore e saj ishte aq lozonjare sa edhe tekati e saj.

(I ati e përcolli me sy dashunisht deri sa doli prej ode. E donte fort pse at vajzë të vetme kishte. Përpiqej me i plotësue ç' do dëshir, me i çue në vend çdo trillë: shkurt e kishte llastue.)

Pra, duke ndjekur logjikisht arsyetimin jo duke përjashtuar arketipin, por mundësinë e Netës për të qenë mbartëse e arketipit, do të thonim se edhe kur arketipi nuk gjen një person të caktuar të gatshëm për t'u bërë bartës i tij, dukuria prirret të personifikojë arketipin, pra e kthen atë në një personazh mitologjik ose, si në rastin tonë dukuri mistike, (zani i hallës i kumbonte në vesh me ambëlsin e pashoqe të një zani qi vjen prej së largu. Oh prej një largësjije të pakufishme!)

biologjike, fiziologjike etj. Pra, ëndërimi i saj – unë këmbëngul me këtë term, duke dashur t'i bindem Koliqit, se ajo nuk fjeti, përjetoi me sy hapur e shidoqoftë në rrënjë të dukurisë gjendet ëndërra – është një arketip edhe sepse u përjetua kolektivisht.

Koliqi, që në nisje të këtij diskutimi, është munduar ta mbrojë personazhin e tij, përjetimin dhe dukurinë e këtij përjetimi, deri në momentin kur vetë Neta do të ndërgjegjëzohet për veprimet e saj e do të mendojë:

Neta u suell, por s'pau kurrkund n'odë. Shikoi ritratat: axha Filip ishte mbrenë në suazë e kishte, ndër buza, e shikojshin mallëngjyeshëm nga fotografia. Fërkoj syt e u çue.

- *Mos kam pa andërr? – bani me vete.*

Jungu, do ta përkufizonte arketipin si një vrimë të zezë në hapësirë, ku kjo vrimë nuk ka formë, nuk preket apo shihet, e ekzistenca e saj provohet, vetëm sepse ajo thith lëndë dhe dritë në brendësinë e saj. Edhe ëndërra e bukur e asaj pasdreke vere e zonzushës Netë nuk ka formë, as preket e as shihet në kufij të përcaktuar, sepse lëviz e transformohet sa nën drejtimin e tregimtarit, sa nën magjinë e vetë tregimit, sa nën mrekullinë e mendësisë dhe mënyrës së jetesës së qytetarisë shkodrane, sa nën simbolikën që bindshëm udhëheq rrëfimin e Koliqit, megjithatë, ajo ekziston sepse thith vëmendje, subjekt e objekt, thith kureshtje, dëshirë e pasion, por edhe lëshon dritë, besim dhe siguri edhe pse është vetëm një ëndërr:

Duel në çardak e hodhi një shikim n'oborr nga dritoret e mëdhaja, të çeluna. Shtëpija e oborrit kishin një fytyrë tjetër. E Netës i u ba se dikush, n'at mbasditë, i a kish ndërreue syt e përparshëm tue i vu në ballë dy tjerë që shifshin ças s'kishte pa në dit të kalueme.

Sy ma të rinj a ma të vjetër?

Arketipi i ëndrës e i imazheve, në të cilët ndërtohet e funksionon, "ndërton" një mënyrë që reflekton mjedisin tonë evolutiv.

E Neta nuk e kuptoi se atë pasdite vere kishte ëndërruar ëndërrën më të bukur të moshës së saj...

1) Jung, Karl, Njeriu dhe Simbolet e tij; 2) Koliqi, Ernest, Hanë Gjaku, Tregime dhe novela të zgjedhura, Apollonia, 1995, fq. 100; 3) Po aty, fq. 103.

L'archetipo nella simbologia dei sogni del Koliqi - Koliqi resta senza dubbio una delle personalità con uno status particolare nella cultura e nella letteratura albanese, e per questo, comunque ti sforzi a studiarlo e a identificarlo, non puoi arrivare a questa conclusione. Mi sono seduta a scrivere di Koliqi, non in modo precipitoso; ho pensato tanto prima di analizzare il suo sogno con mezzi junghiani, l'ho riletto molte volte; e ogni volta che l'ho riletto tanto più mi convincevo che in esso si trovasse elementi del realismo magico e uno di questi era il sogno provato attivamente in maniera passiva. Koliqi riesce in questo mettendo in funzione dello scritto (egli non fa semplicemente letteratura e non parte da questa per scrivere, egli ti dà l'impressione che più che scrivere desidera perpetuare) tutto il suo arsenale culturale e artistico, ma soprattutto sapendo nutrirsi bene sul terreno, lì dove si mette in viaggio il concepimento e la formazione delle sue idee. Ho studiato Koliqi e continuo a farlo e posso dire senza paura che la sua concezione del mondo, più di qualsiasi altro, è autoctono e al servizio dell'autoctonia. "Il sogno di una notte d'estate" è uno dei suoi racconti, che in se stessi, per quanto riguarda profondità, interpretazione e sottintesi, possono essere trattati anche come novelle. Koliqi mi ha stregato fin da piccola e continua ancora a farlo.

(vjen ka faqja 3)

Simon Filipaj dhe Bibla shqip

dom Nikë Ukgjini

nga Shkodra

Bibla Shqip, kulmin e promovimit të saj e kishte arritur, kur më 24 tetor 1994, Ati i Shenjtë, Gjon Pali II, priti në audiencë Imzot Filipajn së bashku me Imzot Rrok Mirditën, kryepeshkvin e Durrës-Tiranës dhe dom David Xhuxhën, drejtuesin e programit të Radio Vatikanit në gjuhë shqipe. Me këtë rast atij u dhurua Bibla në gjuhë shqipe nga vetë përkthyesi.

Dom Simon Filipajt, pas mirënjohjeve që u ishin bërë nga Selia e Shenjtë, duke marrë parasysh kontributin e dhenë për kulturën shqiptare, Presidenti i Republikës, Alfred Moisiu, më 8 qershor 2004 i jep medaljen "Naim Frashëri" i Artë (pas vdekjes).

Pjekja e kryehershme e krishtëritimit me botën ilirike ka lënë gjurmë në mendësinë e shqiptarëve dhe këto gjurmë shprehen në mënyrë të vetëdijshme në punën e Filipajt. Është koha kur historia kishtarë shqiptare dhe ajo kombëtare të rrjedhin lirshëm dhe jo të shtrenguar. Kjo do të thotë se në lidhje me Filipajn, i cili është emblemë e kulturës sonë, ato duhet të tregojnë një vëmendje më të madhe dhe më të hapur, që personaliteti i tij të zërë vendin e merituar në Kishë; kurse, nga ana kombëtare, emri i tij të rreshtohet, zyrtarisht në vargun e kolosëve të letrave shqipe.

Dëshmia e nipit e tij: "Dom Simonin Filipaj, gjithmonë e kam njohur si axha Simon. Fakti që ka përkthyer Biblën në shqip e ka bërë që të njihet dhe të flitet për 'të botërisht. Prania e tij në jetën time ka qenë ndryshe. Nëse për opinionin ishte përkthyesi i madh dhe studiuesi i madh, për mua ishte shembulli i njeriut të cilin doja ta ndiqja. Dëshira ime ishte të bëhesha si axha Simon! Për këtë arsye ia nisa rrugës së meshtarisë, duke ndjekur gjurmët e tija. Populli ynë, i moçëm dhe fisnik, e nderon dhe e respekton shumë figurën e meshtarit, por rrallë herë e kupton në thellësi dhe njëmendësinë e vet, sidomos sot. Axha Simon mbetet ende për mua një pikë e fortë referimi, por shembulli i tij i ka lëshuar vend personit të Jezu Krishtit. Sepse Jezu Krishti ishte dhe shtysa vendimtare që e ka motivuar dhe vet dom Simon Filipajn".

"Gjithsa bëra, e bëra për dashurinë ndaj Fjalës së Hyut dhe për dashurinë ndaj kombit. Punova pa pritur shpërblim. Net dhe ditët e kaluara në karrigë të ngurtë; në dhomë të ftohët dimrit dhe të nxehtë verës, e nuk kanë qenë të pakta, nuk kërkojnë tjetër, po ta lexosh me atë dashuri me të cilën t'u përkthye" (Dom Simon Filipaj)

Simon Filipaj e la Bibbia in albanese - Don S. Filipaj era nato il maggio 1925 nel villaggio di Klezë e Ulët, nel Montenegro. Nell'anno 1994 termino' la traduzione completa della Bibbia (pubblicata a Ferizaj) portata a termine grazie a una volontà ferrea, durante 40 anni di lavoro ininterrotto, con una grande capacità e conoscenza della lingua. Il valore di questa opera è grande soprattutto se si tiene conto del tempo in cui è stata realizzata: la terribile dittatura comunista e atea che per 45 anni ha oppresso il popolo albanese d' Albania. Tradurre la Bibbia ha significato avere una considerevole competenza in numerosi campi: conoscenza delle lingue di quel tempo, essere un teologo rimarchevole, avere competenza nel campo della filosofia, della storia e letteratura, ed essere un grande specialista della lingua albanese. Un alto riconoscimento è stato dato alla Bibbia tradotta da don Simon Filipaj, quando il 24 ottobre 1994, Giovanni Paolo II ricevette in udienza Don Simon Filipaj insieme a Mons. Rrok Mirdita, arcivescovo di Tirana e Durazzo. In quella occasione il traduttore regalò al Papa una copia della Bibbia in albanese. Dopo il riconoscimento del Papa, Don Simon ricevette dal presidente della Repubblica di Albania, Alfred Moisiu, l'8 giugno 2004, la medaglia d'oro "Naim Frashëri", come alto riconoscimento del contributo da lui dato alla cultura albanese.

Sa Arbyreshy te dheu i Kutronit!

(vjen ka nr. 64)

Giudice papa Janni

ka Shin Koghji (Kr)

12) Caria di Altilia: te viti 1149 kjuhesh Corio; pra u vjety pa gjindie si shumy katunde te kyto vende. Nani te ki vend ng'oshty mo gjajgo. Po Ndrira Pesavento ka gjetur ddi kapitaloziona ndyr arbyreshy e feudatari (Barracco). Jany shumy ty ronda pse kka kyto vende njery die ngky kishym manku njo. Kka kyto ty shkruera mumi ty ddimi si rrojtin, çy bojin...Ngky kishin shpi, shkojin gjoghin te kalivet me shkarpa. S. Severiny, hora e madhe ku ish peshkyvi, oshty nry riony (gjitioni) çy kjuhesh Greçia; u thomy se atje kany vatur ty rinjin ato çy ishiny Karie, te ana e monastirit ty Altilies.

13) Skandale (Skandaghi): vend i vjetyr. Gjehet te e dita pjesy ty XI^o kjinadar. Te viti 1589 shumizza e gjindia vet ish arbyreshy (550 greçi e 150 latini, kyshtu ka shkruer Ughelli). Ish kjisha greke e ddi priftra (papas) grikra. Rendi, si kemi thony, ishy greko-bizhantini. Vikarji i Santa Severines, Kardinalit Santoro çy mrx Romy e ishy peshkyvi i i horys (kyshtu bojin ahriinia), i ka dyrgkuer nry ghipyr me lutje i shkruer te gjuha greke. Nani ndodhet te Biblioteca Vaticana; e kany paary me sitty timy.

14) Cotronei (o si thomi, Kutrone) sott o' nry hory e madhe, mo e madhe kka gjithy horyt arbyreshy. Te arkivi i Napulit, P. Maone ka gjetur nry dokument çy thoty se atje ishiny arbyreshy. Pra jany mo burime çy thonjin kyta: relatioes ad limina. Peshkyvi Piasani shkruen: "D. Rokku Spina o' nry prifry kurat e rin e nikokjirin sakramentet grekravet ose Arbreshavet (albanesi) ty katundit ty Kutroneit ty dioçzhis tone" (A. Pisani 17.3.1658). Mo: Te liçeu Pitagora nry vashizhy my kka thony se nana (momymadha) e saja i nryfex se te hora e saja te viti 1920 ishy nry pjake çy fjityx si neve e ish kka hora, gjo se kish ardhur kka jetrat hory. Shumy emra jany emra grekje (Virga, Bua, Bova v. Gentile).

15) S. Giovanni Minagò: gjehet (gjehesh) ndyr Papanice e Kutyr e kjuhesh "S. Johannes de Monacho". Kjuhesh kyshtu kka nry kjishy e vogyle jashty. Hora ishy e ngjaly çy te moti i bizzantinravet. Gjindiet kany ardhur ati kkrur ka rary Kostantinopoli (1453), kkrur ka dekur Skanderberg (1468) e kkrur ka rary Kroja (1478). Kio hory ishy ndandizh dioçzhis e S. Leone çy nani ngk' o' mo e o' vjetur emri i vendit vet.

B) Ndyr Kutron e Izuh: oshty nry livadhe (fushy) te ana e detit te ku kany vony komy shumy greko-arbyresh çy fjityjin shkipyrtar: (S. Pietro d'Isola, Carbonara, Massanova Apriglianello, Papanice)

16) Papanice (kka papas-Niceforo) sott o' nry hory e madhe e bony pjesy kka hora e Kutronit. Ish nry vend me fusha gkruri. Te viti 1443 kish vett di foke (zhjarre), te 1521 (26), te 1602 (234). Kka nry ty shkruer i vjetyr (i mir e i shtrombur) ka ddall se te 1300, shtaty famija, prapa papasit Niceforo kany kjony ty mbjedhura e kany kjindruer ati. Njera famij kka kyto, Skulko, o' bony e bygkaty e e forty. Ka rrony ty marr kastellin e Santa Severines. Kyta kany bony karta pa vyrteçja se thejin se ishiny bujar ty meth e ty vjetyr. Po te "Gjikimi i trashy" (Processo grosso) i bony Napul kany passur shtrombur. E kyta sa ty hijin ty bojin pjesy kka fronti i Sheitit Dionidj "Seggio di S. Dionigi". E kyshtu ka vatur ty shkruerit ty Reres. Famija Reres ka ddashur ty bonjy kyty shkruerje e rremy sa ty bohox mo e madhe e sa ty hix te froni i bujaravet Palemy Seggio di Palermo). Shumy veta parvenu te 1600 bojin kyta. E na i hajim!...

17) Apriglianello: nry katud jashty çy ka marr gjoghy kkrur kany bony ndyrerjen e jashtave (riforma agraria). Te gjimsa e 1600 rronjin albanezhra e skiavune. Hora merr gjoghy ndyr 1643-1648 kkrur disa famija bihenjin ati sa ty shyrbenjin. Kka kyta famija kemy nry elenky me emra grik-arbyreshy.

(2 – ka më)

Tek nr. 64 i Jetës Arbëreshe, te kjo faqe, tek e para pjesë e artikullit "Sa Arbyreshy te dheu i Kutronit!" u bë një gabim:
Errata Giudice papa Janni – Corrigge Giudice papa Janni
I lipënj ndëlesë autorit. Drejtori.

Quanti Arbëreshë nella terra di Crotona!

12) Caria di Altilia: nel 1149 si denominava Corio; in seguito è rimasto senza gente come tanti paesi in questi luoghi. Ora in questo sito non c'è più niente, solo campagna. Ma A. Pesavento ha trovato negli archivi due capitolarioni tra gli arbyresh e il feudatario (Barracco). Sono molto importanti perché di questi luoghi fino a ieri non ne avevamo neanche uno. Da questi scritti possiamo sapere come vivevano e cosa facevano... Non avevano case, passavano la vita nelle capanne costruite con frasche. A S. Severina, la città grande dove c'era il vescovo, vi è un rione che si chiama Grecia; io dico che lì si sono stabiliti quei che vivevano a Caria, vicino al monastero di Altilia.

13) Scandale: luogo antico. Si trova già nominato nella seconda parte dell'XI secolo. Nel 1589 la maggioranza della persone era albanese (550 greci e 150 latini; così scrive l'Ughelli). Vi era la chiesa greca e due sacerdoti greci. Il rito, come abbiamo detto, era greco-bizantino. Il vicario del vescovo di S. Severina, al cardinal Santoro che stava a Roma ed era il vescovo della cittadina (così era costume allora) gli ha mandato un libro di preghiere scritto in lingua greca. Ora si trova nella Biblioteca Vaticana, l'ho visto con gli occhi miei.

14) Cotronei oggi è un grande paese, il più grande di tutti i paesi arbyreshy. Nell'archivio di Napoli, Pericle Maone ha trovato un documento che dice che lì c'erano gli albanesi. Poi ci sono più fonti che dicono questo: le relazioni del vescovo Pisani che scrive: "D. Rocco Spina è un prete curato e vive ed amministra i greci o gli Albanesi del paese di Cotronei della nostra diocesi" (A. Pisani 1658). In più: al liceo Pitagora una ragazza mi ha riferito che sua nonna le diceva che nel suo paese nel 1920 (circa) c'era una vecchia che parlava la nostra lingua ed era del paese, non era venuta da altri paesi. Molti dei cognomi sono cognomi greco-albanesi: Virga, Bova, Bua ecc. (v. Gentile).

15) S. Giovanni Minagò: si trova (trovava) tra Papanice e Cutro e si chiamava "S. Johannes de Monacho". Si chiamava così da una piccola chiesa di campagna. Il paese esisteva già dal tempo dei bizantini. Le persone sono qui venute quando è caduta Costantinopoli (1453), quando è morto Scanderbeg (1468) e quando è caduta Kroja (1478). Questo paese era vicino alla diocesi di S. Leone che ora non esiste più ed è rimasto solo il nome del luogo.

B) Tra Crotona ed Isola Capo Rizzuto: pianeggiante zona vicina al mare ove l'emigrazione è stata consistente. (S. Pietro d'Isola, Carbonara, Massanova Apriglianello, Papanice)

16) Papanice (=papas+Niceforo): è una grossa frazione di Crotona. Importante centro per la produzione granaria. Nel 1443 aveva solo due fuochi; nel 1521 ha 26 fuochi; nel 1602 ne ha 234.

Da un antico documento (vero o falso?) risulta che nel 1300 sette famiglie, dietro al loro papas Niceforo sono state accolte e sono rimaste qui. Una di queste famiglie, Sculco, è riuscita a sovrastare le altre in ricchezza e in potere. Anzi è giunta a prendere il castello di Santa Severina. Nel "Processo grosso" celebrato a Napoli hanno avuto torto. E questo per poter entrare a far parte del seggio dei nobili di Crotona il "Seggio di S. Dionigi". E così è andato lo scritto del Reres. La famiglia Reres ha voluto creare questo falso documento per diventare più importante e per entrare a far parte del Sedile dei nobili di Palermo. Molti parvenu nel 1600 facevano così. E noi li mangiamo!...

17) Apriglianello: un villaggio di campagna che ha preso vita quando hanno attuato la riforma agraria. A metà del 1600 giungono albanesi e schiavoni. Il paese prende vita tra il 1643-1648 quando alcune famiglie si portano qui per lavorare. Di queste famiglie abbiamo un elenco con nomi greco-albanesi.

Sociolekti i Përmetit dhe emërtimet e bimësisë në bashkësinë arbëreshe të Pulinit Ilukan

Prof.as. dr. Nexhip Mërkuri

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë

Ka hapësira në etnolinguistikë për trajtim krahasues të emërtimeve të ndërtuara në bazë të një tipari ose dy; të një sociolekti në Shqipëri dhe sociolektit të Pulinit Ilukan, tek Arbëreshët.

Në të dy sociolektet që janë marrë për krahasim vihet re se në emërtimet e bimësisë të ndërtuara me togfjalëshor në përgjithësi shprehen mundësitë e zhvillimit kuptimor të fjalës, të cilat i realizon në lidhje me fjalët e tjera (një term njëfjalësh me një fjalë të leksikut të përgjithshëm). Krijimi gjithnjë më i madh i emërtimeve togfjalësh krahas atyre njëfjalësh përbën një dukuri mjaft të përhapur në gjuhën shqipe, sikurse edhe në gjuhë të tjera. Në sistemin terminologjik vetitë kombinuase të fjalëve term realizohen me të njëtrajtshme e të caktuara, sepse pasqyrohen prej saj lidhjet më të drejtpërdrejta ndërmjet objekteve, bimëve e vetive të tyre, ku momentet logjike mbizotërojnë e përjashtojnë momentet emocionale e stilistikore (mollë shesharake (1), bathza ulkut (2)).

Fjalorët e botuar për dy sociolektet të japin mundësinë për të klasifikuar sipas aftësive kombinuase të elementëve përbërëse tek emërtimit e bimësisë të ndërtuara me grup fjalësh:

I. Emërtime sipas karakteristikave, vetive, tipareve të bimëve të pjesëve të trupit e të organeve të veçanta të tyre.

II. Emërtime sipas ngjashmërisë së bimëve të organeve a të pjesëve të tyre veçanta me bimë të tjera, kafshë, sende ose me organe a pjesë të trupit të tyre.

Tek emërtimet e kategorisë së parë dallojnë disa grupe:

1) Një numër i madh barërash, shkurresh, drurësh dhe pjesë të tyre të organeve të veçanta të tyre janë emërtuar sipas ngjyrës si tipar i dallueshëm i disa bimëve, duke përjashtuar karakteristikat e tjera. Ky tipar mund të jetë i theksuar në organe a pjesë të veçanta, megjithatë ka shërbyer shpesh si bazë për emërtimin e gjithë bimës. Në këtë grup dallojmë: emërtime sipas ngjyrës së lules, formës së lules, ngjyrës së lëvizhës, sipas shkallës së aftësisë së frutit, sipas ngjyrës së gjetes së bimëve, ngjyrës së kërcellit, të trungut.

Emërtime që lidhen me kultivimin moskultivimin e bimëve. Marrin mbiemrin (i,e) "egër" ose (i,e) "butë". Të tilla janë: fik i egër, kumbull e egër, ftua i egër, arrë e egër, mëllagë e butë "i, kulpër e egër, kulpër e butë". Në bashkësinë arbëreshe: lis i but, hithit e but, hithit e eger, mëndrëza egër, mrajt e egër, moll egër, vadhëz e egër etj.

Emërtime që lidhen me ëmbëlsinë e frutit. Dallimi bëhet për varietetet jo vetëm për ekstremet i ëmbël – i thartë, por edhe për shkallë të ndërmjetme duke emërtuar lloje të ndryshme, thanë e ëmbël "thanë me kokërr të ëmbël kur piqet", shegë e ëmbël, mollë majhoshe, mollë e thartë, mollë thartëqë. Në bashkësinë arbëreshe: lakra ëmbel etj.

Emërtime sipas ngjyrës së kërcellit, të trungut. Këto janë më të pakta se ato të nëngrupit të parë. Të tilla janë: rrap i bardhë "rrap, i cili ka ngjyrën e trungut si në të bardhë" (ky shpjegim mund të jepet edhe për emërtimet e tjera të këtij nëngrupi), ferrë e bardhë, ferrë e kuqe, shelg i zi, shelg i bardhë, kërpudhë e zezë, kërpudhë e kuqreshme. Në bashkësinë arbëreshe: shelk i bardh, shkoz e kuqe, shkoz e bardh.

2. Emërtime sipas madhësisë së trupit të bimës, formës së organeve të veçanta. Përbëjnë numër më të pakët.

Emërtime sipas madhësisë (organit) së gjetes së bimës. Përbëjnë numrin më të madh të emërtimeve të këtij nëngrupi. Të tilla janë: luleverdhe fletëgjere "bimë mjekësore me fletë të gjerë e me push, e cila lëshon lule të verdha në krye të kërcellit", varvashk në arbërisht. Në bashkësinë arbëreshe: fletgjere, kallimare, trifoli trash etj.

Mjaft bimë janë emërtuar sipas karakteristikave të ngjashme që kanë kërcelli, gjethet, lulet, frutat dhe farërat e tyre me ato të bimëve të tjera të trupit a organeve të veçanta të kafshëve, shpendëve, kandrave. Këtu dallojmë:

-Emërtime sipas ngjashmërisë me trajtat e organeve të veçanta të bimëve

të tjera. Ngjashmëria duket në formën e kokrës, lules, fletës si: grashinë koçkull, gjembaç shtrapol, lule qershie, misër orizi, lule dushku, lule shege.

-Emërtime sipas ngjashmërisë në madhësi me kafshët e shpendët apo zvarranikët dhe qeniet mitologjike: rrush qyqe, gjemb kukudhi "lloj gjembi me gjelbërim të përhershëm, i cili lëshon kokrra të kuqe si në vishnje, përdoret për zburkimin e shtëpive ditën e verës kur nuk ka gjelbërim tjetër".

-Emërtime që lidhen me emra kafshësh e shpendësh. Parapëlqehen si pjesë të emërtimit tek një pjesë bimësh emra: kafshë, shpendë, insekte të ndryshme. Kështu emërtimi i tyre është i lidhur me emrat e këtyre qenieve. Të tilla janë: lëpjetë kalë, bar blete, bar pate, Në bashkësinë arbëreshe: bathza ulkut, bishd dhelprije, glëmbi gaidhures, gluha lope, gluha deles, lulja e gjarprit, lulja zogut (3), etj.

Analiza e mësipërme, me ndarjet në grupe dhe nëngrupe na shpie në disa përfundime:

Materiali i mbledhur në dy bashkësitë për emërtimin e bimësisë realizon aftësitë kombinuase si të elementit kryesor (të përcaktuar) të emërtimit togfjalëshor ashtu edhe të elementit përcaktues të tij që janë kryesisht tipare dalluese të ashpërsisë së frutit, formës së tij, ngjyrës së tullit të frutit, veçorive të tjera në brendësi të frutit, formës së kokrave mbështjellës, cipës, lëvizhës, sasisë së tullit në kokërr, farat e vogla brenda, zorrët (tek fiku), gjatësia e tyre, ngjyra e kokrës në tërësi e pjesëve të veçanta të saj, shkalla e ëmbëlsisë së frutit etj. Pra si element përcaktues për ndërtimin e një emërtimi të veçantë, për të plotësuar nevojat e gjuhës në tërësi e për emërtimet e bimësisë ka shërbyer çdo tipar i veçantë tek bima.

Duke bërë analizën e mëtejshme të materialit të grumbulluar takohen edhe emërtime ku kombinohen tre elementë përbërës. Aftësia e kombinimit bën të mundur shënimin e një bime, emërtimin e saj etj. Për këto emërtime në qoftë se do t'i referoheshim teorisë së G.V.Lajbnicit për emërtimin, mendojmë se mundësitë emërtuese (shënuese) dhe aftësitë kombinuase të elementëve përbërës janë më të mëdha, me dy elementë përbërës. Aftësitë kombinuase të tre elementëve përbërës janë të kufizuara.

Shtirje e gjerë të vazhdimësisë tek të dy sociolektet kanë emërtimet njëfjalëshorë si: arr, bredh, dllënjë, ftua, kulumbri, moll, shelk, than, vidh (4), etj. Ka emërtime që trashëgohen në arbërisht dhe nuk njihen nga anëtarët e sociolektit të Përmetit si: eshk (bungë), putanel, barradhish etj. Pasuria gjuhësore e sjellë për shqyrtim nga dy sociolektet ka nevojë për trajtime të mëtejshme për të plotësuar më shumë kërkimet në fushën e etnolinguistikës shqiptare.

1) Mërkuri, N. E folmja e Pëmetit, Fjalor krahorin, Fjalor i emërtimeve trashëguese të bimësisë. Vlorë, 2009. f.410; 2) Scutari, P. Emrat e bimëve në bashkësinë arbëreshe të Pulinit Ilukan. Centro editoriale e Librario, Università della Calabria. Rende-Italia 2005, f.83; 3) Scutari, P., vepër e cituar, faqe 85; 4) Scutari, P., vepër e cituar, faqe 83.

L'articolo tratta della ricchezza linguistica apportata da due autori come contributo all'etnolinguistica albanese. Ricchezza linguistica che qui riguarda le denominazioni della vegetazione coltivata nei secoli. Vengono trattate le denominazioni strutturate con gruppi di parole, dato che questo tipo di denominazioni, accanto a quelle ad unica parola, costituisce ormai un fenomeno molto diffuso nella lingua albanese, come anche in altre lingue. Lo sguardo comparativo si basa sulla teoria della denominazione di G.V.Laibniz. Il materiale linguistico di queste due pubblicazioni ha dato la possibilità all'autore di realizzare confronti e di pervenire a conclusioni molto riuscite, nonché di distinguere le denominazioni particolari in lingua arbëreshe.

Ndikimi i kulturës arbëreshe në Shqipërinë e viteve 1878-1912

Arbëreshët e Italisë kanë vendin e tyre shumë të rëndësishëm në librin e historisë së kombit dhe të gjuhës shqipe. Përfshirja e intelektualëve arbëreshë në luftën për të shpëtuar kombin dhe gjuhën njihet vetëm më tej. Gjuha e kultura kombëtare u bënë çështje të rëndësishme për të cilat rilindasit arbëreshë punuan. Sipas shkrimeve të kohës në shtypin arbëreshë “Shqipëria ndodhej para jetës ose vdekjes së saj, para ringjalljes ose copëtimit të saj”. Bëhet fjalë për periudhën 1878-1912 (Lidhja shqiptare e Prizrenit - Shpallja e Pavarësisë). Arbëreshët në vazhdimësi kanë nxjerrë emra që kanë lënë gjurmë në kulturën shqiptare. Ajo që i bashkon këto emra është fakti se merren jo vetëm me poezinë, me filologjinë, me përkthimin, me gazetarinë por dhe me politikën.

Situata historike dhe politike në të cilën gjendeshin shqiptarët në dekadat e fundit të shekullit të 19-të, ndikoi shumë në krijimtarinë e një numri të madh shkrimtarësh shqiptarë pavarësisht se ku jetonin ato. Jemi në kohën kur nisin të qartësohen më mirë çështjet historike dhe politike. Proceset politiko-shoqërore të përcaktuara nga vendimet e Kongresit të Berlinit ishin bërë më të qarta. Kjo është arsyeja që botimet e kësaj periudhe përen nga aspekti politik dhe atdhetar më shumë se kurrë. Tashmë e shkuara duket se “lihet mënjane” në veprat e tyre për t’i zënë vend të tashmes. Përfaqësuesit e romantizmit arbëreshë gradualisht do të trajtojnë me kujdes gjendjen në Shqipëri dhe rreth saj. Interesimin e tyre të madh për atdheun e lashtë do ta dëshmojnë jo vetëm me shkrime gazetarie dhe publicistikë por edhe me vepra thjesht letrare. Kështu Skiroi boton përmbledhjen “Kënkat e Luftës” ku në qëndër është gjuha shqipe, robëria shumë shekullore, nevoja e luftës së armatosur kundër turqve, njësiia toskë – gegë, simbolet kombëtare etj. Madje shkohet më tej duke pohuar se robëria shumëshekullore është arsye e njerimit social. Në këtë periudhë rrethet kulturore të arbëresheve ishin të “pushtuar” prej shembullit krijues poetik, por edhe atdhetar të Jeronim De Rades, prej prijjes themelore atdhetare dhe historike të veprës së tij si dhe nga vetë kushtet historike. Janë vitet pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Autorët arbëreshë shkruanin vargje, me të cilat tregonin përkatësinë e vet kombëtare, identitetin e tyre. Në vazhdimësi emrat e mëdhenj arbëreshë nuk do të mungonin. Ndërsa Jeronim De Rada ishte i lodhur nga jeta dhe nga fatkeqësitë familjare, Zef Serembe ishte i rënduar nga sëmundja dhe varfëria, në letërsinë arbëreshe del një emër i ri, Zef Skiroi. Botimet letrare e ndihmuan Skiroin në veprimtarinë politike. Zef Skiroi boton dy poemat e vogla “Skanderbeg” dhe “Kruja”. U mor me mbledhjen dhe botimet e krijimeve popullore: të këngëve, të fjalëve të urta, të anekdotave. Zef Skiroi në vitin 1907 boton një përmbledhje me këngë fetare të arbëresheve të Sicilisë me titullim “Kënkat të përshpyrësme të Shkypjarëve të Sikkjiliis”. Vetë Skiroi shkruan se qëllimi pse bëri një punë të tillë ishte “që të ndihmojmë në mënyrën më të mirë për ta bërë popullin e Pjanës e atë të kolonivet të tjera shqiptare të Sicilisë që të jenë në shkallë të mos përdorin në kishë një gjuhë tjetër përveç asaj kombëtares”. Arsyet e përkushtimit të Rilindasve arbëreshë ndaj mbledhjes dhe botimit të krijimeve popullore janë kryesisht atdhetare dhe artistike. Sipas shkrimtarëve romantikë arbëreshë, letërsia popullore është dëshmia e shkëlqyer dhe e vlefshme artistike e qenies, e lavdisë historike dhe e mundësive krijuese poetike të arbëresheve, përkatësisht të popullit shqiptar në tërësi. Në vitin 1887 Zef Skiroi kur ishte 22 vjeç boton përmbledhjen e parë “Rapsodi shqiptare”, në qëndër të së cilës ishte koha e Skënderbeut. Këto botime bënë të valojë flamuri kuq e zi dhe të dëgjohej zani i kombësisë shqiptare. I zgjoi arbëreshët e Europës dhe vuri në dukje faktin se: populli shqiptar jeton.

Në vitin 1882 De Rada themelon katedrën e gjuhës shqipe. Ministri i arsimit Italian Boselli dha urdhër që të hapet katedra e gjuhës shqipe në Shën Mitër Koronë. Në vitin 1896 thirri Kongresin e gjuhësisë shqiptare

Dr. Rrezarta Draçini

Universiteti i Shkodrës

në Corigliano. U themelua shoqëria kombëtare shqiptare. Botimet e De Rades në këtë periudhë janë: Letër politike dërguar G. Stamillesit, ‘Pelagasi e Albanesi’ (1890); Pellazgët dhe shqiptarët, ‘Conferenza su l’antichità della lingua Albanese’ (1893); Konferencë mbi vjetërsinë e gjuhës shqipe, ‘Caratteri della lingua Albanese’ (1898); Karakteri i gjuhës shqipe, ‘Antologia albanese’ (1896).

Romantikët arbëreshë Jeronim De Rada, Dhimitër Kamarda, Vincens Dorsa, Zef Serembe, Zef Skiroi etj. i kushtojnë kujdes gjuhës qoftë si poetë ashtu edhe si studiues. Nisin të trajtojnë tema të tilla si prejardhja e gjuhës shqipe, marrëdhënie me gjuhët e tjera, rrugët e mëtejshme të zhvillimit të saj. Është koha kur ndërgjegjia historike ndikonte në ndërgjegjen gjuhësore. Nga vepra të shkruara në të folmen arbëreshe gradualisht kemi botime të shkruara në një gjuhë që është gjithnjë e më afërt me gjuhën e atdheut. Këtë rrugë ndoqi Zef Skiroi i cili, sipas Rexhep Qosjes, është një njohës i rrallë i gjuhës shqipe. Afrimin e të folmes shqipe në një gjuhë të vetme Skiroi do ta ndihmonte shumë me leksikonin e tij. Ai arrin që në shkrimet e tij të bëjë bashkim të fjalëve të marra nga gegërishtja, toskerishtja dhe e folmja arbëreshe. Madje kemi një tendencë drejt pastërtisë së gjuhës. Krijon fjalë të reja (gjëmore-plot gjëmime, i përvësëm- me vese, të rezonjë -të ndricojë me reze, gjetherake- me gjethe). Ai gradualisht e pjek mendimin e tij për alfabetin, arrin dhe të ndryshojë qëndrimin në lidhje me alfabetin. Mes viteve 1880-1887 Skiroi braktisi përfundimisht jo vetëm sistemin alfabetik grek, por edhe ato pak shkronja që i kishin shërbyer për të shkruar “Himin e tij të llyftës”. Madje vetë Skiroi në “Prefazione alle Rapsodie” shkruan “Përsa i përket metodës së shkrimit të adoptuar prej meje, duhet të them se, edhe pse i këshilluar nga shumë persona të rëndësishëm për të mos lënë mënjane krejtësisht disa shkronja greke. e gjeta si shumë të drejtë mendimin e albanologëve të shquar, të cilët nuk e pranojnë në shkrimin e shqipes përzjerjen e shkronjave greke me latine, sepse me to lidhen keq të parat për mospajtim në formë.”

(1 – ka më)

L'influsso della cultura arbëreshe nell'Albania degli anni 1878-1912

Gli Arbëreshë d'Italia hanno il loro posto molto importante nel libro della storia della nazione e della lingua albanese. Precisamente negli anni 1878-1912, quando si rischiava lo spezzettamento dell'Albania, il coinvolgimento degli intellettuali arbëreshë nella lotta per la salvezza della nazione e della lingua ebbe un'importanza particolare. La lingua e la cultura nazionale diventarono problemi rilevanti per i quali i risorgimentali arbëreshë lavorarono molto. La situazione storica e politica nella quale si trovavano gli albanesi negli ultimi decenni del sec. XIX, incise molto sulla creatività di un gran numero di scrittori albanesi, indipendentemente da dove vivessero. In questo periodo cominciano a schiarsi meglio le problematiche storiche e politiche, definite dalle risoluzioni del Congresso di Berlino. Questa è la ragione per cui le pubblicazioni arbëreshe di questo periodo propendono verso l'aspetto politico e patriottico più che mai. I romantici arbëreshë De Rada, Dorsa, Serembe, Schirò ecc., dedicano attenzione alla lingua sia come poeti e sia come studiosi. E' il tempo in cui la coscienza storica influisce su quella linguistica. Da opere scritte nella parlata arbëreshe gradualmente abbiamo opere scritte in una lingua sempre più vicina a quella della madrepatria. Abbiamo la prima rivista albanese pubblicata dagli Arbëreshë, abbiamo il primo Congresso linguistico di Corigliano (1895), abbiamo la creazione della cattedra della lingua da parte del De Rada, abbiamo i tentativi per l'Alfabeto della lingua albanese. Gli autori arbëreshë cominciavano a interessarsi non solo della lingua come mezzo creativo poetico, ma anche come peculiarità distintiva nazionale.

Zef Serembe në këndvështrimin gjuhësor

Letërsia arbëreshe është bërë shpesh objekt studimesh letrare e hulumtuesh të shumta gjuhësore nga studiues, shkrihtarë e kritikë letrarë. Disa prej tyre janë botimet e Gualtierit, Markianoit, Stratigoit, Dorsës, Justin Krotës, E.Çabejt, N. Resultit etj. Në këto studime manifestohet, sipas rastit, mbështetja e kontinuitetit, si dhe hidhen mendime e teza të reja.

M.Camaj, në studimet e tij e shikonte romantizmin arbëresh si një gërshetim të traditës popullore me romantizmin libresk e intelektual. Madje, sipas tij, lidhja me letërsinë përdimtare e siguroi letërsisë arbëreshe statusin e një ure lidhëse të letërsisë shqipe si megasistem letrar me letërsinë europiane të kohës. Çabej e quan atë lëndë ballkanike, e posaçërisht shqiptare, të derdhur në formë romane; autorët e saj në rrafshin estetik, sipas tij, janë drejtuar në themel nga Perëndimi. Këtë veçori thelbësore të kësaj letërsie, ky studiues e çmon si element të rëndësishëm pasurimi dhe jo veçimi apo tëhuajësimi mes saj dhe letërsisë tjetër shqipe, duke e argumentuar bindshëm karakterin integrant të kësaj rrjedhe letrare me trugun amtat letrar. Një ndër përfaqësuesit e letërsisë arbëreshe që shpreh bindshëm karakterin integrant në rrjedhën letrare të trugut mëmë është Zef Serembe, autori që përjetoi e pasqyroi në krijimet e veta dhimbjen trefishe të një mërgimtari larg dheut mëmë. (1)

Serembe këndoi në frymën e këngëve të para, të festës apo muzgut, të dashurisë apo dëshpërimit, por edhe në trajta nga më të ndryshmet e të shumëllojshmet duke e dhënë kështu origjinalitet veprës së vet poetike. Serembe këndoi: “*Po helmi mua më rrethen e së m’l’/se gjëndem shumë i nëmur te kjo jet’*”, por edhe në frymën e vargjeve: “*U pa pushim si një suval vete / e ju e dini penen ç’ m’përzë’*” (Serembe. G. 2005: 15)

Në thelb poeti e sheh dashurinë si forcë jetësore, si burim lumturie. Një mendim i tillë pasqyrohet në vjershat që i këndojnë lindjes së dashurisë (“Kënga e dashurisë së parë”, “Këngë e gëzueshme”, “Fytyra e saj”). Më vonë lirika erotike e poetit fillon të përshkrohet nga fryma elegjake.

Veçanësi e poezisë së Serembes është analiza e hollësishtme psikologjike e ndjenjës. Cilërsia, njomësia dhe thellësia e ndjenjës i japin poezisë erotike të Serembes një vlerë të madhe njerëzore dhe përgjithësuese. Nga pikëpamja gjuhësore kjo realizohet nga përdorimi i emrave abstraktë: *horizont, shkëlqimi, njerimi, mërgimi, mëshirë, shpresë, dashuri, mall, mendim, trimëri*. Mes përdorimeve të tilla autori arrin të pasqyrojë përmasat e dashurisë dhe dhimbjes njerëzore.

Mes një analize sasiore do të parashatrojmë nga pikëpamja morfologjike shpeshësinë e përdorimit të pjesëve të ligjëratës. Në poezitë e Serembes vihet re përdorimi i shpesh të mbiemrave: *i dilrë, i grisur, e ndërshme, mendjekthjellët, e zhveshur, e pikur, e stolisur, i shpejtë, zemërcjerrë*.

Duke pasur parasysh fushën e fjalëformimit magjia serembiane nuk mund të imagjinohet pa fjalët e përbëra e të përngjitura. Shpesh këto formohen sipas gjedhëve fjalëformuese të gjuhës popullore. Gjejmë përdorime të fjalëve: *drutëmadhe, gëzimgjatë, meshollë, dhëmbënxirë, hipplotë, zemërcjerrë, faqemollë, faqeakuqe, symëshqerrë, faqeskuqur, flokëgështenjë, fatmirë, luldielli, pendëbardhë*. Mes këtyre fjalëve autori përshkruan vashën si dhe gjendjen e shkaktuar nga dashuria e malli për të. Gjendja në të cilën ndodhet autori paraqitet gjuhësisht mes procesit të emëzimit (*i mjeri, e mjera*). Shpesh krijon edhe sintagma mes figurës së invernionit; *të bukarën buzë, e humburës parajsë*. Autori luan me kuptimet e fjalëve duke na bindur se është poet, të cilit i lejohet liria gjuhësore dhe është i aftë të krijojë fjalë e të kalojë nga një kuptim tek tjetri. P.sh: *llahtar/ llahtari/ llaftarime*. (2) Përdorime të tilla shpesh nuk kanë lidhje me kuptimin e parë referencial të fjalëve (*të parat llaftarime*). Duke pasur parasysh evolucionin e shqipes pohojmë se Serembe provon me guxim titani e poeti të mrekullueshëm aftësinë e fjalës e gjuhës, edhe kur ajo nuk ndodhet në gjendjen më të mirë të saj. Formime si: *cirla ngazullore, dielli na llambar, dashuri më buloi, zemrën ma trendi, drutëzonte* dëshmojnë për mrekullinë e gjuhës poetike të

Helena Grillo, M.A.

pedagoge e gjuhës shqipe, Universiteti i Vlorës

Zef Serembes.

Vërehen përdorime të dysorëve arbërisht- shqip. P. sh: keza- kësulë; mushkumendi- mendjemushka; bjerrafat- i pafat.

Në përdorimin e emrave me parafjalë ndodh inkorporimi i $n > n'$, i cili në shqipin e sotme është prijje e përgjithshme e gjuhës së folur shkaktuar nga përdorimi i shpesh të kushtet e një ekonomizimi gjuhësor: *n'horizont, n'mëshirë, n'hidhërim*.

Autori parapëlqen formën e së ardhmes me pjesëzën “do”. Nga hulumtimet dialektore në fushën e historisë së gjuhës vërejmë se ky tip i së ardhmes përdoret në një masë më të kufizuar tek arbëreshët e Italisë, ku përdoret më dendur e ardhmja e tipit **kam të vete**. *Do t'ishkajnë dimër mbi dimër e pranverë/ Jeta do t'lujëzojë, un s' do jem i gjallë. Do t'rrembej*.

Në përdorimet e kohës së tashme vërehet shpeshësia e mbarsës nj: *kajtonj, dëshironj, vështronj, gëzonj, shtrëngonj*. Nëse mbajmë parasysh edhe besnikërinë e përshtatësitet atëherë konstatojmë se kjo mbarsë është rezultati i përdorimit të gjuhës italiane. Po të kemi parasysh se huazimi latin **lëvdonj (laudare)** është më i vjetër se huazimi Italian paguanj, të cilin Jokli e bie të ardhur nga një formë e vjetër e vetës së tretë njëjës të perfektit Italian **pagau**, megjithëse nuk mund të vërtetojmë nëse kjo formë vjen nga latinishtja apo italishtja. Serembe përdor formantin e spikatur për vjershat erotike fjalët me prapshitesa zvogëluese –(z): *gozhdëz, degëz, fluturëz*.

Përjetimi i detajeve të ambientit të vendlindjes së vet me ritme dramatike, është shprehje e shqetësimit dhe e pakënaqësisë, më shumë se e identifikimit të fuqishëm me atë mjedis, edhe pse as kjo lidhje nuk mungon.

Një përmasë e vecantë në poezinë e Serembes është malli. Këtë përmasë poeti e sjell gjuhësisht mes përdorimeve të fjalëve që i përkasin fushës leksikore të fjalës *mall*. Nëse filologu ose kritiku letrar Mallin e sheh të shfaqet si një mbivendosje (*superpozicion*) ndjenjash , poeti e sheh atë në këndvështrimin e ndjeshmërisë së tij dhe e paraqet të shndërruar në figura konkrete, në tërë pasurinë e ngjyimeve, në larininë e formave të shfaqjes, në ato që i quajmë *hipostaza*. (3)

Nga analiza gjuhësore e poezisë së Zef Serembes vërehet se: edhe me mjete të kufizuara gjuhësore, (një e folme e izoluar, pa zhvillim normal për shekuj të tërë), mund të krijohen vepra poetike solide, kur është fjala për talentë të mëdhenj.

1) Referim në *Simposiumin e III Ndërkombëtar “Gjuha dhe letërsia arbëreshe”*, Tetovë (UEJL); 2) *Shih: Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980, f. 10343 A. Plasari*, “Don Kishoti zbret në Shqipëri”, *Shtëpia Botuese “N.Frashëri”*, f. 136

Zef Serembe dal punto di vista linguistico - La Letteratura Arbëreshe è fatta spesso oggetto di studi letterari e di ricerche linguistiche da parte di studiosi, scrittori e critici letterari. Qui si è voluto dare uno sguardo linguistico alla poesia di Zef Serembe. Dal punto di vista linguistico, analisi dettagliate del sentimento si realizzano con l'uso di nomi astratti: *orizzonte, splendore, disgrazia, espatrio, pietà, speranza, amore, desiderio*. Tenendo presente il campo della formazione delle parole, la magia serembiana non si può immaginare senza le parole composte, con le quali l'autore descrive la ragazza, come anche la situazione che causa l'amore per lei. L'autore preferisce la forma del futuro con la particella “do”. Dalle ricerche dialettali nel campo della storia della lingua, osserviamo che questo tipo di futuro si usa in misura più limitata dagli Arbëreshe d'Italia, che più spesso usano il futuro del tipo “kam të”. Dall'analisi linguistica della poesia di Zef Serembe notiamo che, quando si tratta di grandi talenti, anche con mezzi limitati linguistici (una parlata isolata, senza sviluppo normale per interi secoli), si possono creare opere poetiche solide.

Birnard Bilota i shkruan De Radës

Frascineto, 3 Novembre 1884

Veneratissimo Signor Maestro, Da gran tempo mi agita il desiderio di [rec]armi personalmente ad ossequiarvi. Intanto ora una cosa, ora un'altra, e massimamente la cura delle anime, non mi permettono muovermi di qua.

Se Iddio vuole, darò soddisfazione a questa mia ardente brama. Avrei a sottomettere al vostro venerato giudizio il mio poemetto, di undici canti rimati, intitolato "La spada di Scanderbeg ne' campi di Dibra Inferiore"; perché, ove meritasse la vostra stima, mi occuperei a ritoccarlo.

L'ho scritto ad imitazione de' poemi classici, poiché i Libri di Omero e di Virgilio mi danno più gusto de' scrittori moderni. Conosco che ha bisogno di essere ritocato, e comincerò a lavorarvi sopra, spero, nella vegnente primavera, o prima, se prima di quel tempo compirò un mio lavoretto filologico, col quale intendo togliere il velo al passato, per essere intesi gli abitatori della terra dell'evo posdiluviano, fino alla presa di Troia favellare in modo, che solo gli Albanesi l'intenderebbono, e potrebbero rispondergli e, sebbene stentatamente, conversare seco.

Achille Parapugna, giovine che prometteva molto a vantaggio della Letteratura Albanese, ed amico intimo del vostro tanto compianto e degno figlio Giuseppe, morì nel Marzo 1882; onde, quando cominciò la pubblicazione del periodico il Fiamuri, respirava le aure dell'Altra Vita. Non è da far meraviglia quindi, se da' suoi superstiti fratelli, Antonio, Basile etc. forniti di nessun gusto per la letteratura nazionale, ne fu respinto il numero d'invito a quell'associazione. E ciò fu fatto non per colpa loro, sibbene dell'avara natura. Da parte mia quindi li scuso e compatisco. Avrò cura di prendere conto delle due altre associazioni al periodico, appena m'incontrerò al Sigr. Sindaco (ch'è lo stesso D. Antonio Parapugna) ed a Pietro Miraglia. Augurandovi la vita longeva di Noè, rispettosamente vi bacio la destra Dev. ed Obb.mo Discepolo Bernardo Bilota

Testi orixhinal i shkruajtur me dorë nga Birnard Bilota (1843 – 1918), një skritor i njohur nga Frasnita, gjëndet ndë Arkivin

e Shtetit të Tiranës (Fondi 24, dosja 54, fleta 142) e e bëjm të njohur, këtu, për herën e parë. Si kemi bërë njera nani mbi këtë rivistë, zgjodhim këtë liter pse na buthton cili ish ambienti ku gjëllijin e si gjëllijin intelektualët arbëreshë e çë raporte i lidhjin me De Radën.

Birnard Bilota konsiderohet dhishipull i De Radës e ka për këtë autor të madh një venerationë të fortë e të sinqertë, pse e njeh si një skritor e si një personalitet çë shërben për të zgjuanj kulturën arbëreshe e shqiptare. Ai shërbeu për gjithë jetën e tij për leteraturën, për gjuhën, për të hapur idhetë e rea ndë gjithë jeten arbëreshe e europiane me zëmërgjer e me shumë konvinxionë aq sa tëhelq gjithë ata çë e njohin. Kështu Bilota ndien dëshirën të verë ai vetë Maq se t'ë përpjek e t'ë falinj e se t'i buthtonj gjithë aktivitetet kulturele çë është e bën.

Bilota e informon se është e shkruan një poem, me 11 këngë, me titull: "Shpata e Skanderbekut" e ka dëshirë të ja buthtonj De Radës pse mund t'i jap ndonjë kunxil se t'ë përmirësonj operën. Edhe ture parkalesur De Radën t'i shtier një sy kësaj operje, Bilota buthton se i ka shumë besë De Radës dhe se pret sugjerime nga ai çë njihet si burrë me prestixh, me urtëri e me mirësi.

Operën "Shpata e Skanderbekut", pra, Bilota nëng arvoi t'ë stambarij, e e la dorëshkrim, si shumë opera të tjera, çë adhe sod presin të njihen; po e stambarti i nipi, Zoti Emanuil Xhordano ndë vitin 1967, Tiranë, kur ra 500-vjetori i vdekjes së Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Më atej, i nipi i Zotit Emanuil, Gustin Xhordano, i bëri një studim më të thellë çë e djovasi te Konvenji Internacional çë u mba Anapul (1 – 2 Shëndre 2005) kur ranë 600 vjetët e të lerit të këtij eroi arbëresh (shih Giorgio Castriota Scanderbeg nella storia e nella letteratura, Atti del Convegno Internazionale, a cura di I. C. Fortino – E. Çali, Napoli 2008, ff. 195 – 220).

Ndë këtë liter Bilota i thot De Radës se është e shkruan edhe një t'ër libër mbi gjuhët më të vjetra çë mund të interpretohen dhe ndiohen me arbërishten. Me të vërtetë Bilotta, pra, stambarti dica libra të shkurtër çë trajtojin këtë argumend. Këta janë librat me këtë argumend: 1) Studio filologico circa gli eroi preistorici (Castrovillari 1915), 2) Lavoretto filologico circa i Pelasgi

prof. dr. Italo Costante Fortino

nga Shën Benedhiti (CS), Universiteti L'Orientale i Napoli

(Castrovillari 1893), 3) Studio filologico e preistorico circa Dardano di Corinto (Castrovillari 1913), 4) Enti sacri della Bibbia ne' numi mitologici venerati da' Pelasgi albanesi del gentilesimo (Castrovillari 1897), 5) Articoli filologici riguardanti gli enti sacri della Bibbia ne' numi mitologici venerati da' Pelasgi albanesi del gentilesimo (Castrovillari 1899), 6) Le mie opinioni archeologiche e preistoriche (Castrovillari 1911).

Si mund shihet shumë interes pati Bilota për studhimet çë venë e gjëjin orixhinën e fjalëve më të vjetra, kështu si orixhinën e popujve më të vjetër. Ka të thomi se jo nga herë çë Bilota shkruan për këta argumente ka të drejtë, pse nd'atë mot etimoloxhia nëng ish adhe e zvilupartur. Mund të thomi se Bilota ndë këta studie është i orientuar nga induciona. Se t'ë ndiojim më mirë këtë proçedhimend të Bilotës, djovasim atë çë ai shkruan për të spiegonj fjalën e popullit çë njihet si "Pelasgi": "Il vocabolo Albanese "pieelj" significa "generato", da "piel", che nel passato fa "puel", e nel presente "piel". Esempi: "piel gaidhuria", genera l'asina; "puel dhia", figlio la capra; "vicci i-pieelj", il vitello generato. Il nome "Pelasgi" è attributivo di tutte le genti primitive. Ce lo accerta lo stesso vocabolo, scomponendosi nei voc. albanesi "pieeli", generato, e "ljiashiti", antico, primitivo, vecchio. Onde noi diciamo "burr i-ljiashit", uomo anziano; "të mbieljia të ljiashita", seminati primitivi. Dal voc. alb. "ljiashit" derivò l'altro voc. pure alb. "ljaalj" zio consanguineo e persona che ne avvanza in età. Lo zio consanguineo propriamente si nomina "unghlji" come in francese "oncle". Un dotto filologo e Poeta Albanese, mio predecessore, il nome "Pelasgi" fece equivalere al voc. alb. "piekszit" o "pjeljszit", che significa "vecchi" (shih. Lavoretto filologico circa i Pelasgi, f. 5). Bilota, pas notixies çë i jep De Radës se poeti Akile Parapunja, nga Eianina, - çë të birit të parë të De Radës, Zepës, i kish dedhikatur një poezi të gjatë, - kish vdekur dy vjet më parë, i taksën se interesohet sa t'i gjënj abonamente për rivistën "Fiamuri Arbërit".

Ambiendi kulturor çë na shëngon edhe kjo liter e shkurtur është ai i intelektualëve çë janë të impenjuar se të bëjm më të bëgat leteraturën, gjuhën dhe me një fjalë kulturën arbëreshe.

Njatër vepër e Bernard Bilotës, e botuar e paplotë

Shpata Skanderbekut ndë Dibret Posht (1890)

Bernard Bilota zë e shkruan poemën “Shpata e Skanderbekut ndë Dibret Posht” tek viti 1874, kur kish 31 vjet. Na qëndruan katër redaktime: i pari, i vitevet 1874-78; i dijeti, pa datë, po i atyre viteve; i trejti, i vitit 1888; dhe i katërti i vitit 1890. Vepër e botuar, e paplotë, nga protopapasi Emanuele Giordano, në Tiranë, te viti 1968. Këtu citomi të parat 18 sekstina të redaktimit të katër. Në përgjithësi janë 5 Fashikuj, 366 faqe, madhësi cm.20x26.8. Poema është e ndajtur në Kangjele (12) dhe e shkruar në sekstina, të nomruara ka autori (1764); përgjithësisht vargje 10.584. Rimë ABCBDD. Teksti arbëresh është i pjerrë (po jo ngaherë) ka autori lëtisht. Tek Poema rrëfihet një ndër luftat më të rëndësishme që

(transkriptoi) **Agostino Giordano**

ka Purçilli (Cs)

Arbëreshët, nën urdhërin e Skanderbekut, fituan kundër Turqvet. Kush do të dirë gjë më shumë mbi këtë vepër të Bilotës, le të djovasënjë: “Agostino Giordano, *“La Shpata e Skanderbekut di Bernardo Bilotta”* (tek libri **“Giorgio Castriota Scanderbeg nella storia e nella letteratura”**- atti del Convegno Internazionale, Napoli 1-2 dicembre 2005 (a cura di I.C.Fortino e E.Çali), edito dal Dipartimento di Studi dell’Europa Orientale, Università L’Orientale di Napoli, Napoli 2008; faqe 195-219).

Kangjeli Për

1. Dihej dit e bårdh
ndër sheshet e Dibrës:
të falnej Arbresht
me diellin, gjëll e hjes,
çë jeten zbukuron
e me t’mirat i mburon.

2. Ajo llambardhosnej
me gas e me harë:
e bukur të ngjallnej
çëdo kish ki dhë!
Të gjallit rrëfiejen
harezen çë ndiejen.

3. Zoqzit ndëpër degat
ëmbëlith këndojen
me mallin, çë i velnej
zëmren: e kallzjojen
te gjith shok mbjithshin
e bashk mür ndihshin

4. si vashat ndonj valle.
Me oreks nd’at hër
edhe këto zdrhidnej
graxetazit tue luer,
e trimavet këndojen
vatur t’i nderojen.

5. Nëndë Skanderbekun,
krie, çë shkëlqenej
mbi sã burra ahiera
jeta me drit vrenej.
Qenqezit e delet
shkaflisjen ka vadhelet

6. e mënxanavetë veshur
E me lule ndrruer
Si nata me ilez,
vejen tue keier
e bãbë bëjen
me gøl çë s’këndjen.

7. Kuelte e Skanderbekut
dhe ingëlljen e bëjen
djallin!... Samënxithe
kalorit mund i mbajen!...
Doj t’skaperdhisjen
ka ënda i qindrisnej...

8. Me ta edhe kalorit
e axàtrat ndë shesht
Dibres s’dojn t’ prisjen
më me ehjat veshit:
ënda i hãj të strosshin
si ka Turqit ndothshin.

9. Doj t’ven t’i timosjen
ndër malet e Asis...
I mbanej e mirr mot
si bir i urtësis
të qellej nd’at dit,
Skanderbeku i ngrit.

10. Mirr mot, vëj kuff
ku kish përulfosej:
çë udhje me kalorit
Turkut kish strosej;
ndë ç’vend shokt axàtu
kish shtëinej pra o mbjatu.

11. Pra çë mbaru vreti
e shkoj mür sheshet
ku lufa kish çelej,
bëri kriq e i veshet
si pik kcen kaluer
kalit, e ndër duer

12. ndën shpaten. Me diellin
kjo si ðill me bishtin
të shkeptnej. Zũ e tha:
“Parkalesmi Krishtin,
shok, të mbãnj me nã,
bë t’qellemi me hje.

13. Po Kriqezën e tñj,
kraf-qifte sinodhñ,
ndrë të paret ndëmi.
Ju trima, shokt e mñ,
shini t’i bëmi ndër,
ndë duemi ka ajo vrër.

14. Vi, kalër e axàtra,
çë me ehja veshi,
nganjë ka shëngji tñj!’.
Tarandaksi sheshi
kur nd’at fjal u tundtin.
Ajri, te ju shkundtin

15. ehjat ngrah, buhjisit
sikür të gjimonej.
Te ni zũ nga krie
shoktë triçidhoney,
Skanderbeku agotiksi
kalin, çë skaperdhiksi

16. e vëj si vrundullër.
Nd’at kal dukej Marti
çë shpaten i shnõj
te krahu, kür i Larti
i lipsur dheut tñj,
çë nënd Turkut rrñj,

17. i dashur bën e leu.
Nd’atë dit rë
Inzot ult te Dielli
i hñjth pjot hje
një drit të shkëlqier,
se t’i bënej ndër.

18. E gjith dheut tñj
i pjeksnej një kurõr
me ilez e uraten
i ndënej me at dõr,
çë Kriqen e të Birit
puthnej rrëz gjirit.
(...)

Ankthi i dritës në poezinë e Alket Çanit

METRIKA E DRITËS

Alisa Velaj
nga Vlora

I.
Drita përndrit dritën
Atje ku shkrepit e malit prekin qiellin me dorë
Duke lënë gjurmën e heshtjes së përjetshme.
E gjelbër dhe e pandërprerë ja tek ngjitet jehona
E lugjeve të kristaltë dhe muzika e ujërave
Që pikturojnë në ajrin e shtangur të agut
Pamjen e pritme të ditës.

Drita lind nga uji.
Nga uji i drurëve që humb në rërën e virgjër (1)
Dhe uji i lumenjve të lodhur së kërkuari detin.
Këshillat e urta të rrënjëve dhe gurit më mësuan
Si t'u hap shtratin lumenjve dhe të bëj brima në rërë,
Brima të thella gjersa gjeta
Rrënoja qytetërimesh antike, rrënoja drite
Dhe kujtime gjeta e varre ku mermeri
Lëshon prej syve një vezullim verbues.

Unë ecja dhe pas vetes tërhiqja kohën
Si një mendim të hershëm që të ndjek gjithë jetën,
A si një imazh mjegullor nga fëmijëria
Që ngjan me kaun plak që tërheq parmendën
Nëpër një tokë të shterët.

Por duke ecur gjer në fund të rrugës –
Gjer në fund të vetvetes,
Duke kërkuar burime të rërë e shkretëtirës,
Arrita të kap një fije të hollë drite,
Që e mbajta fort dhe e ruajta si të vetmin thesar
Dhe krijova me të duke e mbjellë në tokë:
Një lumë, një pemë dhe një poemë.
Ty t'kjoftsha falë, o dritë, ama e mbrodsimit! (2)

II.
Zgjohesha me një dhimbje drite në sy,
Duke prekur me gishtrinë trupa të panjohur,
Duke gjetur aty
Hapësira rrënjësh, ekuinokse dhe përshkoja
Rrathët e heshtjes si rrathët e ferrit
Apo të qiellit.
Koha e luleve më dhuroi
Pjalmin e verdhë që ngjitej te dielli,
Hosinë e nektarit
Ku rridhnin ujërat e Letes,
Dhe krahët e shkriër të Ikarit
Si flatra kujtese.
Prekja vezullimin që velonte argjilën e tokës,
Zbrazëtinë e mbrujtur me brumin e dritës,
Lexoja profecitë e gjithë muzgjeve të botës
Dhe vdisja në flijimin e dritës,
Duke gjurmuar shpresën e rrezes së fundme,
Si ai që kërkon te kalimtari i natës
Njeriun e njohur.

III.
Është ky ankthi i dritës
Që të përmbyt ndërsa ti

Mendon, një ditë shiu që s'ka fund,
Se tragjedia lindi nga seksi tragjik,
Se bota është një lëmsh lajmesh,
Se gjithë kjo hapësirë yjesh të ndritshëm
Tretet, një çast, brenda riteve të diellit,
Se vështrimet e shtresuara janë imazhe
Që koha morfologjike i përhap
Në lojën e përfytyrimit metafizik.

Nëpër dritën e ideve të hajthme :
Rrjedhje ajri, rrjedhje tingujsh, vorbull
Mjegullnajash rreth enigmave mitike,
Vargje të gjatë rrëfimesh të mumjeve prej dylli,
Hipotezash në bibliotekat e djegurat...

Sa herë zbulohet një e vërtetë
Zhduket një thelb
Dhe mbetet veç fjala – labirint i kujtesës.

Me fjalën thellon
Abysin e mendimit.
Duke shkruar i shton diçka
Kotësisë së krijimit.

Duke shkruar s'ke thënë asgjë,

Veçse i rikthen dritës
Ca profeci të vjetra,
Mesazhe të errët psherëtimash dhe shenjash,
Ëndrra pa kohë, largësi dhe heshtje.

1) « L'eau des bois se perdait dans les sables vierges. » Arthur Rimbaud, Larmes. 2) Ndre Mjeda, Liria.

Kam qenë në vitin e fundit të studimeve për letërsi, diku nga janari i vitit 2005, kur më ka rënë për herë të parë në dorë vëllimi me poezi “Shtrati i Prokrustit” i poetit Alket Çani. Një vëllim që do të më linte mbresa të thella, e që do ta ruajta në kujtesën time poetike, si një nga librat më të mirë të poezisë shqipe pas viteve '90. Në këtë shkrim nuk kam për qëllim të bëj ndonjë vështrim gjithëpërfshirës të këtij vëllimi, por do të doja të ndalesha tek një poezi e vetme, e cila për nga vlerat që mbart mbetet një nga krijimet më të mira të poezisë moderne shqipe, e denjë për t'u përfshirë në çdo antologji poetike. E kam fjalën për poezinë “Metrika e dritës”. (Poezi që përfshihet dhe në vëllimin e parë me poezi të A. Çanit, duke i dhënë madje titullin krejt vëllimit). Poezia është e strukturuar në tri pjesë. Dy pjesët e para përshkohen nga e njëjta simbolikë. Ato janë si të thuash një ravgim drejt Dritës, ndërsa pjesa e tretë mund të konsiderohet fare mirë si epilogu i këtij ravgimi. Për të depërtuar në simbolikën shumështrësore të kësaj poezie, do të doja të ndalesha pikësisht në vargun që hap pjesën e dytë të saj.

“Zgjohesha me një dhimbje drite në sy” (3)

Është pikërisht ky ankth drite që pulson brenda këtij vargu, ai që

do ta çojë subjektin poetik drejt ravgimeve të tij. Diku në veprën e tij “Koncepti i ankthit”, Sorren Kierkegaard përmend *ankthin e së keqes* (4), në të cilin individit gjendet kur është në mëkat. Kjo sjellje nga një këndvështrim më i lartë, i përket sferës të së mirës dhe prandaj individit provon ankthin e së keqes. E përmenda këtë citim të mendimtarit danez, jo për faktin se do të ndalem në kategori të tilla si mëkati apo jo-mëkati, pasi ato nuk kanë aspak lidhje me këto rradhë, por sepse kjo aksiomë mbart një thelb, të cilin do të doja ta huazoja për ta bërë argument të interpretimit tim. Konceptet e mëkatis dhe jo-mëkatis do t’i zëvendësoja me ato të dijes dhe të padijes. Këto dy të fundit shndërrohen në dy poet qëndrore, ndërmjet të cilave ravgon subjekti, ose Qenia e mëmkuptuar brenda kësaj poezie. Ravgim ky që ka për shkak ankthin e dritës. Ajo që do të vazhdoj ta quaj **Qenia e nënkuptuar** ose thjesht **Qenia** fillon të mbushet me një lloj dije, e cila vjen tek ajo dalëngadalë nëpërmjet Sodihtjes. (Në pjesën e dytë të poezisë Qenia do të kuptojë se është pikërisht kjo lloj Sodihtje që e bën të zgjohet me një dhimbje drite në sy). Duke u ndodhur pra në një gjendje padije, ankthi i Qenies është i drejtuar kah dija. Ajo (Qenia) fillon të dritësohet shkallë-shkallë me anë të përndritjes., që ndodh diku rreth saj, por që realisht e ka përfshirë dhe atë vet përmes procesit të Sodihtjes.

“Drita përndrit dritën

Aty ku shkrepit e malit prekin qiellin me dorë” (5)

Pamja e pritme e dritës, ajo që mbart dritën natyrore, fillon e përndritet në takimin e saj me dritën e Hyut (dijen e epërme). Asaj lloj drite trashedentale, për të cilën Qenia shpreh adhurimin e saj të hapur në vargun

“*Ty t’kjofta falë, o dritë, ama e mbrodhsimit!*”

E gjithë kjo mund të shprehej në një formulë të tillë për procesin e përndritjes.

Dritë tokësore + Esencë drite hyjnore =>Përndritje.

Në Shkrimet e Shenjta, Hyu u drejtohet krijesave të veta me fjalët: “*Ju jeni drita e botës, kripa e tokës*”. (6) Ndaj dhe Qenia ndjek këshillat e urta të rrënjëve dhe të gurit, për të mos mbetur vetëm tek soditja e dritës, por për të kërkuar në pakohësi themelet e saj.

“*...gjersa gjeta Rrenoja qytetërimesh antike, rrënoja drite*”. (7) Dhe duke qenë një dritë e pakohë, një dritë që nis prej përkohshmërisë së qytetërimeve e mandej zgjat deri në amëshim, këto rrënoja kthehen papritmas në ndërtesa, ndërsa përkohshmëria e qytetërimeve shndërrohet në grimëkohë përjetësie. Por ajo që duhet të skalitet mirë në kujtesën njerëzore është se kjo dritë mbartet të secili prej nesh. “*Unë ju kam krijuar sipas shëmbëlltyrës sime*” (8), thotë Hyu. Qenia arrin të jetë vetë krijonjëse, vetëm kur arrin të kapë këtë fill të hollë drite në fund të vetvetes.

“*Dhe krijova me të duke e mbjellë në tokë / Një lumë një pemë dhe një poemë*”. (9)

Në këtë mënyrë Qenia mbjell ekzistencën, e cila del e nënkuptuar nëpërmjet tri elementëve të saj: Ajrit (rrënjët), Ujit (lumit) dhe Zjarrit (dritës). Poeti vetpagaçohet gjithashtu Krijonjës, përderisa arrin të mbjellë një poemë. Pjesa e dytë e poezisë jep një subjekt tashmë të dritësuar (me dije të plotë). Krahët e shkrirë të lkarit si flatra kujtese simbolizojnë Qenien para dhe pas ravgimit. Më parë në kërkim të rrënjëve, ndërsa tash me një koncept krejt të ndryshëm mbi jetën dhe vdekjen, mbi dritën dhe errësirën.

“*Dhe vdijsa në flijimin e dritës*”. (10)

Pikërisht në këtë varg përmbysët kuptimi denotativ i titullit të kësaj poezie. Nuk mund të ketë metrikë drite për një Qenie me dije të plotë. Kjo metrikë perceptohet si e tillë vetëm nga optika e vështrimit të dikujt që nuk mbart kurrfarë dije. Ndoshta për këtë arsye, në pjesën e tretë të poezisë, njëlloj si në Librin e Predikuesit

në Shkrimet e Shenjta, Qenia merr rolin e Krijuesit, dhe përpjetë t’i flasë me parabolë një qenieje tjetër. Asaj që është e ndryshme prej saj, ose është e mburitur ashtu siç ishte vetë ajo para se të përjetonte ankthin e dritës. Duke i profetizuar qenies tjetër se në fund të gjithçkaje mbetet veç fjala (“*dhe mbetet veç fjala-labirint i kujtesës*”), Qenia nuk është gjë tjetër veçse jehona e zërit të Hyut në Testamentin e Ri, ku shkruhet: **në fillim ishte Fjala**. Fjala si fund dhe fjala si fillim dhe në këtë krijesë plot drite të poetit Alket Çani!

3) Alket Çani: Shtrati i Prokrustit, Shtëpia botuese “Ombra GVG”, Tiranë 2004, f.36, v. 30; 4) Sorren Kierkegaard: Koncepti i ankthit, Shtëpia botuese “Plejad”, Tiranë 2002, f.122; 5) Alket Çani: po aty, f.35, vv. 1-2; 6) Bibla: Mateu 5:13; 7) Alket Çani: po aty, f.35, vv. 13-14; 8) Bibla: Zanafilla 1:26; 9) Alket Çani: po aty, f.36, vv. 27-28; 10) Po aty, f.37, v 45; 11) Bibla: Gjoni 1:1;

L’ansia della luce nella poesia di Alket Çani - La poesia “La Metrica della luce”, che è strutturata in tre parti, è, nella sua profondità, un pellegrinaggio verso la luce. Ansia della luce, che si sente in tutta la respirazione dei versi, è la ragione essenziale che porta il soggetto poetico verso i suoi pellegrinaggi. I concetti principali sono la conoscenza e l’ignoranza. Questi concetti si trasformano in due poli centrali, attraverso i quali si dirige il soggetto, o l’Essere. Quello che battezeremo come l’*Essere sottinteso* inizia a riempirsi di una sorta di conoscenza, che viene in lui lentamente attraverso la Contemplazione. Nella seconda parte della poesia, l’Essere capirà che è proprio questa sorta di Contemplazione che lo fa svegliare con un dolore di luce negli occhi. Trovandosi poi in una situazione di ignoranza, l’ansia dell’Essere è diretta verso la conoscenza. Esso (L’Essere) inizia a illuminarsi gradatamente per mezzo della lucentezza che si trova da qualche parte attorno a sé, ma che realmente ha abbracciato anche lui attraverso il processo della Contemplazione. Nella terza parte della poesia, come in reminiscenza, ci viene il simbolismo biblico, quasi come nel Libro del Predicatore, dove l’Essere prende il ruolo del Creatore, e si sforza di parlare con parabole ad un altro essere. A quello che è diverso da sé, oppure è impastato così com’era Esso prima di provare l’ansia della luce. Profetizzando all’altro essere che nel fondo di ogni cosa resta solamente la parola (“*E resta solo la parola / labirinto del ricordo*”), l’Essere ci viene come l’eco della voce di Dio nel Nuovo Testamento, dove è scritto: “*In principio era la Parola*”.

FJALËT I MERR AJRI, SHKRIMI QËNDRON

- “Nel Sacramento del Matrimonio è vietato l’uso di strumenti musicali e di canti non contemplati nel rito: prima, durante e dopo la celebrazione nuziale” (*Sacramenti, Il Sacramento dell’Incoronazione-Il Matrimonio, IV, 72, pag.51*);

- “Non si celebrino ufficiature non contemplate nei libri liturgici” (*Liturgia, La Liturgia nella nostra Chiesa, I, 84, pag.57*);

- “E’ necessario abbandonare gradatamente, mediante opportuna catechesi, forme, usi e pratiche che risultino estranee alla nostra tradizione bizantina (...)” (*ibidem, 85, pag.57*);

- “Tutte le chiese della nostra eparchia abbiano l’Iconostasi” (*Liturgia, Le iconi, XIV, 178, pag.87*);

- “In ogni festa parrocchiale vi siano tutte le iconi delle feste principali e siano esposte alla venerazione dei fedeli in occasione delle rispettive festività” (*ibidem, 180, pag.87*);

- “E’ severamente proibito introdurre nuove statue in chiesa. Secondo il Sinodo di Grottaferrata, le statue devono essere sostituite con le iconi” (*ibidem, 181, pag.88*);

- “Nelle processioni in onore della Madre di Dio o dei Santi siano portate le corrispettive iconi bizantine” (*ibidem, 183, pag.88*)* (...)

* **Eparchia di Lungro degli italo-albanesi dell’Italia Continentale**, Dichiarazioni e Decisioni della *Assemblea Eparchiale - 1995-1996*, Mit, Cosenza 1997.

Studime Polake për gjuhën shqipe

(3 - vjen nga nr.64)

Prof.dr.hab. Irena Sawicka

Universiteti N. Kopernik, Torunj (Poloni)

Irena Sawicka (vazhdim)

- 1997, Artikuj enciklopedikë [në:] Nowa encyklopedia powszechna, Warszawa, vëllimi VI - Variboba, 603.
- 1996, Liga Ballkanike fonetike, [në:] Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare XVIII, Tirana, 517-520.
- 1996, Nowe jugosłowiańskie prace albanobalkanicystyczne (rec.), Studia linguistica polono-meridianoslavica, 243-248.
- 1996, Waclaw Cimochoowski, Głos Uczelni V, Toruń, 9-10.
- 1996, Co wiemy o języku albańskim, Dziennik Polski 20.VI, London.
- 1997, The Balkan Sprachbund In the Light of phonetic features, Energiea, Warszawa.
- 1998, Charakterystyka fonetyczna centralnego obszaru ligi bałkańskiej, Македонски јазик XLV-XLVII, 169-177.
- 1999, Z zagadnień fonetyki bałkańskiej - problem fonologicznej szwy, Prace Filologiczne XLIV, 493-497.
- 2000, Vocalic Balkanic Features, [në:] Akten des Internationalen Kongress Balkanlinguistik, Synchronie und Diachronie, 30.X.-1.XI.1997, Thessaloniki, Thessaloniki, 207-215.
- 2000, Об одном средневековом балканизме, [në:] Материалы XXVIII Межвузовской научно-методической конференции преподавателей и аспирантов, вып. 21, Балканские исследования, част 3, март 1999, Санкт Петербург, 25-28.
- 2000, A medieval phonetic balkanism, Folia Linguistica Historica XXI/1-2, 155-158.
- 2001, Artikuj enciklopedikë [në:] Wielka encyklopedia powszechna, Warszawa, vëllimi I - Albańska literatura (bashkë- autor), 321; albański język, 323; Agolli, 205; vëllimi II - Asdreni, 361; Arapi, 222; vëllimi III - Bardhi, 271; Barleti, 238; vëllimi IV - hasla: Bogdani, 219; Budi, 552; vëllimi V - Buzuku, 91.
- 2001, Lidhje midis hudoresisë dhe reduktimit në gjuhëve ballkanike, [në:] Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare XIX, Prishtinë, 283-286.
- 2002, Функционирование групп согласных типа НД в балканских языках, [në:] Материалы конференции посвященной 90-летию со дня рождения Агнии Васильевны Десницкой, Санкт-Петербург, Наука, 195 -198.
- 2002, Z zagadnień fonetyki bałkańskiej, Славистички студии 10, Универзитет св. Кирил и Методиј, 425-429.
- 2004, Z problemów fonetyki toskijskiej gwary Leshnji, (rec.), Studia Slavica IX, Toruń, 99-105.
- 2004, Xh.Ylli, A. Sobolev, Албанский тоскский говор села Лешня (rec), Südost Forschungen.
- 2005, Suche i Wysoka – synteza fonetyki bałkańskiej, [në:] Mieczysław Małecki. Człowiek, uczonek, organizator, Kraków, 213-219.
- 2005, Upitna intonacja u albanskom jeziku, [në:] Язык, личность, текст, изд. Языки славянских культур, Москва 513-518.
- 2005, Two “new” phonetic balkanisms, [në:] Studia Albanica in honorem W.Cimochoowski (bashkë- autor), Toruń, 147-153.
- 2005, Initial and non-initial clusters of a nasal sonant and homorganic stop in the Balkan dialects, Južnoslovenski filolog 61, 51-55.
- 2007, Charakterystyka fonetyki albańskiej, [në:] Albanistyka

poliska, Toruń, 183-197.

- 2007, Arealines fonetikos (fonetines geografijos) ivadas, Bibliotheca Salensis, Vilnius.
- 2007, Struktura e rrokjes së shqipes kosovare, Gjurmime albanologjike (filologjike) 37, 55-63.
- 2008, Fonetyczny model sylaby albańskiej, Acta Universitatis Carolinae, Phonetica Pragensia XI, 53-58.
- 2008, Studime filologjike albanologjike ne Poloni, [në:] Studime filologjike shqiptare, Akad. e shkencave dhe e arteve e Kosoves, Prishtine 163-177.
- 2008, Z zagadnień fonetyki arealnej, [në:] Językoznawstwo historyczne i typologiczne, Kraków 343-351.
- 2009, Studime polake për gjuhën shqipe – pjesa e parë, Jeta Arbëreshe, nr 63, 9, 25.

Witold Stefański

- 1989, Einige Bemerkungen zum albanischen Admirativ, Balcanica Posnaniensia IV, 407-411.

Zdzisław Wąsik

- 1980, Język albański w Jugosławii, [në:] Sprawozdania Wrocławskiego Towarzystwa Naukowego 33, Wrocław, 28-30.
- 1980, Tipet strukturalne të interogativit të gjuhës shqipe krahasuar me gjuhët e tjera (të Ballkanit dhe me gjuhët indoevropiane), [në:] Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare VII, Prishtinë, 241-243.
- 1985, Profesor dr Eqrem Çabej (1908-1980), wybitny filolog, twórca współczesnego językoznawstwa albańskiego, Acta Universitatis Wratislaviensis, Studia Linguistica 9, 99-114.
- 1986, Zu den strukturellen Frageexponenten im Albanischen (vom vergleichenden Standpunkt aus betrachtet, Acta Baltico-Slavica XVII, 307-328.
- 1986, Contrastive features of question exponents in Albanian, Lingua Posnaniensis XXIX, 11-21.

Krzysztof Witczak

- 1991, Ancient Epir and its inhabitants (bashkë- autor), Linguistique Balkanique 34, 1-2, 41-49.
- 1994, Proto-Albanian and the problem of the Ethnogenesis of the Albanian nation, Biuletyn Polskiego Towarzystwa Językoznawczego 50, 21-26.
- 1995, Were the Besans ancestors of the Albanians? A new opinion on the ethnogenesis of the Albanian nation. Thraco-Dacia 16, 1-2, 309-312.
- 1995, Some remarks on the Albanian vocabulary in the Paleo-Balkanic and Indo-European view (bashkë- autor), [në:] Analecta Indoeuropaea Cracoviensia Ioanis Safarewicz dedicata, Kraków, 123-135.
- 1996, New findings in Tracian etymology III-IV, Linguistique Balkanique 38, 1, 3-8.
- 1997, Greek and Albanian: new evidence for lexical connections, Zeitschrift für Balkanologie 33, 2, 215-220.
- 2002, On the etymology of Hittite kappar ‘vegetable’, ‘a product of the garden’ (bashkë- autor), [në:] Silva Anatolica. Anatolian studies presented to Maciej Popko on the occasion of his 65th birthday, Warszawa, 57-62.
- 2004, Albanian kopsht ‘garden’ and its cognates, Studia etymologica Cracoviensia 9, 179-186.
- 2004, The Indoeuropean origin of Albanian arboreal collectives ending with -ishtë, Zeitschrift für Balkanologie 40. (**Fund**)

"Fjalor Enciklopedik Shqiptar", pasuri e madhe kombëtare**Dr. Vilma Proko-Jazexhiu**

Qendra e Enciklopedisë Shqiptare, Tiranë

Kur para 23 vjetësh doli Fjalori Enciklopedik Shqiptar (1985), ai me plot arsye nuk u prit me gëzimin e zakonshëm që shoqëron daljen e çdo libri me vlerë për kulturën tonë. E kuptueshme sigurisht, sepse fjalori nuk është libër i zakonshëm, prandaj edhe gëzimi dhe interesimi nuk ishin të zakonshme, në të vërtetë ishin të jashtëzakonshme: Ai ishte vepra e parë enciklopedike në gjuhën shqipe, që do të mbetet në historinë e shkencës e të kulturës shqiptare si çdo fillim pozitiv, që hap një rrugë të re.

Dalja nga shtypi dhe vënia në qarkullim e vëllimit të parë e të dytë të "Fjalor enciklopedik shqiptar", Tiranë 2008, botim i ri, në tri vëllime, është me të vërtetë një ngjarje e shënuar në jetën shkencore të vendit tonë, por edhe të shkencës e të kulturës shqiptare në tërësi. Botimi i kësaj vepre enciklopedike, fryt i një pune të gjatë kolektive, përbën një arritje të rëndësishme të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Sot, kur po promovohet për herë të parë në Shqipëri në pastkomuniste një ndërmarrje e këtillë serioze shkencore e profesionale, me rëndësi të shumëfishtë për kulturën tonë në përgjithësi, s'ka si të mos përgëzohet një punë e këtillë dhe s'ka si të mos na gëzojë dalja e tij në ditë.

Vite të gjata pune komplekse, në një veprimtari shumëdisiplinare, u deshën për përgatitjen e botimit të ri Fjalor enciklopedik shqiptar (FESH), e cila është vepra e parë enciklopedike me shtrirje mbarëkombëtare, e hartuar me forca të përbashkëta të gjithë shqiptarëve. Ky botim u përgatit në rrethana të reja historike-politike të brendshme e të jashtme dhe në pajtim me to ndryshon shumë nga fjalori i mëparshëm, si nga ana sasiore, ashtu edhe nga përmbajtja e zërave e nga mënyra e trajtimit të tyre.

FESH përfaqëson një veprë shkencore sintetike e përgjithësuese. Ai pasqyron historinë e kombit shqiptar në tërësi dhe të trevave të tij etnike që nga lashtësia deri në ditët tona. Vend të gjerë zë pasqyrimi i gjithanshëm i jetës së shtetit shqiptar që me themelimin e tij më 28 Nëntor 1912. Po ashtu pasqyrohet historia e Kosovës, historia dhe jeta e popullsisë shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi, ana gjeografike-natyrore e trojeve të saj të banimit, zhvillimet dhe arritjet e reja politike, ekonomike, arsimore e kulturore-shkencore. Arbëreshët e Italisë e të Greqisë dhe në përgjithësi Diaspora Shqiptare, e vjetra dhe e reja, veprimtaria e institucioneve dhe e figurave të njohura të saj, janë vështuar si pjesë përbërëse e pandashme e Botës Shqiptare. Emërtimi shqiptar pasqyron përmbajtjen e veprës dhe ka të bëjë me kombin shqiptar dhe me trojet e tij etnike, pra nuk është një veprë enciklopedike e tipit universal.

Të gjithë zërat e fjalorit të mëparshëm janë rivështruar, ripunuar e plotësuar, shpeshherë rrënjësisht, janë mënjeluar vlerësimet ideologjike e politike të së kaluarës, që kishin sjellë shtrembërime të së vërtetës historike për një numër ngjarjesh e personalitetesh. Fjalori i ri enciklopedik përmban mbi 7200 zëra, ndër të cilët rreth 2350 zëra persona, në krahasim me rreth 5000 zëra të Fjalorit të 1985-ës, ndër të cilët rreth 700 zëra persona. Shtesa prej rreth 2300 zërash krahasuar me botimin e 1985-ës nuk ka të bëjë vetëm me përfshirjen e ngjarjeve e të dukurive të reja në Shqipëri, por pasqyron dhe realitetin e ri të krijuar në ditët tona për popullin shqiptar në Ballkan, veçanërisht pas çlirimit të Kosovës dhe shpalljes së Republikës së Kosovës. Në të pasqyrohen gjerësisht gjithë trevat shqiptare (qytete, fshatra, komuna; njësitë e gjeografisë fizike (male, fusha, lugjina, qafa, gryka, lumenj etj.); monumente të natyrës e të kulturës të këtyre trevave, shumë

ngjarje historike, të vjetra e të reja, ndër to edhe lufta e UÇK-së dhe fushata e NATO-s për çlirimin e Kosovës; institucionet arsimore, kulturore-artistike, shkencore, si dhe personalitete e figura historike ose të fushave të ndryshme të kulturës, artit, shkencës, sportit etj.

Në këtë botim të FESH janë përfshirë më gjerë edhe ngjarje të jetës ndërkombëtare, si edhe një varg personalitetesh të huaja politike, shkencore, nga bota e artit e fusha të tjera, që kanë pasur lidhje të drejtpërdrejte me vendin tonë ose kanë ndikuar në zhvillimet e jetës shqiptare, sidomos ata që kanë përkrahur aspiratat dhe përpjekjet e popullit tonë për një Shqipëri të lirë, të përparuar e demokratike.

Për realizimin e Fjalorit kanë bashkëpunuar dhe kanë dhënë ndihmesë të pazëvendësueshme punonjës shkencorë të instituteve dhe qendrave kërkimore-shkencore të ASHSH, pedagogë të Universitetit të Tiranës, Universitetit Politeknik të Tiranës, Universitetit Bujqësor të Tiranës, universiteteve të tjera të vendit, Akademisë së Arteve, Akademisë Ushtarake, Akademisë së Rendit, si dhe bashkëpunorë nga Universiteti i Prishtinës, Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe institucione të tjera të Kosovës, po ashtu nga Universiteti Shtetëror i Tetovës, Universiteti i Europës Juglindore (Tetovë) dhe nga institucione të tjera në Maqedoni, në Malin e Zi, nga Arbëreshët e Italisë, si edhe disa albanologë të huaj.

Rritje të ndjeshme në FESH kanë edhe ilustrimet. Formulimi grafik i veprës është kryer me shije artistike dhe me ambicien për një standard të ri.

Prof. Emil Lafe, si kryeredaktor i veprës e drejtues i projektit, së bashku me redaktorët e QESH, ka përballur një punë mjaft të vëllimshme dhe ka bërë përpjekjet më të mëdha për ta bërë lëndën të përshtatshme që vepra të arrijë standardet akademike më të larta, si në përmbajtje, ashtu edhe në paraqitje.

Kjo veprë është një dëshmi e qartë e pasurisë së vlerave tona historike e kulturore, një dëshmi të lashtësisë dhe të njësisë së fisit shqiptar, një dëshmi të mundësive për të ecur më shpejt përpara, një dëshmi dinjiteti njerëzor e kombëtar.

Dizionario Enciclopedico Albanese, grande patrimonio nazionale

La nuova edizione, in 3 volumi, del "Dizionario Enciclopedico Albanese"(2008), rappresenta un'opera scientifica sintetica e generalista, che ritrae il Mondo Albanese nella sua completezza, dall'antichità fino ai giorni nostri, la storia della nazione in generale e delle sue regioni etniche. Largo spazio occupa l'osservazione multiforme della vita dello Stato albanese fin dalla sua fondazione (1912). Vengono trattate anche la storia della Kosova, la storia e la vita della popolazione albanese in Macedonia e Montenegro, la parte geografico-naturale delle sue aree popolate, gli sviluppi e i nuovi successi politici, economici, scolastici e culturali. Gli Arbëreshë d'Italia e di Grecia e in generale la diaspora albanese, la vecchia e la nuova, l'attività delle istituzioni e delle sue autorità, sono state viste come parte integrante e inscindibile del Mondo Albanese. Nell'"Enciclopedia" viene trattato l'individualità nazionale del popolo albanese, la sua antichità e l'autoctonia nei suoi territori, i rapporti con gli altri popoli e il suo posto nella storia e nella cultura mondiale. L'Enciclopedia comprende più di 7.200 voci, fra cui 2350 persone.

Laskarina Pinoçi, Bubulina

(vjen ka nr.64)

4 - *Fëmijëria , martesja dhe lidhja e saj me organizatën për çlirim e Greqisë" Filiaq Eteria"(Miqte e Popullit)*

Këtu lindi më 11 Maj 1771 vajza Laskarinë, që do të merret emrin e nënës të njeriut që e ndihmoi të lindte në qelinë e burgut. Me fëmijën në krahë ajo u kthye në vendlindjen e saj Hidra, ku jetonte. Babai i saj, Koçini Konduroti, i shet disa toka: "Koçini"- emër që e trashëgonin ata që iknin nga vëndi i tyre. (Në Palasë ekziston ende ky toponim.) Në këto kushte nëna Shqevi vetëm me fëmijën tre muajshe vendoset në ishullin fqinjë Specaj, pasi aty flitej shqip (Arvanitika).

Në ishullin e ri, ajo zbriti e vetmuar, me një foshnjë dhe pa mbështetje. Shtëpia e re e Bubulinës në Specaj ishte në lagjen "Kunupica", mendoj se rrjedh nga fjala shqipe "kunupi". Shtëpia e saj dy katëshe me mure guri, e lyster me gëlqere të bardhë, mbuluar me tjegulla të kuqe, ku dritaret e saj shikonin kalldrëmet e ishullit dhe detin. Kjo më kujton Palasën ku shtëpitë ndërtohen me mure guri dhe me vështrim nga deti. Në Specaj vajza do të rritej mes aromës së barutit dhe historive të jataganit, ku Kara Ali Pasha kishte thënë: "Dua të mos mbetet asnjë gurë mbi shkëmb dhe asnjë zog në pemë". Dhe Jeniçerët e tij e dogjën ishullin duke lënë pas një re tymi. (Istorika nr. 139, viti 2002, f.28,32,33).

Në Specaj fëmijët mermin edukatë fetare, ku prifti u mësonte të lexonin duke recituar tekste fetare, por u sollën edhe mësues nga perëndim. Këtu Bubulina mësoi shkrim e këndim dhe dallohej për një kaligrafi në shkrim. Po cila ishte ëndra e saj? -Të bëhej kapitene e një anijeje. Vdekja e babait në qelitë e Stambollit i kishte dhënë një urrejtje abstrakte, ndërsa masakra e Karali Pashës në ishull zgjoi tek Laskarina një urrejtje të dukshme... Origjina e saj Hidriote e ngacmonte për të parë vendlindjen. Në Hidra çmallet me vendet piktoreske. Por vajza rritej. Ajo njihet me Dhimitër Jonuzasin, mjeshtër anijesh, njëri shumë i pasur e shpirtmirë, martohet dhe vë kurrorë në kishën e "Trinitetit" në Specaj, bëhet nëne, rrit tre fëmijë: Janin, Jorgon dhe Maria. Ajo me të shoqin filluan të rrahin portet e Mesdheut. Nga tregtia që bënin u shtuan të ardhurat. Ndërtojnë tri anije të tonazhit të madh. Mallrat që blinin në brigjet e detit të Zi i shisnin në portet spanjolle, franceze, italiane, afrikane etj. Por në det të hapur ata ndesheshin me anijet pirate. Pas vrasjes së Karali Pashës një anije pirate e paguar nga admiralit turk e qëllon me top anijen tregtare të drejtuar nga burri i Laskarinës duke e fundosur në detin Mesdhe.

Laskarina tani jetonte si një vejujshë, me kujtimet e Dhimitrit, ku ende ishte 26 vjeç por me ndërhyrjen e miqëve të saj ajo martohet me Bulisin. Kjo martesë i dha asaj emrin që do të njihet në mbarë Greqinë dhe nëpër botë, Bubulina. Brenda një kohe shumë të shkurtër ajo forcon flotën e saj 400 tonëshë. Bulisi përveç Mesdheut kaloi dhe Atlantikun deri në Argjentinë etj.

Çifti shtonte pasurinë. Kjo çoi në ndjekjen hap pas hapi nga qeveria turke. Lëvizja në portet e Mesdheut e bindi Bulisin për tu lidhur me organizatën për çlirim e Greqisë "Miqte e popullit", e themeluar në Odesa (në vitin 1814).

Më 11 Maj 1811, kur Bubulina me fëmijët po festonin 40 vjetorin e lindjes, lajmi i zi ndërpret festën. Bulisi i saj ishte vrarë, nga piratët francezë të paguar nga turqit osmanllinjë.

Marinarët kërkuan nga e shoqja që të vazhdonte punën e të shoqit. Ajo merr vendimin për të drejtuar anijet si Kapitene dhe për të vazhduar punën e nisur bashkë me Bulisin vite me parë. Turqit e ndjekin hap pas hapi aktivitetin e saj tregtar e patriotik.

Nga Sulltan Mahmuti mbrin fermani për sekuestrimin e anijeve të saj. Kjo e detyron të udhëtojë drejt Stambollit, duke bërë takime nga

doc. Odise Çaçi

Universiteti " Ismail Qemali", Vlorë (Shqipëri)

krerët e kishës greke, tek konsulli rus dhe së fundi tek nëna e Sulltanit. Merr fermin nga sulltani, që anulonte sekuestrimin e anijeve të saj në Mesdhe.

Në Stamboll ajo lidhet me njerëzit që drejtonin organizatën për çlirim e Greqisë "Filiaq Eteria"("Miqte e Popullit"). Aty ajo mëson se në këtë organizatë bënin pjesë njerëz nga gjitha shtresat e shoqërisë greke: Ata ishin prelatë, bankierë, tregtare, ushtarakë, funksionarë, diplomatë, karrierë, aristokratë dhe personalitete të shquara botërore.

Në kujtesë të saj kishte ngelur takimi me Papa Grigorin V, i cili e "këshillonte që të kthehet rrugë pasi ato nuk ishin punë për gratë dhe se duheshin të piqeshin kushtet të paktën për 5 vjet", dhe, siç tregojnë historianët, ai, pa i thënë gjë, "e kishte çkishëruar këtë trime". (Istorika, nr.139,f.31,viti 2002).

5 - *Roli i Bubulinës në revolucionin grek dhe prapaskenat politike.Vrasja e Bubulinës.*

Bubulina, me tu kthyer në ishullin e saj, në Specaj më 3 Mars 1821, ul nga anija e saj "Agamemnon" flamurin turk dhe ngre flamurin me një Feniks të madh. Ajo deklaroi: "Rroftë liria".

Dhe nga anija e saj "Agamemnoni" dhe shtatë anije të tjera do qëllonin me top për të dhënë sinjalin e fillimit të Revolucionit grek. Arvanitasit ishin rreshtuar në krah të revolucionit grek: Mjauli, Kondurioti, Kollokotroni, Marko Boçari e dhjetra të tjerë. Bubulina lufton në Nafplio, e Argos, ku njerëzit e përshëndesnin "Zonjë e Madhe" (Megali Qiria).

Më 25 mars 1825 ajo përkrah Germanos, shton rrethimin e Nafplos dhe feston fitoren e revolucionit grek në Kalavita të Patrës (vënd ku është ngritur flamuri për të shpallur pavarësinë e Greqisë) duke e bërë 25 marsin një ngjarje mbarëkombëtare.

Në betejën e përgjakshme të Nafplos me turqit ajo humben djalin e saj Janin.

Laskarina mendon hakmarrjen, në emër të gjakut të dhjetëra të vrarëve dhe marrjen me çdo kusht të Tripolicës. Me rënien e Tripolicës dhe të Nafplos ajo kap rrob oficerin turk dhe kërkon të hakmerret për djalin e saj, por Kollokotroni zbut zëmërimin e saj: "se, i gjallë oficeri turk, mund të ndërrohej me shumë luftëtarë të zënë rrob nga turqit".

Po aq vendimtar ishte dhe roli i Bubulinës për marrjen e Nafplos.

(2 – ka më)

Laskarina Pinoçi, Bubulina - Bubulina nasce l'11 maggio 1771 nella prigione delle "7 Torri" sulle coste della Marmara. Sua madre la porta prima a Hidra, poi è costretta a sistemarsi a Speca, un'altra isola dove si parlava solo albanese (arvanitika). Qui Bubulina cresce in mezzo all'aroma della polvere da sparo e delle storie della sciabola; e viene educata religiosamente. La morte del padre nel carcere delle "7 Torri" e il massacro di Kara Ali Pasha a Ishull sveglia in Bubulina l'odio per gli occupatori ottomani. Si sposa ventiseienne a Specaj ma gli spioni gli uccidono il marito Demetrio. Dopo un po' Bubulina si risposa con un altro arvanitas, Bulis: con la sua flotta battono il Mediterraneo fino in Argentina. All'età di 40 anni pirati francesi le uccidono a tradimento anche Bulis, affondandolo nel Mediterraneo. Bubulina allora diventa capitano delle sue navi. I suoi incontri a Istanbul con la madre del sultano, e quello col papa Gregorio V non allontanano l'arvanita dalla costa himariota e dalla lotta per la completa liberazione della Grecia. Si lega all'organizzazione per la liberazione della Grecia. E il suo contributo cementifica le fondamenta della nuova Grecia, a cui danno il loro apporto essenziale molte decine di eroi arvaniti, albanesi: ben 90 su un totale di 100 eroi che conta la rivoluzione greca.

Gjuha shqipe dhe ndikimet e latinitetit mesdhetar

Irena Fistani

pedagoge e gjuhës frënge në Universitetin e Shkodrës (Shqipëri)

Ideja kryesore e studimit të pranishëm, lidhet me pohimin dhe nxjerrjen në pah të vlerave etnokulturore të shqiptarëve, të pranishme së tyre të hershme në Evropë dhe të rolit të tyre kulturë-bërës në mjedisin e lashtë evropian dhe botëror të sotëm.

Prej një trualli bregdetar dhe me mundësi të shumta lidhjeje me Europën nëpërmjet tokës e detit, Iliria e moçme dhe Shqipëria e sotme, ne fakt, kanë qenë kurdoherë brenda Europës, madje mu në zemër të saj.

Për këtë ndër të tjera, na dëshmojnë edhe gjuha dhe onomastistika shqiptare, veshjet dhe traditat kulturore, sa të moçme e interesante, aq edhe tërheqëse e deshmitare të kohrave. Në këtë mes, sikundër do të perpiqemi të zhdavarisim në rreshtat e mëposhtëm, një rol të rëndësishëm ka frazeologjia shqiptare e popullit tonë.

“Jashtë shoqërisë nuk ka gjuhë. Gjuha është e lidhur ngushtë me veprimtarinë më prodhuese të njeriut. Gjuha e një populli pasqyron kulturën e tij, zakonet në zhvillimin e tyre historik. Prej këtej rrjedh edhe rëndësia e madhe e gjuhësisë për arkeologjinë pohimin e lashtësisë e të autoktonisë së shqiptarëve në trojet e veta amtare e në fqinjësi të lashtë e të pasqyrueshme më të hershme të brigjeve të Mesdheut, sidomos me latinët e grekët. Gjuha ruan shumë gjurmë nga kultura e vjetër e tyre, megjithëse me kohë ato kanë marrë përmbajtje tjetër.” (Shih: *Nertian Ceka, Myzafer Korkuti: Arkeologjia, SH.B.U. Tiranë 1998, fq.17*)

Kultura arbërore në tërë shtrirjen e saj gjeografike me daljen në detin Mesdhe, me lidhjet që ka pasur, e ka, me vendet latine e greke tregon për një shkëmbim kulturash që janë pasqyruar në gjuhën shqipe.

Lidhjet, afrimet, përqsasjet e paralelet me gjuhët e mesdheut me bazë latine tregon për vazhdimësi të hershme mesjetare shqiptare me kulturën ilire, gjë që dëshmon edhe për një vazhdimësi etnike, duke provuar se shqiptarët janë autoktonë dhe shqipja është faza më e re e ilirishes së vjetër. Që nga latinishtja, e deri tani në kohën e sotme, dy brigjet tona të Adriatikut e të Jonit janë kapërcyer këmbërazë, herë nga forca ushtarake, herë nga turma e grupe të mëdha popullore për të gjetur plang e shtëpi tek njeri tjetri. Legionet romake që kishin pikësnyim Shqipërinë do t'i linin vendin turmave të mëdha arbëreshësh që, duke dashur të shpetonin nga pushtimi osman, do të linin vendin e tyre dhe do të mësynin brigjet e Greqisë ishullore, pastaj të Kalabrisë e deri në Sicili.

Prania e arbëreshëve në Greqi e në Italinë fqinje ka qenë dhe mbetet si urë miqësie, si një shenjë afërsie e lidhjes shpirtërore e kulturore të popujve tanë.

Pa dyshim një pikëtakim fqinjësie e tillë shumëshkullore e iliro-shqiptarëve me latinitetin mesdhetar ka bërë që shumë dijetarë e shkrimtarë, diplomatë e gjuhëtarë francezë të interesohen për kulturën shqiptare në përgjithësi dhe gjuhën shqipe në veçanti, duke vërtetuar me fakte historike dhe vërtetësi gjuhësore për pjesëmarrjen e saj dinjitoze në familjen mesdhetare evropiane.

Shtegtimi i emrave etnike ka ndjekur dhe pasqyruar shtegtimin e popujve tanë. Nga Ballkani i lashtë drejt ishullit të Sicilisë, janë përmendur shtegtime të personaliteteve më në zë të kulturës Helenike. Diku në afërsi të Xheles (it. Gela) prëhen eshtrat e tragjedianit të madh grek Eskilit, këtij vigani të mendimit të lashtë e artit dramatik antik. Në librin me ese “Eskili, ky humbës i madh”, Ismail Kadareja ndër të tjera shkruan se jeta e atij tragjediani të lashtë që lidhur ngushtë me Sicilinë, ku edhe mbylli sytë si ushtar i thjeshtë.

A nuk është për t'u habitur kjo? Më i madhi tragjedian i Greqisë së lashtë vdiste në Sicili dhe, për ironi te fatit, mbi varrin e tij nuk shënohet që ai të ketë qenë një krijues, por thjesht “Eskili, i bir i Euforionit”.

Në lufrat Garibaldine per bashkimin e Italisë, Garibaldi pati ushtarët më trima që ishin arbëreshë dhe që ai i dërgonte “në ballin e luftës”.

Pushtimet romake, tregtia me Italinë, spostimet e njerëzve etj... flasin për një farë romaniteti në pellgun e vendeve që lagen nga Adriatiku, ku përfshihet edhe gjuha ilire, gjurmët e të cilës kanë mbërritur deri në shqipen tonë të njësuar.

Por edhe direkt lidhjet me Francën kanë rrënjë të thella. Dokumenti i parë në frëngjisht i gjetur në Shqipëri, i ruajtur në Arkivin Kombëtar të Shqipërisë i përket vitit 1614. Por ky është një dokument zyrtar i shkruar, ndërsa marrëdhëniet me frëngjishten si gjuhë e folur shkojnë dhe më larg. Ato i referohen vitit 1272, periudhë e cila i përket Mbretërisë të Napolit dhe Shqipërisë.

Në atë kohë kjo mbretëri e gjerë dhe e rëndësishme drejtohej prej Charlit të parë d'Anjou, vëllai i mbretit të Francës.

Revolucioni francez ka shënuar një kthesë të madhe në lidhjet që bashkojnë shqiptarët me Francën.

Janë këto ide të ndritshme të “Siècles des Lumières” (Shekullit të Dritës) që kanë udhehequr e drejtuar një pjesë të madhe të elitës të intelektualeve shqiptarë.

Janë këto ide që u dhanë zemër patriotëve shqiptarë të marrin pjesë me pushkë e me penë në Revolucionin e madh shqiptar për fitimin e pavarësisë.

Shumë studentë shqiptarë u formuan dhe u ndërgjegjësuam politikisht në Universitetet e rëndësishme të Francës, si ai i Sorbonës etj..., ku mund të përmendim Hoxha Tahsin, Said Toptani, Pashko Vasa e Sami Frashëri, të cilët u vunë në krye të luftës e të punes për Rilindjen Kombëtare.

La lingua albanese e gli influssi della latinità mediterranea - L'idea principale di questo studio si lega all'affermazione e alla messa in evidenza dei valori etnoculturali e sociolinguistici degli albanesi, della loro presenza antica in Europa e del loro ruolo culturale attivo nell'ambito antico europeo e mondiale odierno. I legami, le affinità, i confronti e i paralleli con le lingue del mediterraneo e, nel nostro caso con altre lingue a base latina, dimostrano che esistono nessi antichi medievali albanesi con la cultura illira, cosa che testimonia anche continuità etnica, e provano che gli albanesi sono autoctoni e la lingua albanese è la fase più nuova della vecchia lingua illirica. La presenza degli Arbëreshë nella vicina Italia è stata e resta come ponte di amicizia e di legami spirituali e culturali dei nostri due popoli. Senza dubbio un punto d'incontro di tale vicinanza multisecolare degli illiro-albanesi, con la latinità mediterranea, ha fatto sì che molti scienziati, albanogi e scrittori si interessassero della cultura albanese in generale e della lingua albanese in particolare, accertando con fatti storici e veridicità linguistiche la sua partecipazione dignitosa alla famiglia mediterranea europea.

BIBLIOTEKA e JETËS ARBËRESHE**Emanuele papas Giordano:***Vangjeli, i pjerrë arbërisht* – 2006 – ff. 230 € 10*Mbledhje këndimesh arbëreshë* – 2006 – ff. 160 € 10*Himne Bixantinë* – 2005 – ff. 217 € 10*Gramatikë Arbëreshë* – 2005 – ff. 70 (fotok.) € 5*Fjalor (Dizionario Arbëresh-Italiano / Vocabolario Italiano-Arbëresh)* - edic. 2000 - ff. 715 € 30*Shpalla e Skanderbeut di B.Bilotta* – 1967 – ff. 217 € 15*Folklore albanese in Italia – Festeggiamenti Pasquali a Frascineto (1957)* (fotok.) € 5**Jeta Arbëreshë:***(tetë vjet. 2002-2009)* € 400; për Institucionet € 600*Pajtim vjetor (abbonamento annuale)* ... € 30; për Institucionet € 60

Vilhelme Vranari (Haxhiraj)

Vilhelme Vranari (Haxhiraj) lindi në Kaninë (Vlorë) më 8/12/1944, në një familje të lashtë, atdhetare, themeluese e këshjellës së Kaninës dhe me trashëgimi kulturore. Me këtë familje nisi fisnikëria feudale e Arbërisë, e njohur historikisht qysh nga viti 1000. Një nga të parët e kësaj familjeje, David Vrana-Arianiti prej (1001-1018) ka qenë strateg në Perandorinë Bizantine. Vilhelma është pinjolle e familjes së princit Gjergj Arianiti, familje që luajti rol të rëndësishëm qysh nga shek XI, por shkëlqimin e arriti në shek.XIV-XVI në kohën e sundimit të princ Gjergj Arianitit ose (Madhështori). Djali madh, Kostantin Arianiti, që u rit në oborret princërore të Italisë, u bë zot i Monferratos, Kapedan i Pizas, më 1478 protonoter i Papës, aq i shakthët, sa shmangu luftën mes Romës dhe Karlit të VIII (mbreti i Francës). Kostantin Arianiti vdiq më 1531 dhe u varros në Kishën e 12 apostujve në Romë. Mbretëresha Donika, gruaja e Skënderbeut, është motra e Kostantinit, u strehua në oborin mbretëror të Napolit, ku reflektoi virtetet e saj prej fisnikeje. Gjyshi i shkrimtares, Xhevit Ali Vrana, kreu studimet në American College, Stamboll, dhe u specializua për hortikulturë në Aleksandri (Egjypt), zhvilloi ekonominë dhe tregtinë me Italinë. Ka përkrahur lëvizjen për Pavarësi përkrah Ismail Qemalit. Një nga djemtë e tij, (xhaxha i autores) Skënder Xhevit Vrana, pas studimeve në Politeknikumin Harry Fultz, u lauria në Universitetin e Siënës (Firenze). Më pas Konti italian Orlando e emëroi drejtor në fermën e Llakatundit, pranë Vlorës. Më 1944 Skënderi internohet nga gjermanët dhe vdiq në moshën 33 vjeç, në Mat'hauzen. Më 1945, me reformat komuniste - shpronësimet, sekuestrimi i pasurisë dhe luftën e ashpër kundër fisnikërisë dhe intelektualëve - e lanë familjen dhe gjithë vendin në varfëri. Sigurimi i shtetit më 1947 vrau xhaxhanë e vogël të autores, Batjar Vrana, 18 vjeç, student në shkollën Tregtare, Vlorë. Kur kthehej në shtëpi, spiunët i vendosën në samar të mushkës një gozhdë. Kafsha e tërhoqi zvarrë nga Vlora në Kaninë. Copat e trupit i mblodhën me pisharë. Pastaj vranë 3 nipërit e familjes Vrana, vëllezërit Sharra: Varën në litar Injnier Abdyl Sharra (lauria në Itali), më 1947 vranë vëllanë e dytë, tregtarin Shyqyri Sharra dhe më vonë vëllanë e vogël, Lekmi Sharra, vdiq i asfikuar në një kasafortë hermetike, se duhej të dorëzonte florin inekzistent, që ia kishte rëmbyer pushteti i ri komunist. Dy vëllezërit Imer Sharra (profesor në Universitet -Romë) dhe Hysni Sharra tregtar në Paris, u dënuan me vdekje në mungesë. Nuk u kthyen kurrë në atdhe, se i priste vdekja. Vilhelme Vranari qysh 6 vjeçe ka njohur luftën e klasave, më e egra që ka njohur njerëzimi: i burgosën dhe dënuan me burg të përjetshëm babanë Vëhip Xhevit Vrana, si antipushtet. Xhaxhanë e saj, Mynyr Vrana, e burgosën 8 vite si antikomunist, se nuk piu dollinë për mustaqet e Stalinin. Internimet e gjata të familjes Vrana nga 1952-55 dhe nga 1966-1990 lanë pasojë të rënda. Kush e beson se Shqipëria e bukur dhe e pasur, ishte tejet e vuajtur dhe e varfër, aq sa çdo nënë i ushqente barktharët e saj me lakra pa vaj. Vendi u kthye në varrezë mbushur me varre pa emër dhe në një burg gjigant, ku kishte vetëm rojtare dhe të burgosur. Shkrimtarja është arsimuar sa në internim e nga një vend, në tjetrin. Median e përfundoi në shkollën e parë shqipe “28 Nëntori”, Vlorë. U diplomua në shkollën pedagogjike “Jani Minga”, punoi 4 vite mësuese fshati dhe kryente Universitetin, dega Gjuhësi-Histori me korrespondencë. Në vitin 1966 i ndalohet diplomimi, kur duhej të likuidonte edhe tri (3) lëndë dhe pushohet nga a. Internohet përsëri familja Vrana. Me këmbëngulje rifitoi të drejtën e studimeve, në degën Histori-Gjeografi. U diplomua me rezultate maksimale më 1975, por pa të drejtën e ushtrimit të mësuesisë. Punoi 25 vjet punëtores dhe vetëm më 1990-të rifilloi punë në arsim dhe u muarr me publicistikë për liritë dhe të drejtat e femrës. Më 1997, i rimohojnë profesionin si demokratke. Është njëra nga 4-5 femrat e para që u ngritën kundër diktaturës. Është themeluese dhe Kryetare e Lidhjes Demokratike të Gruas (LDG) -dega Vlorë, 1991-98, si dhe Anëtare e Këshillit Kombëtar të LD.G.Sh. dhe Partisë Demokratike Shqiptare. Duke u marrë me politikë gjeti veten. Në dhjetor 1996 (në moshën 52 vjeç) u realizua ëndrra e saj. U botua vëllimi i

e shkruar nga autorja e vetë

parë poetik. Më pas shkroi thaujse në të gjitha gjinitë: në prozë (skicë, tregim, novelë), fabulë, përrallë dhe roman. Në 13 vite si krijuese, po boton të 23-ën veprë letrare dhe ka gati për botim disa të tjera. Gjinja letrare, ku autorja ndihet më mirë është romani. Deri tani ka botuar 10 romane dhe një e ka në botim. Vepër e suksesshme është: trilogjia “Vështroni Meduzën” (3 volume), ku në mbi 1100 faqe përshkruhet realiteti shqiptar, që nis nga shek. i XV-të dhe deri në rënien e diktaturës. Autorja ngrihet kundër dhunës ndaj femrës. Në veprat e saj spikat Realiteti Real, personazhi femër dhe problemet sociale që shqetësojnë shoqërinë dhe sot. Shkrimtarja ka botuar në sasi, në disa gjini dhe merret me publicistikë në disa media, si në Tiranë, Kosovë, SHBA, Londër, Kanada, Itali, Bukuresht, dhe 2006-2008 Kryredaktore e Gazetës “Kanina”. Puna e saj është vlerësuar nga kritika profesionale, analistë, shkrimtarë dhe lexues, vendos të huaj. Edhe pse 65 vjeç, e pranon sfidën, duke u ballafaquar me letërsinë shqipe dhe të huaj. Ja si e përcakton krijimtarinë e Vilhelmes poeti, shkrimtari, publicisti i shquar Mujo Buçpap: “Nëse vepra e Vilhelme Vranarit do të përkthehej, bota do të njihnte letërsinë dhe artin e saj tronditës. Pa frikë them se proza e saj është e një niveli evropian dhe botëror. Unë mund ta vlerësoj shkrimtaren Vilhelme Vranari si Herta Mulerin shqiptare, e cila fitoi çmimin nobël për letërsinë 2009. Që të dyja këto shkrimtare që kaluan shumicën e jetës në “Perandorinë e së Keqes”, siç pati deklaruar Presidenti Regan, kanë të përbashkët jo vetëm persekutimin e gjatë komunist, përndjekjet, burgosjet dhe internimet, por edhe artin e të shkruarit, tematikat dhe personazhet. Dallimi ekziston vetëm në faktin se Herta Muler shkruan në një gjuhë të madhe si gjermanishtja dhe ka pas vetes një shtet si Gjermania. Por dallon edhe te vuajtjet e Vranarit, të cilat janë të tmerrshme, të vazhdueshme dhe rrënuese. Vranarit nuk iu lejuja nga regjimi komunist që të botonte asgjë deri në rënien e tij në dhjetor 1990.” Shkrimtarja Vilhelme Vranari (Haxhiraj) është vlerësuar brenda dhe jashtë shtetit me këto çmime: a) Në vitin 2006 me çmimin “Petro Marko” për romanin “Dilema e së nesërme”, nga Bashkia Vlorë dhe Lidhja e Shkrimtarëve, dega Vlorë. b) Më 2007, për “Poezinë e mirinterpretuar”, nga Lidhja e shkrimtarëve dhe Biblioteka Vlorë. c) Më 2008 me çmimin “Protagonist i vitit 2008”, me “Unaza e Prangosur”, si romanciere. d) Më 18 prill 2009 me Çmimin Nacional “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” - Torino-Itali. e) Më 10-6-2009, vlerësohet në Kosovë me çmimin: “Mirënjohje e Lidhjes së Prizrenit”. f) Më 29 korrik 2009 me vendim të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, shkrimtarja Vilhelme Haxhiraj fitoi Pension të Posaçëm. g) Më Dhjetor 2009 u përkthye në rumanisht libri e ri poetik i Vilhelme Vranari Haxhiraj “Rrënjët”.

Vilhelme Vranari (Haxhiraj) - Vilhelme Vranari è nata a Kanina (Vlora) nel 1945, rampolla della famiglia del principe Giorgio Arianiti. Appena seienne, è vittima della lotta di classe, la più crudele che ha conosciuto l'umanità: le condannano il padre all'ergastolo, le condannano, internano e uccidono i parenti. Con molta difficoltà riesce ad istruirsi, tra il confino e qua e là: media e magistrali, poi lavora 4 anni come insegnante e intanto frequenta l'università per corrispondenza. Nel 1966 le viene invalidato il diploma e cessa di insegnare. La famiglia Vranari viene nuovamente confinata. Nel 1975 Vilhelme si diploma ma senza diritto di esercitare la professione. Lavora per 25 anni come operaia. Nel 1990 ricomincia a insegnare, e a e a battersi per la libertà e i diritti della donna. Nel 1997 la licenziano dal lavoro in quanto democratica: è una delle prime donne che si è ribellata alla dittatura. Fonda la lega Democratica della Donna. Entra in politica e ritrova se stessa. A 52 anni pubblica il suo primo libro e scrive su molti generi letterari: poesia e prosa, favole e romanzi. Oggi, 65enne, Vilhelme Vranari è annoverata, dalla critica e dai lettori, tra i più grandi scrittori albanesi. A testimoniario sono i riconoscimenti e i molti premi letterari vinti, dentro e fuori Albania.

Giordano protopapas Emanuele, *Vangjeli i perëndishëm dhe i Shëjtë*, i pjerrë arbërisht e i redaktuar nga E.G., pro manuscripto, Purçill/Ejaninë, Pashkët 2010

Pas *Vangjeli*, të botuar te viti 2006, zotit Manuell i ngit të bënj edhe *Vangjelljarin*, ç'i mungon Eparkisë së Ungërës. Te ky libër gjënden gjithë Vangjelet që prifti bixantin arbëresh i djozasën popullit gjatë tërë vitit liturgjik. Por edhe një tërë vepër të rëndësishme për Eparkinë zoti Manuell, dhaj këto ditë, mbaroi së pjerri arbërisht: *Epistollarin*. E njëje do të shohë dritën.

Fortino Arhjim. F.Eleuterio, *La Madonna del Buon Consiglio, l'Odigitria degli Arbëreshë*, Sussidi catechetici 43 - Besa, Roma 2009

Këtë libër Arhjimandriti Fortino ja dhuron kujtimet të zotit Alessandrini - prift i Shën Benedhitit, ç'e drejtoi tek udha e prifërisë – po edhe katundit 'tj, Shën Benedhitit. Sepse këtu ka shekul nderohet Shënmëria e Mirëvulisë, të Xhenacanit, e asaj tek shek.XVIII ju stis një qishë ka fëmila Rodotà. Autori, tek libri, ndër të tjerat, boton edhe Himnin e Varibobës "Mëma e Bonkunxillit", arbërisht, që gjëndet tek vepra e tij "La Vita di Maria".

Palazzo S. – Pace N., *Ribellismi*, Centro di Ricerca e Documentazione sul fenomeno mafioso e criminale, Università della Calabria, Rende 2009

Është një libër që na buthton dica momente historikë e dica personaxhe që shërbien për të ndërrojin politikën e shoqërinë. Ndë mes të njerëzvet, janë ata që ngrëjtin kryet e u bëhë "rebele". Nga kjo fjalë del titulli i librit. Nando Pace, arbëresh nga Spixana, ndër të tjera shurbise, te ky libër shkruan për Peshkopin Frangjisk Bugliari, Presidentin e Kolegjit Korsini, dhe për revolucionarin Axhezilào Milanin nga Shën Benedhiti, që provoi sa të vritë Rregjin Borbon të Napolit, te viti 1856.

Riza Selman, *Vepra të zgjedhura*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë - Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë 2009

Me rastin e 100vjetorit të gjuhëtarit shqiptar Selman Riza, Qendra e Studimeve Albanologjike dish të ribotonij veprat më të mira të këtij studiozi. Janë studime për historinë e gjuhës, mbi emrin, mbi sistemin e foljes, mbi përemrat etj... Libri intereson jo vetëm gjuhën e folur ndë Shqipëri, ndë Kosovë e ndë Maqedoni, po edhe Arbërishten: Autori e citon shpesh, sepse arbërishtja vlon dica fenomene të vjetër të gjuhës.

Cassiano Domenico *Processo del 1857 ai patrioti di San Demetrio Corone, Macchia, San Cosmo, Vaccarizzo, San Giorgio, celebrato a Rossano dopo l'attentato di Agesilao Milano*, Il Coscile, Castrovillari 2009

Historiku arbëresh Domenico Cassiano na

dhuron një tërë vepër ku na flet për kontributin e Arbëreshëvet për Rilindjen italiane. Këtë herë ai folen mbi origjinën e atentatit që Axhezilào Milano i bën Rregjit të Napolit ndë vitin 1856, mbi dënimin e tij me vdekje, mbi procesin që i bëhë Arbëreshëvet. Gjithë kjo histori inkuadrohet ndë ambientin kulturor të Kollexhit të Shën Ndranian, Shën Mitër, ku u rrit një gjeneratë studentësh (laikë e prisrtrash) me ide liberale.

Masci Lucio Franco, *Gli insediamenti albanesi in Italia (Morfologia e architettura). Nuclei urbani della Calabria citra*, Comune di S. Sofia d'Epìro, 2004

Një libër që na buthton si u formuan katundet arbëreshë. Autori studioi format e katundeve që gjënden ka e djathta e lumit Krati - Shën Sofia, Strighari, Vakarici, Mbuzati, Shen Mitri - dhe erri të ipotixarënj se më parë, kur erthin ndër Talljet, Arbëreshët gjëlljitin ndër kalive kashtje, pra bëhë shpëtë me materiale më të fortë dhe i stistin rreth një vendi të hapët që thërritet "shesh". Tri o katër shtëpi, rreth njëi sheshi, formuan një "gjitoni". Libri është i zbukuruar me shumë fotografi.

Emmanuele Stefania, *Camminate civitesi - Udhëtime çiftote*, Associazione Culturale "Gennaro Placco", Civita, 2009

Çifti i dhuron turistit një ndër bukuritë më pitoreske që ka Arbëria. Vit pas viti shtohen turistët që venë Çivit për t'e vizitojnë, për të fjetur atëj dica ditë ndër B&B, që ndë vitet e sprasëm u haptin e presën me shumë mirësi njerëzit që duan të shkojnë ca ditë mbë paqë e ndë mes t' intereseve kulturore. Autorja e këtij libri illustron gjithë udhëtimet që mund bëhen Çivit, ndë katund e jasht katundit: ajo merr turistin për dorje e e qellen të shorë bukuritë naturale e kulturore të këtij vendi.

Bruno Vincenzo, *Një cakule me përrallezë - Un sacco di favole*, testi ideati e scritti nell'arbrisht di Civita, Associazione Culturale "Gennaro Placco", Civita 2008

Autori është i njohur ndër katundet arbëreshë pse shkruan si flitet e mund t' ndëlojën gjithë. Problemi i parë i arbëreshëvet është nani të alfabetizohen, vjen me thënë të xënë të djozasjën e të shkruajën arbërisht. Këtë e ndëloj shumë mirë Viçenx Bruni e te ky libër mbodhi më se 50 përrallëza, që shkruajti ai vetë. Kanë vlerje si krijime originale po edhe si tekste që mund të djozasen, pa probleme, ka gjithë.

Campofredano Pinuccia (a cura), *Chieuti e i Comuni di San Giorgio in Italia*, Comune di Chieuti, 2009

Është një libërth që rrëfyn jetën e shëjtit Gjergj, që jetoi ndë shekullin III dhe që vrau dragun, simboli i së keqes. Autorja më parë na flet për kultin e Shën Gjergjit ndë katundin arbëresh të Qeftit, ku ditën e festës, 23 prill të çdo viti, bëhet të rrjedhurit e qerrevet; pra

shkon e na flet për gjithë katundet e Talljes ku edhe sot festohet ky shëjt i math.

Schirò Di Modica Giuseppe, *Radhoi i sprasëm*, Hora e Arbëreshëvet, Piana degli Albanesi, 2009

Autori mbëlliti ciklin e kësaj rivistje, që ish një zë i veçantë, pse vej ture gjetur dica aspekte kuriozë dhe interesantë të kulturës e të jetës arbëreshe. E mbami si një dëm mbylljen e kësaj rivistje, pse vjen e na mungon një pjesë e kulturës arbëreshe. Ky numri i fundit është shumë i begatë me artikuj që, në të shumtën, drejtori ri-paraqet për interesin e veçantë që kanë.

Borsetta M.P. - La Vena V. (a cura di), *Organi e organisti in Calabria - Contributo per lo studio dell'organo e delle tradizioni musicali religiose*, Associazione musicale "Il Cerchio", Rossano 2002

Kultura muzikore ndë Kallabriet intereson edhe kulturën muzikore arbëreshe. Me të vërtetë autorët e këtij libri, që ka ngjitur edhe një CD me këngë, kanë studiuar edhe dica këngë qishtarë të arbëreshëvet të Kallabrijes. Citimi vetëm dica: "Oj bir e oj bir" nga Spixana; "Qeva u, i mjeri, i ziu" nga Shën Sofia; "Megjithëse guri" nga Frasnita. Autorët thonë se zoti Emanuele Giordano, prift i Eianinës, punon për të rifitonjë këngët e traditës bixantine lokale. Ka edhe këngë liturgjike greke: "En Iordani" si këndohet Ejaninë, "O Monojenis" si këndohet Kastemexh; "Ajios" i traditës së Platanit.

Fortino Italo C., *Agesilao Milano: patriota arbëresh, tra storia e letteratura*, in "Hylli i Dritës", Shkoder 2009/3, pp. 38 – 58

Studimi siell ndë dritë qëndrimet e historianëve R. De Cesare, e mësemë të M. Mendella, mbi atentatin e arbëreshit Axhezilào Milano, nga Shën Benedhiti Ullano, ndë vitin 1856. Gjë për atentatet e A. Milanit na la shkruar edhe poeti nga Spixana Xhuzepe Anxhelo Noçiti. Pra autori i këtij studimi të vogël shënon poezinë që shkruajti A. Milani për Mark Boçarin, një arvanit nga Greçia, si edhe traxhedinë me titull "Agesilao Milano" të Nicola Romano-s, një prift nga Akri.

Brettoni Augusta (a cura di), *ALBANIE. Traduzione, tradizione. La traduzione dalle varianti linguistiche alle varianti culturali*, Atti del Convegno Internazionale (Scutari 5-6 giugno 2008), Bulzoni, Roma 2009

Janë Aktet e Mbledhjes Internacionale që organizoi Universiteti i Firenzës bashkë me Universitetin e Shkodrës. Gjithë kumtesat flasin për problemën e përkthimevet të veprave të letërsisë. Per letërsinë arbereshe foli F. Altimari, çë tha si Xhirolam De Rada qe i pari autor që pruar, ai vetë, veprat e tija nga arbërishtja ndë gjuhën italiane. Tjerët arbëreshë që folin ndë këtë Mbledhje qenë G. Bellushi e G. Turano.

Mostra itinerante sulla Cultura Arbëreshe

Dentro la storia delle minoranze linguistiche convivono esperienze e testimonianze che vanno oltre il territorio stesso e si focalizzano in una visione in cui il valore di tradizione diventa fondamentale. Ho avuto modo di sperimentare ciò grazie al mio lavoro sul campo dedicato, in modo particolare, alla promozione e alla valorizzazione della cultura Arbëreshe. Un'esperienza significativa che mi ha portato ad aprire visioni importanti attraverso un rapporto tra la cultura materiale vissuta sul territorio in una geografia ben definita e il rapporto con i territori che sono affascinati dalle realtà frontaliere che hanno un vissuto eterogeneo ma che si confrontano costantemente con serie parallele. Credo che sia proprio il mondo Italo-albanese ad offrire ciò.

Mi riferisco anche ad una mostra sulla cultura e sul popolo arbëresh che è partita da alcuni anni, dal 2005, e che è stata ospitata da siti arbëreshë certamente, ma in modo particolare da territori che non hanno radici Italo-albanesi. Ci sono constatazioni di fondo con le quali occorre misurarsi e che farò nei prossimi numeri quando questo percorso sarà quasi ultimato, ma c'è da dire che il successo di questa mostra mi ha un po' sorpreso. Da piccoli comuni come Carosino in provincia di Taranto, comunità che è stata arbëreshe, a città come Brindisi, da Cosenza a Grottaglie, da San Marzano di San Giuseppe a Roma, da Strasburgo a Francavilla. Insomma una bella esperienza. Ma cosa c'è nel fondo di questa maturata visione dell'incontro tra etnie, lingua ed eredità culturali?

C'è da dire che la cultura delle minoranze non risiede nei processi culturali della modernità. E' una cultura che è patrimonio di una tradizione. E' necessario, quindi, riconsiderare il rapporto tra storia, territorio, testimonianza e sentire etico-esistenziale. La modernità è fuori da ogni contatto con quella tradizione che custodisce non solo un bene materiale (ben poco visibile ormai) ma soprattutto immateriale. Ed è su questa base di cultura immateriale, pur attraverso apparati documentari e strumenti reali, che si innesca un discorso "rivoluzionario" sul valore di minoranza, il quale non può avere funzioni "progressiste", piuttosto è un valore che ha un senso solo nella cultura della tradizione.

Occorre un humus particolare. Bisogna avvertire e vivere l'essere di una "diversità" (in positivo, naturalmente) rispetto alla realtà della omologazione. La modernità omologa. Nell'età dell'utilitarismo tutto diventa "mercato". Si è minoranza in quanto, tra l'altro, si è depositari di più culture e di più storie, come d'altronde, si può verificare tra le etnie linguistiche storiche presenti in Italia e sancite dalla normativa 482/99. Ma occorrerebbe andare anche oltre quelle presenze minoritarie sancite dalla normativa e penetrare il territorio dal punto di vista sia linguistico che storico-antropologico e archeologico.

L'appartenere ad una "identità altra" è vivere il tempo della spiritualità di una cultura. Il sentimento delle radici non solo si tramanda attraverso modelli di tradizione ma si partecipa: non con episodi che possono isolare - con manifestazioni di cultura e di umanità che possono costituire espressione, certamente, antropologica - ma, soprattutto, etica, religiosa, ontologica. E' un discorso che vale per tutte le altre presenze minoritarie che rivestono una loro importanza nella geografia italiana.

Le vere radici non sono nell'esposizione folcloristica ma nella "impresa" religiosa (e non mi riferisco soltanto a forme rituali e liturgiche che hanno una loro ricchezza imponente). L'appartenenza di un popolo diventa orizzonte di senso e orizzonte culturale grazie a quei legami che sono profondamente metafisici. Il resto fa da scenario.

E questo è un dato che riguarda certamente tutte le 12 etnie (storiche) considerate tali in Italia. Dagli Arbëreshë, dunque, ai

Pierfranco Bruni

poet, shkrimtar, gazetar, arkeolog ka Sullarënxha (Cs)

Grecanici. Dai Ladini ai Sardi. Dagli Occitani ai Franco-provenzali. Un punto deve essere chiaro. Queste etnie non appartengono alla cultura della modernità, e con la modernità, in termini culturali, si scontrano costantemente. Già di per sé il concetto di tutela implica una manifestazione in cui il significato di conservazione è emblematico. Soltanto un processo culturale inteso come interpretazione dei significati conservativi può sostenere un processo che vada all'insegna della salvaguardia e della conoscenza.

L'appartenenza è l'interno di una comunità. Cioè ciò che realmente si avverte, si sente, si ascolta. Non sottovalutiamo una riflessione del genere perché la vera difesa delle radici si gioca su due pilastri: la lingua e la capacità di resistenza dal punto di vista religioso. Facciamo in modo che proprio questi due capisaldi non siano strumento di offerta folcloristica o di sagre che non motivano culturalmente un evento o un contesto.

La cultura popolare è quella che nasce e si svolge all'interno di un territorio e vive nel radicamento della storia, ma territorio e storia resistono all'urto della modernità grazie ad una grande dimensione che è la dimensione spirituale. Mi pare che è su questo che vanno spese motivazioni e riflessioni per un confronto sul ruolo che la cultura delle minoranze deve avere nella nostra temperie. E' naturale che per difendere non solo bisogna conoscere ma anche saper consolidare una identità che è sempre più legata ad una cultura della tradizione. Spirito e tradizione insieme alla lingua e alla religiosità costituiscono un modello per un progetto di alto profilo etico. Il tema delle minoranze etnico-linguistiche si presenta, soprattutto oggi, con delle chiavi di lettura che offrono la possibilità di spaziare in contesti e temperie abbastanza eterogenee. Ci sono aspetti storici, antropologici, letterari, musicali, artistici, esistenziali che si inquadrano in una visione in cui il rapporto tra tradizione, cultura e identità (come modello di appartenenza e come riferimento geografico) diventa fondamentale.

Alcune minoranze (o meglio alcuni popoli che hanno trovato una loro "sistemazione" in Italia) si portano dietro dei codici sia linguistici che culturali (e quindi identitari) che risentono (e rimandano, quindi, ad una tradizione) di un legame (o di una matrice) con le civiltà "sommerse" che hanno interessato il Mediterraneo.

Ci sono minoranze che provengono dal mare e si sono stanziate (molte di queste) lontani dal mare. Ci sono minoranze che hanno una vocazione risalente ad una geografia interna ed hanno mantenuto questo contatto. Ma ci sono anche altre minoranze che si sono innestate su ceppi già esistenti. Si pensi ai grecanici o ancora agli italo-albanesi o ai ladini, ma si potrebbero menzionare tutte quelle realtà di minoranza etnico-linguistiche (compresi quelli parlanti) sancite dalla normativa vigente.

Resta fermo un concetto che è quello del rapporto tra l'identità come difesa di un patrimonio e la tradizione che però non resta come rispetto del tempo vissuto ma si presenta sotto forma di una rivalizzazione. In questo senso la mostra itinerante da me curata è stata ed è un contributo notevole rivolto certamente alla conoscenza ma in modo particolare stimola un dibattito all'interno delle problematiche che chiamano in causa l'identità di un popolo nell'attraversamento dei territori; e la necessità di conoscenza da parte dei non-arbëreshë è un inciso che non bisogna certamente trascurare.